

**LIGJI NR. 04/L-139  
PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE**

**PJESA E PARË**

**KREU I  
DISPOZITAT THEMELORE**

**Neni 1  
Qëllimi dhe fushëveprimi i ligjit**

1. Ky ligj rregullon procedurën përmes së cilës Gjykatat dhe përmbauesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbarimin në bazë të dokumenteve përmbaues dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për përmbarimin e vendimit të marrë në procedurën administrative dhe për kundërvajtje me të cilin është caktuar detyrimi në të holla, përveçse kur për përmbarimin e tillë është paraparë me ligj kompetenca e organit tjetër.

3. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe në përmbarimin në anije dhe në mjet fluturues përveç nëse kjo çështje rregullohet me ligj të veçantë.

4. Ky ligj rregullon edhe kryerjen e veprimtarisë së përmbauesve privat.

**Neni 2  
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Procedura e përmbaimit** - i referohet çfarëdo veprimi të ndërmarrë bazuar në vendimin përmbaues gjatë zbatimit të atij vendimi;

1.2. **Kredia** - e drejta për realizimin e shumës së të hollave apo të ndonjë dhënieje, veprimi, mosveprimi apo pësimi;

1.3. **Kreditor** - personi, kredia e të cilit realizohet në procedurë të përmbaimit të detyrueshëm;

1.4. **Debitor** - personi kundër të cilit realizohet kredia;

1.5. **Pjesëmarrës** - personi që në procedurën e përmbaimit e realizon ndonjë të drejtë apo interes juridik, e që nuk është palë në procedurën e përmbaimit;

1.6. **Palë** - kreditori apo debitori në procedurën përmbauese;

1.7. **Person i tretë** - një person tjetër që nuk është kreditori apo debitori, i cili ka të drejta apo detyrime e mbi të cilin ngarkohen të drejtat apo obligimet nga procedura përmbarese, apo të drejtat apo obligimet e së cilit janë të prekura direkt nga procedura përmbarese;

1.8. **Dokument Përmbare** - dokument në bazë të cilit fillohet procedura e përbarimit;

1.9. **Organi përmbare** - Gjykata apo përmbaresi privat që vepron në pajtim me dispozitat e këtij ligji;

1.10. **Përmbaresi i Gjykatës** - i punësuar në sistemin gjyqësor i cili drejtpërdrejt kryen veprime përmbarese të caktuara;

1.11. **Përmbaresi privat** - personi fizik i emëruar nga Ministri i Drejtësisë në pajtim me dispozitat e këtij ligji, i cili në kryerjen e autorizimeve publike të besuara sipas këtij ligji, vendos për veprimet nga kompetenca e tij në zbatimin e përbarimit të lejuar dhe ndërmerr veprime për përbarim.

1.12 **Urdhri për përbarim** - vendimi i përbaruesit privat me të cilin pranohet plotësisht apo pjesërisht propozimi për kryerjen e përbarimit;

1.13. **Aktvendimi për përbarim** - vendimi i Gjykatës përmes së cilit propozimi për përbarim pranohet plotësisht apo pjesërisht apo përbarimi urdhërohet sipas detyrës zyrtare;

1.14. **Regjistri publik i paluajtshmërive** - të gjitha librat publike në të cilat regjistrohen të drejtat për sendet e paluajtshme;

1.15. **Letra me vlerë** - dokument i shkruar ose elektronik në bazë të cilit ekziston një e drejtë ose përmban një të drejtë mbi të cilin kërkohet përbarimi;

1.16. **Aksione** - letër me vlerë e cila është regjistruar në regjistrin e letrave me vlerë në të cilën zbatohet përbarimi;

1.17. **Banka** - banka apo organizata financiare e cila kryen punët e qarkullimit të pagesave;

1.18. **Parashënimi** - lloj regjistrimi në librat publike me të cilin kushtimisht fitohen, barten apo shuhet të drejtat për sendet e paluajtshme dhe sendet tjera që janë objekt përbarimi;

1.19. **Bujku** - personi që si burim kryesor ka të ardhura nga bujqësia;

2. Të shprehurit në një gjini gramatikore, femërore apo mashkullore në këtë ligj, përfshinë të dyja gjinitë e personave fizik.

### Neni 3

#### Organi përmbare dhe vendimet

1. Procedurën e përbarimit në shkallë të parë e udhëheq dhe për te vendosë përmbaresi privat, ndërsa përjashtimisht gjyqtari individual kur me këtë ligj është caktuar se përbarimin e cakton dhe zbaton Gjykata (organi i shkallës së parë). Organi përmbare vendos për propozimin e përbarimit brenda afatit prej shtatë (7) ditëve pas pranimit të propozimit.

2. Në shkallën e dytë vendimet i nxjerrë gjyqtari individual.

3. Nëse vendimi për realizimin e detyrueshëm të kredisë merret në ndonjë procedurë tjetër gjyqësore, ai vendim merret nga Gjykata në përbërjen sipas të cilës udhëhiqet ajo procedurë gjyqësore

4. Vendimet në procedurën e përbarimit organi përmbare i nxjerrë në formë të aktvendimit ose urdhrin për përbarim.

5. Konkluzioni nxirret për zbatimin e disa veprimeve dhe për drejtimin e procedurës.

#### **Neni 4**

##### **Fillimi i procedurës**

1. Procedura e përmbarimit fillohet me propozimin e kreditorit.
2. Procedura e përmbarimit fillohet nga Gjykata sipas detyrës zyrtare kur me ligj parashihet një gjë e tillë.

#### **Neni 5**

##### **Kompetenca**

1. Përmbarimin e cakton dhe zbaton organi përmbarues i paraparë me këtë ligj, po qe se me ligj tjetër nuk është paraparë ndryshe.
2. Gjykata kompetente ka kompetencë lëndore për të urdhëruar dhe për të kryer përmbarimin si dhe për të vendosur për çështjet gjatë procedurës në pajtim me dispozitat e këtij ligji përveç nëse Gjykatat dhe autoritetet tjera përmbaruese kanë juridiksionin për të urdhëruar dhe për të kryer përmbarimin si dhe për të vendosur për çështjet gjatë procedurës.
3. Përmbaruesi privat nxjerr urdhër në bazë të propozimit për kryerje të përmbarimit dhe kryen përmbarimin me qëllim të plotësimit të kërkesës së debitorit në bazë të dokumentit përmbarues, përveç nëse ndryshe parashikohet me ligj që urdhëron që përmbarimi dhe kryerja e përmbarimit të bëhet brenda juridiksionit të Gjykatës.
4. Kompetenca territoriale për të vendosur për çështjet lidhur me aplikimin e procedurave përmbarimore caktohet me dispozitat e këtij ligji, varësisht nga mjetet dhe objekti i përmbarimit, si dhe në bazë të statusit të organit përmbarues.
5. Për të vendosur çështjet që kanë të bëjnë me çdo prapësim, ankesë, parregullsi në procedurën përmbaruese sipas nenit 52 dhe 67 të këtij ligji, ose çfarëdo lloj procedure kundër veprimeve të ndërmarra nga Përmbaruesi privat, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e së cilës debitori ka vendbanimin apo nëse nuk ka vendbanim në Kosovë, atëherë në territorin në të cilin ka vendqëndrimin nëse është person fizik. Nëse debitori është person juridik, kompetencë territoriale ka Gjykata kompetente ku gjendet selia e debitorit. Nëse debitori nuk ka vendbanim të përkohshëm ose seli në Kosovë, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e se cilës gjinden sendet e luajtshme dhe të paluajtshme e të cilat janë objekt përmbarimi.
6. Gjykata është kompetente të vendos në procedurën e përmbarimit dhe të zbatoj përmbarimin e vendimeve gjyqësore lidhur me:
  - 6.1. të gjitha çështjet nga e drejta familjare dhe
  - 6.2. kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë dhe kompensimet tjera.

#### **Neni 6**

##### **Urgjenca dhe rendi i veprimit**

1. Në procedurën e përmbarimit organi përmbarues ka për detyrë të veprojë me ngutshmëri.
2. Organi përmbarues ka për detyrë që lëndët t'i marrë në punë sipas radhës që i ka pranuar, përpos kur natyra e kredisë ose rrethanat e posaçme kërkojnë që organi përmbarues të veprojë ndryshe.
3. Organi përmbarues mund të konkludojë se natyra e kredisë kërkon trajtim të përshpejtuar të rastit nëse ka rrezik legjitim që pasuritë e debitorit në atë rast të mos jenë në dispozicion për konfiskim apo do t'i bie vlera shumë në rast të vonesës. Gjyqtari mund të pranojë ekzistimin e rrethanave të veçanta, dhe të veprojë shpejt, në rastet që kanë të bëjnë me punësimin, çështjet familjare, alimentacionin apo pagesat për fëmijë nëse interesat e palës mund të ndikohen negativisht si rezultat i vonesës.

## **Neni 7**

### **Mjetet dhe objekti i përmbarimit**

1. Mjete të përmbarimit janë veprimet përmbarimore ose sistemi i veprimeve të tilla, me të cilat sipas ligjit kërkesa realizohet me detyrim.
2. Objektet e përmbarimit janë pasuria dhe të drejtat tjera që mund t'i nënshtrohen përmbarimit, përveç atyre që përjashtohen nga përmbarimi me ligj dhe aktet ndërkombëtare të zbatueshme në Kosovë.
3. Veprimet përmbarimore mund të kryhen drejtpërdrejtë kundër debitorëve dhe personave tjerë, në pajtim me këtë ligj.

## **Neni 8**

### **Objektet që nuk i nënshtrohen përmbarimit**

1. Objekt përmbarimi nuk mund të bëhen sendet jashtë qarkullimit juridik, pasuritë nëntokësore dhe pasuritë tjera natyrore.
2. Objekt përmbarimi nuk mund të bëhen objektet, armatimi dhe pajisjet e forcave të armatosura dhe të policisë, e as mjetet financiare të siguruara për dedikime të këtilla.

## **Neni 9**

### **Mbrojtja e dinjitetit të debitorit**

1. Gjatë zbatimit të procedurës së përmbarimit, duhet kushtuar vëmendje mbrojtjes së dinjitetit të debitorit, dhe përmbarimi të jetë sa më pak i dëmshëm që është e mundshme për debitorët.
2. Organi përmbarues ka për detyrë që me rastin e ekzekutimit të vendimit dhe të identifikimit të sendeve të veprojë me respektin e duhur të personalitetit të debitorit dhe të anëtarëve të familjes së tij.
3. Nëse ekziston ndonjë arsye legjitime dhe nëse organi përmbarues ka miratimin për të kryer përmbarimin gjatë ditëve të pushimit dhe gjatë orëve të natës, organi përmbarues gjithashtu mund të kryej përmbarimin në shtëpinë e debitorit gjatë ditëve të pushimit apo orëve të natës.

## **Neni 10**

### **Përcaktimi i mjeteve dhe objekteve të përmbarimit**

1. Gjykata me aktvendim, ose përmbaruesi privat me urdhër për përmbarim, e cakton përmbarimin ndaj atyre mjeteve dhe në ato objekte të përmbarimit që janë specifikuar në propozimin për përmbarimin.
2. Përmbarimi përfshinë një apo të gjitha mjetet dhe objektet e përmbarimit të paraqitura në propozimin për përmbarim gjersa kërkesa të realizohet plotësisht.
3. Me propozim të kreditorit apo sipas detyrës zyrtare, organi përmbarues mund të vendosë, përmes urdhrin për përmbarim që përmbarimi të zbatohet ndaj pasurisë së debitorit që mund të jetë subjekt i përmbarimit, pa deklaruar mjetet dhe objektet e përmbarimit deri në limitin që mjafton për realizimin e kredisë së kreditorit.
4. Nëse organi përmbarues sekuestron më shumë mjete sesa nevojiten për të realizuar kredinë, pjesa tjetër i kthehet debitorit në afat prej tridhjetë (30) ditësh.
5. Kreditori mund të kërkojë nga organi përmbarues që të ndihmojë në identifikimin e pasurisë siç është paraparë në këtë ligj:

5.1. në qoftë se janë propozuar më shumë mjete apo objekte përbarimi sesa që nevojiten për të plotësuar vendimin, organi përbarues mund ta kufizojë përbarimin, sipas propozimit të debitorit, të kufizojë përbarimin vetëm në disa nga mjetet dhe objektet e tilla, po qe se ato mjaftojnë për realizimin e kredisë.

5.2. debitori mund t'i propozojë organit përbarues pasuritë që ai preferon të përbarojë, dhe jep arsyet për kufizim të përbarimit.

5.3. debitori i bashkangjet propozimit nga nënparagrafi 5.2. i këtij paragrafi dëshmitë e shkruara, siç janë deklaratat bankare, duke dëshmuar se ato mjete dhe objekte mjaftojnë për të mbuluar kredinë. Debitori gjithashtu do të ofrojë informata të sakta organit përbarues se ku gjenden ato mjete apo objekte dhe si ato të sekuestrohen.

5.4. propozimi i debitorit, si dhe të gjitha informatat shoqëruese, i jepen kreditorit, dhe kreditori i përgjigjet propozimit brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i propozimit.

5.5. nëse kreditori nuk pranon propozimin, organi përbarues sigurohet nga dëshmitë e siguruara se pasuritë e dhëna në listë mjaftojnë për të mbuluar kredinë para se të vendosë në favor të propozimit të debitorit. Nëse organi përbarues nuk arrin që të sigurohet, në bazë të dëshmimeve të ofruara, se pasuritë e dhëna në listë mjaftojnë për të mbuluar kredinë, organi përbarues refuzon propozimin.

6. Nëse pranohet propozimi i debitorit për të kufizuar mjetet dhe objektet e përbarimit, dhe nëse pasuritë e dhëna në listë të propozimit nuk mund të gjenden apo ato pasuri janë të pamjaftueshme në shumën për të mbuluar kredinë, atëherë kreditori njofton organin përbarues i cili menjëherë urdhëron zbatimin e propozimit fillestar të kreditorit për përbarim. Nën këto rrethana, debitori që ka bërë propozimin mund t'i nënshtrohet gjobave sipas dispozitave nga neni 15 dhe 16 të këtij ligji.

7. Kreditori mund të pajtohet që të kufizojë kërkesën e tij në pajtim me propozimin e debitorit nëse konsideron propozimin adekuat për të mbuluar kredinë.

8. Po qe se aktvendimi apo urdhri i përbarimit nuk mund të zbatohet në objektin apo mjetin e përbarimit, atëherë propozuesi i përbarimit me qëllim të realizimit të kërkesës së njëjtë, mund të propozojë ndonjë mjet ose objekt tjetër përbarimi.

#### **Neni 11**

#### **Përbarimi i dokumenteve përbarimore të huaja**

Përbarimi i dokumentit të huaj përbarimor do të caktohet dhe zbatohet sipas këtij ligji, nëse dokumenti përbarimor i huaj i plotëson kushtet e parapara me ligj apo marrveshje ndërkombëtare për pranim dhe përbarim.

#### **Neni 12**

#### **Përbarimi ndaj pronës në shtetin e huaj**

1. Në pasurinë e shtetit të huaj në Republikën e Kosovës ose të organizatës ndërkombëtare, e cila gjendet në territorin e Republikës së Kosovës, nuk mund të caktohet përbarimi pa pëlqimin paraprak të Ministrit të Drejtësisë dhe mendimit të Ministrit të Punëve të Jashtëm, përveç kur shteti i huaj apo organizata ndërkombëtare është pajtuar me përbarimin.

2. Nëse propozimi për fillimin e procedurës mbi pronën e shtetit të huaj në Republikën e Kosovës nuk është paraqitur pëlqimi nga paragrafi 1. i këtij neni përkatësisht pajtimit të shtetit të huaj, propozimin do ta hedhë poshtë përbaruesi privat përkatësisht Gjykata.

#### **Neni 13**

#### **Shpenzimet e përbarimit**

1. Shpenzimet e procedurës lidhur me caktimin dhe kryerjen e përbarimit paraprakisht i paguan kreditori.

2. Shpenzimet nga paragrafi 1. i këtij neni, propozuesi i përmbartimit ka për detyrë t'i parapaguaj brenda afatit të caktuar nga organi përmbartues. Organi përmbartues do ta pezulloj përmbartimin po qe se nuk parapaguhet shpenzimet brenda afatit të tillë. Po qe se brenda afatit të dhënë nga organi përmbartues nuk parapaguhet shpenzimet për kryerjen e një veprimi konkret, atëherë nuk do të kryhet vetëm veprimi i tillë.

3. Shpenzimet e procedurës së filluar nga Gjykata sipas detyrës zyrtare, paraprakisht i përballon vetë Gjykata nga mjetet financiare të buxhetit të saj.

4. Debitori ka për detyrë që kreditorit t'ia paguaj shpenzimet procedurale dhe të gjitha shpenzimet tjera të shkaktuara gjatë procedurës së përmbartimit.

5. Kreditori duhet t'ia kompensojë debitorit shpenzimet e shkaktuara pa nevojë të justifikueshme.

6. Për kërkesën për pagimin e shpenzimeve procedurale organi përmbartues vendos njëkohësisht me vendimin për përmbartim po në këtë procedurë sipas propozimit të palës, duke e caktuar përmbartimin me qëllim të realizimit të tij.

#### **Neni 14 Garancia**

1. Organi përmbartues urdhëron për dhënien e garancisë me aktvendim apo me urdhër. Në rastet në të cilat ky ligj e parasheh dhënien e garancisë atëherë ai jepet në para të gatshme. Organi përmbartues mund të lejojë dhënien e garancisë edhe në formë të garancisë bankare, letrave me vlerë si dhe në sende të çmueshme vlera e të cilave lehtë caktohet në treg dhe që mund të shndërrohet në të holla shpejt dhe në mënyrë të thjeshtë.

2. Institucionet e Republikës së Kosovës dhe organet ose shërbimet e tyre nuk janë të detyruara të deponojnë garancinë kur në procedurën përmbartimore paraqiten si palë.

3. Në garancinë e deponuar pala kundërshtare e fiton të drejtën e pengut ligjor.

4. Nëse organi përmbartues në procedurën përmbartimore vendos për të drejtën e palës kundërshtare që t'i paguhet shpenzimet procedurale dhe dëmet e shkaktuara lidhur me veprimin për të cilin është dhënë garancia, atëherë me propozimin e palës, Gjykata me të njëjtin aktvendim do të vendos edhe për pagimin e kërkesës nga garancia e dhënë.

5. Garancitë nuk mund të kërkohen, nëse ofrimi i saj shkakton dëm të riparueshëm për debitorin.

#### **Neni 15 Gjobat në procedurën përmbartimore**

1. Gjobat e parapara nga ky nen mund të shqiptohen, me vendim të Gjykatës, për çdo veprim apo mosveprim me të cilat shkelen dispozitat e këtij ligji apo të vendimit të organit përmbartues në pajtim me këtë ligj. Këto gjoba mund të shqiptohen nga Gjykata sipas detyrës zyrtare, si dhe në bazë të propozimit të arsyetuar të përmbartuesit privat nëse në procedurën që zhvillohet pranë përmbartuesit privat janë plotësuar kushtet për shqiptimin e gjobës.

2. Gjobat mund të shqiptohen kundër personave fizik në procedurën përmbartimore në shumë prej njëqind (100) gjer në njëmijë (1.000) Euro, përderisa për personat juridik në shumë prej njëmijë (1.000) gjer në dhjetë mijë (10.000) Euro.

3. Gjoba në të holla në shumë prej pesqind (500) deri dymijë e pesqind (2.500) Euro mund t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës të personit juridik.

4. Gjoba në të holla nga paragrafi 2. i këtij neni, mund të shqiptohet në mënyrë të përsëritur, po qe se debitori nuk vepron sipas urdhrit të përsëritur të Gjykatës apo përmbartuesit privat apo vazhdon të veprojë në kundërshtim me këtë urdhër.

5. Para shqiptimit të gjobës në të holla, Gjykata ia mundëson palës ndaj së cilës është shqiptuar gjoba që të deklarohet, dhe kur konsiderohet e nevojshme nga Gjykata, ajo mund të caktojë seancë me qëllim të marrjes së provave.

6. Gjobën në të holla e shqipton Gjykata duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, e sidomos mjetet ekonomike të palës dhe rëndësinë e veprimit që konsiderohet se ka pasur për detyrë ta kryej pala. Me aktvendimin për gjobitjen, caktohet edhe afati për pagimin e shumës së të hollave që e përbënë gjobën.

7. Personi i gjobitur mund të ankohet kundër aktvendimit brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, nga dita kur i është dorëzuar.

8. Personi i gjobitur duhet t'i paguaj shpenzimet e krijuara me shqiptimin dhe përmbarimin e kësaj gjobe.

9. Pas përmbarimit të aktvendimit, gjobën në të holla e realizon organi përmbarues sipas detyrës zyrtare, në dobi të llogarisë rrjedhëse nga e cila financohet Gjykata. Shpenzimet e përmbarimit e ngarkojnë buxhetin e Gjykatës, kurse pagimi i këtyre shpenzimeve që caktohet me anë të konkluzionit, zbatohet në procedurën e realizimit të dhunshëm të gjobës në të holla.

10. Gjoba në të holla mund të shqiptohet dhe zbatohet edhe kundër debitorit dhe personave të tjerë fizik, si dhe kundër personave përgjegjës të personit juridik edhe kur refuzojnë të japin të dhëna për pasurinë e debitorit, si dhe kur me veprimet dhe sjelljet e tyre në kundërshtim me urdhrin e autoritetit përmbarues, ose kur e dëmtojnë apo zvogëlojnë pasurinë e debitorit, apo e pengojnë organin përmbarues në kryerjen e veprimeve përmbarimore.

11. Gjoba në të holla e shqiptuar sipas dispozitave të këtij neni nuk mund të shndërrohet në dënim me burgim.

#### **Neni 16**

#### **Gjobat për vonesë të përmbarimit**

1. Kur debitori nuk përmbushë brenda afatit të caktuar çfarëdo obligimi monetar apo jo monetar të përcaktuar nga dokumenti përmbarues, sipas detyrës zyrtare, apo me propozim të kreditorit, do të përcaktojë një datë jo më pak se tri (3) ditë pas skadimit të afatit për përmbushje vullnetare nga data, me të cilën fillon llogaritja e gjobës nëse pagesa nuk është realizuar gjer në datën e caktuar.

2. Gjobat për çdo ditë të vonesës do të jenë mbi pesë (5) euro por jo më lartë se pesdhjetë (50) euro për personat fizik, dhe mbi pesdhjetë (50) euro por jo më tepër se pesqind (500) euro për personat juridik. Gjobat do të shtohen për çdo ditë apo periudhë tjetër të vonesës, në pajtim me rregullat e Ligjit për Detyrimet, që nga dita e skadimit të afatit për përmbushjen e obligimeve e gjer sa të arrihet kjo përmbushje.

#### **Neni 17**

#### **Zbatimi i dispozitave të ligjeve tjera**

Në procedurën përmbarimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër.

### **KREU II**

#### **PROCEDURA E PERMBARIMIT**

#### **Neni 18**

#### **Dërgimi i parashtresave dhe i dokumenteve**

Dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, të parapara për dërgimin e shkresave, vlejné edhe për aktvendimin për përmbarrimin, urdhrin për përmbarrim, aktvendimin lidhur me prapësimin kundër aktvendimit për përmbarrim dhe aktvendimit për gjobën me të holla.

### **Neni 19**

#### **Detyra për të dhënë informata rreth debitorit**

1. Me kërkesë të organit përmbarrues, personat juridik apo organet që kanë autoritetin për regjistrat e pronës dhe të drejtat mbi pronën e debitorit përmbarrues, dhe personi që thuhet nga kreditori përmbarrues se është debitor, apo është në posedim të çfarëdo prone të debitorit jep informata për pronën e debitorit brenda tetë (8) ditëve.

2. Personat dhe organet nga paragrafi 1. i këtij neni nuk do të njoftojné debitorin se këto informata janë kërkuar nga ta.

### **Neni 20**

#### **Parashtresat, seancat dhe dosjet**

1. Në procedurën përmbarrimore organi përmbarrues vepron në bazë të parashtresave të palëve dhe dëshmime tjera të dokumentuara.

2. Organi përmbarrues cakton seancë dëgjimore atëherë kur një gjë e tillë është paraparë me këtë ligj, ose kur mendon se një gjë e tillë është e dobishme.

3. Për punën e kryer në seancë, në vend të procesverbalit organi përmbarrues mund të përpilojë shënim zyrtar.

4. Jashtë seancës dëgjimore organi përmbarrues e dëgjon palën apo pjesëmarrësin tjetër në procedurë, po qe se një gjë e tillë është paraparë me këtë ligj, apo kur vlerëson se një gjë e tillë është e nevojshme për sqarimin e ndonjë çështjeje, apo për deklarimin lidhur me ndonjë propozim të palës.

5. Mungesa e njëres apo e të dy palëve, ose e pjesëmarrësit tjetër në procedurë nga seanca dëgjimore, apo mosveprimi sipas letërthirjes së organit përmbarrues me qëllim të dëgjimit të tyre, nuk e pengon organin përmbarrues që të veprojë në seancë.

6. Parashtresat në procedurën përmbarrimore paraqiten në numër të mjaftueshëm për organin përmbarrues dhe për palën kundërshtare.

## **KREU III**

### **DOKUMENTI PERMBARRUES (TITULLI EKZEKUTIV) DHE DOKUMENTI I BESUESHËM**

#### **Neni 21**

##### **Bazat juridike për caktimin e përmbarrimit**

Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.

#### **Neni 22**

##### **Dokumentit përmbarrues**

1. Dokumente përmbarruese janë:

1.1. vendimi përmbarrues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbarruese;

1.2. vendimi përmbarrues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia);



1.3. dokumenti noterial i përmbarueshëm në pajtim me ligjin për noterinë;

1.4. marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit në pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin pas aprovimit të Gjykatës;

1.5. aktvendimet, aktet dhe memorandumet për ujdite gjyqësore të Gjykatave të huaja si dhe vendimet e Gjykatave të huaja të arbitrazhit dhe ujdite e arritura para Gjykatave të tilla në raste të arbitrazhit, të cilat janë pranuar për përmbarim brenda territorit të Republikës së Kosovës;

1.6. vendimet dhe marrëveshjet përmbaruese të arbitrazhit në Republikën e Kosovës të shpallura të ekzekutueshme nga Gjykata;

1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit;

1.8. vendimi gjyqësor i vërtetuar si urdhër përmbarues evropian;

1.9. dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument përmbarues.

### **Neni 23 Vendimi dhe ujdia**

1. Sipas këtij ligji, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdë gjyqësore konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit.

2. Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike, kurse aktpajtim administrative konsiderohet ujdia e arritur në procedurën administrative përpara organit ose shërbimit, përkatësisht personit juridik të tillë, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër.

### **Neni 24 Përmbarueshmeria e vendimit**

1. Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbarueshëm po qe se ka marrë formë të prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.

2. Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për mosveprim ose veprim, është i përmbarueshëm po qe se është bërë i formës së prerë. Organi përmbarues kompetent mund të lejoj një afat shtesë për përmbushjen e obligimeve të debitorit.

3. Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.

4. Në bazë të vendimit i cili është bërë i përmbarueshëm vetëm në një pjesë të tij, përmbarimi mund të lejohet vetëm për sa i përket pjesës së tillë.

5. Përmbarimi caktohet në bazë të vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë, ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurën administrative që nuk është bërë përfundimtar, vetëm po qe se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përmbarimin.

### **Neni 25 Përmbarueshmëria e ujdisë**

1. Ujdia gjyqësore, aktpajtimi e lidhur në procedurën administrative, marrëveshja përmbaruese e arbitrazhit, marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit apo marrëveshja e lidhur në

procedurë tjetër është e përbarueshme në qoftë se kredia të cilën duhet përmbushur sipas saj është bërë e arritshme.

2. Arritshmëria e kredisë provohet me anë të procesverbalit për ujdinë, me anë të dokumentit publik, ose me anë të dokumentit të vërtetuar sipas ligjit.

3. Arritshmëria që nuk mund të provohet në mënyrën e caktuar në paragrafin 2. të këtij neni, provohet me anë të vendimit të formës së prerë të dhënë në procedurën kontestimore me të cilin konstatohet bazueshmëria e kredisë (kërkesës).

4. Në bazë të ujdisë që është bërë e përbarueshme vetëm në një pjesë të saj, përbarimi mund të caktohet vetëm sa i përket pjesës së tillë.

#### **Neni 26**

##### **Përbarueshmëria e dokumentit të noterisë**

1. Dokumenti i noterizuar është i përbarueshëm nëse është bërë i përbarueshëm sipas rregullave të veçanta që rregullojnë përbarueshmërin e atij dokumenti.

2. Përbarimi në bazë të dokumentit të noterizuar që është bërë i përbarueshëm për ndonjë pjesë, mund të urdhërohet vetëm për atë pjesë.

#### **Neni 27**

##### **Përshtatshmëria e dokumentit përbarimor**

1. Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

2. Në qoftë se me anë të dokumentit përbarues nuk është caktuar afati për përmbushje vullnetare të detyrimit, afati i tillë do të caktohet me anë të aktvendimit për përbarimin, dhe urdhrin për përbarim, për shtatë (7) ditë.

3. Në rastin nga paragrafi 2. i këtij neni, organi përbarues e cakton përbarimin e propozuar nëse debitori brenda afatit që i është caktuar për përmbushje vullnetare nuk e përmbushë detyrimin e tij.

#### **Neni 28**

##### **Kamatëvonesa**

Në qoftë se kamata vonesa ka ndryshuar pas nxjerrjes të dokumentit përbarimor, organi përbarues sipas detyrës zyrtare do të aplikoj kamatën sipas shkallës së ndryshuar gjatë kohës në pajtim me Ligjin për marrëdhëniet detyrimore.

#### **Neni 29**

##### **Dokumentet e besueshme**

1. Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokumenti i besueshëm, sipas këtij ligji është:

1.1. kambialet dhe çeqet me potest dhe faturë kthyese, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës;

1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave;

1.3. faturat;

1.4. dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike;

2. Llogaritja e kamatës konsiderohet si pjesë e dokumentit të besueshëm.

3. Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar.

### **Neni 30** **Kërkueshmëria e kredisë**

Kur nga dokumenti i besueshëm nuk shihet se a është bërë e kërkueshme kredia, atëherë përmbarimi caktohet vetëm në qoftë se kreditori paraqet deklaratë me shkrim se kredia e tij është bërë e kërkueshme duke u treguar edhe dita për një gjë të tillë.

### **Neni 31** **Kalimi i kredisë apo i debisë**

1. Përmbarimi caktohet edhe sipas kërkesës së personit dhe në dobi të tij i cili në dokumentin përmbarues nuk është shënuar si kreditor, po qe se ai (me anë të dokumentit publik apo me dokument privat por të vërtetuar sipas ligjit) provon se kredia i është kaluar atij, apo se në ndonjë mënyrë tjetër ka kaluar tek ai. Debitori njoftohet përmes organit përmbarues për ndryshim të kreditorit përmes dërgesës standarde me postë në adresën e fundit të regjistruar të debitorit. Po qe se kalimi ose mënyra tjetër se si është bërë kalimi i kredisë nuk mund të provohet, atëherë një gjë e tillë mund të provohet me anë të vendimit të formës së prerë të dhënë në procedurën kontestimore.

2. Përmbarimi caktohet edhe kundër personit të tretë i cili në dokumentin përmbarimor nuk përmendet si debitor, po qe se kreditori me anë të dokumentit publik apo privat, por të vërtetuar sipas ligjit provon se personi i tillë në mënyrë të ligjshme e ka marrë përsipër borxhin (debinë) nga dokumenti përmbarues, apo se ai borxhin e tillë sipas ligjit është i detyruar ta shlyejë. Po qe se kontestohet detyrimi i personit të tretë për marrjen përsipër të borxhit, atëherë palët para se të lejohet përmbarimi, kontestin duhet ta zgjidhin në procedurë kontestimore.

### **Neni 32** **Detyrimi i kushtëzuar dhe detyrimi reciprok**

1. Përmbarimi që varet nga përmbushja paraprake e ndonjë detyrimi nga ana e kreditorit, ose nga plotësimi i ndonjë kushti, caktohet në qoftë se propozuesi i përmbarimit me dokument publik apo privat, por të vërtetuar provon se e ka përmbushur detyrimin e vet, apo se e ka siguruar përmbushjen e tij, përkatësisht se kushti është plotësuar.

2. Përmbushja e detyrimit, respektivisht plotësimi i kushtit provohet me anë të aktgjykimit të formës së prerë të dhënë në procedurën kontestimore, po qe se kreditori nuk ka mundësi që një gjë të tillë ta provojë në mënyrën e shënuar në paragrafin 1. të këtij neni.

3. Në qoftë se debitori sipas titullit përmbarues është i detyruar që ta përmbushë detyrimin e tij me kusht që në të njëjtën kohë të përmbushet ndonjë detyrim në dobi të tij, atëherë Gjykata do ta caktoj përmbarimin vetëm po qe se kreditori paraqet provë se e ka siguruar përmbushjen e detyrimit të vet.

4. Konsiderohet se kreditori e ka siguruar mjaftueshëm përmbushjen e detyrimit të vet në vështrim të paragrafit 3. të këtij neni, në qoftë se objektin e detyrimit e ka depozituar te Gjykata apo përmbaruesi privat.

### **Neni 33** **Detyrimi alternativ sipas zgjedhjes së debitorit**

1. Në qoftë se debitori sipas dokumentit përmbarues ka të drejtë zgjedhjeje midis disa objekteve të detyrimit të vet, kreditori ka për detyrë që në kërkesën për përmbarim ta caktojë objektin me të cilin duhet të përmbushet detyrimi.

2. Debitori ka të drejtë zgjedhjeje në mesin e objekteve të përmbartimit deri sa kreditori pranon një apo më shumë objekte që e ka përmendur në propozimin për përmbartim në përmbushjen e plotë apo të pjesshme të detyrimit.

#### **Neni 34** **Autorizimi alternativ i debitorit**

1. Debitori ndaj të cilit me anë të titullit përmbartues është shqiptuar detyrimi jo në të holla, në të njëjtën kohë krahas të drejtës së lirit nga detyrimi i përmbushjes së tij duke paguar shumën në para të caktuar në titullin përmbartues, mund ta paguaj shumën e tillë derisa kreditori as pjesërisht nuk ka filluar ta pranojë objektin e detyrimit.

2. Kreditori gëzon të drejtën që t'i paguhen shpenzimet e procedurës së përfunduar e cila është ndaluar nga shkaku se debitori pas fillimit të saj në vend të detyrimit primar e ka përmbushur detyrimin tjetër të caktuar me titullin përmbartues.

#### **Neni 35** **Ndërprerja e procedurës**

1. Organi përmbartues nuk mund ta ndërpres procedurën përmbartimore me qëllim që të presë vendimin e Gjykatës kompetente, apo të ndonjë organi tjetër për çështjen paraprake.

2. Në rastet tjera të ndërprerjes së procedurës, të parapara me Ligjin për Procedurën Kontestimore, Gjykata mundet, po qe se e lejojnë rrethanat e rastit një gjë të tillë, sipas propozimit të palës apo sipas detyrës zyrtare që të caktojë vazhdimin e procedurës duke ia emëruar përfaqësuesin e përkohshëm palës për të cilën ka të bëjë shkaku nga i cili vjen gjerë te ndërprerja e procedurës.

3. Në rast të vdekjes së kreditorit që nuk ka përfaqësues me prokurë apo përfaqësues ligjor, secili nga trashëgimtarët apo personat e interesuar mund të propozojë që deri sa të zgjasë bashkësisë trashëgimore, Gjykata me shpenzime të propozuesit t'ua emërojë përfaqësuesin e përkohshëm dhe ta vazhdojë procedurën. Gjykata mund të emërojë vetëm një person që nuk ka interes personal në konflikt me interesat e kreditorit, dhe përfaqësuesi i përkohshëm ka për detyrë të lënë në mirëbesim që të veprojë në interes të kreditorit. Personi i emëruar ka të drejtën që të refuzojë emërimin, dhe përmbartuesi në atë rast kanë të drejtën që të emërojë një zëvendësues. Gjykata do ta emërojë përfaqësuesin e përkohshëm brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, nga dita e parashtimit të propozimit. Në rast se propozimi i këtillë i trashëgimtarit, apo personave të interesuar nuk parashtrohet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e vdekjes së kreditorit, Gjykata e pezullon procedurën përmbartimore.

4. Në rast të vdekjes së debitorit që nuk ka përfaqësues ligjor apo me prokurë, Gjykata, brenda afatit prej pesëmbdhjetë (15) ditësh nga dita në të cilën është njoftuar për vdekjen e debitorit, emëron përfaqësuesin e përkohshëm në emër të trashëguesve të debitorit në ngarkim të shpenzimeve të kreditorit, si rregull nga radha e personave që e kanë në posedim pasurinë që është objekt përmbartimi, dhe vazhdon procedurën. Gjykata e emëron përfaqësuesin e përkohshëm brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, nga dita e parashtimit të kërkesës. Po qe se personat e autorizuar nuk e propozojnë vazhdimin e procedurës brenda afatit që u është caktuar, Gjykata e pezullon procedurën përmbartimore. Gjykata mund të emërojë vetëm një person që nuk ka interes personal në konflikt me interesat e debitorit, dhe përfaqësuesi i përkohshëm ka për detyrë që të veprojë në interes të debitorit. Personi i emëruar ka të drejtën që të refuzojë emërimin, dhe Gjykata në atë rast ka të drejtën që të emërojë një zëvendësues.

5. Shpenzimet definitive të kreditorit të përmbartimit nga paragrafi 4. i këtij neni, realizohen nga pasuria e debitorit.

6. Pas mbarimit të bashkësisë trashëgimore, secili nga trashëgimtarët mund ta marrë përsipër procedurën përmbartimore duke iu paraqitur organit përmbartues.

7. Për marrjen përsipër të procedurës dhe shkarkimin e përfaqësuesit të përkohshëm, organi përmbartues vendosë me vendim të dhënë në formë të konkluzionit.

#### **Neni 36**

## **Vërtetimi për përmbueshmërinë**

1. Së bashku me propozimin për përmbueshmëri, organit përmbues i dorëzohet edhe dokumenti përmbues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbueshmërisë për përmbueshmëri.
2. Vërtetimin për përmbueshmërinë e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë.
3. Përbashimisht nga dispozitat e paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni, dokumenti përmbues i noterit, në bazë të cilit është paraqitur propozimi për përmbueshmëri, nuk ka nevojë të jetë i pajisur me vërtetimin për përmbueshmërinë, por përmbueshmëria e tij përcaktohet sipas dispozitave të ligjit për noterinë.
4. Vërtetimin për përmbueshmërinë të dhënë pa qenë të plotësuar kushtet e parapara me ligj e anulon me aktvendim e njëjta Gjykata, respektivisht i njëjti organ i pushtetit sipas propozimit të debitorit. Propozimi për anulim duhet të paraqitet brenda afatit prej shtatë (7) ditë nga dita e dorëzimit të aktvendimit përmbues tek debitori. Organi përmbues ose organi kompetent shtetëror po ashtu mund ta iniciojë anulimin në çdo kohë.

### **Neni 37**

#### **Përmbueshmëri në bazë të dokumentit të besueshëm**

Kur propozimi për përmbueshmëri paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.

## **KREU IV**

### **PROPOZIMI DHE CAKTIMI I PËRMBUESHMËRISË**

#### **Neni 38**

##### **Propozimi për përmbueshmëri**

1. Propozimi për përmbueshmëri duhet ta përmbajë kërkesën për përmbueshmëri në të cilën do të tregohet dokumenti përmbueshmëri origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbueshmëri, kërkuesi i përmbueshmërisë dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet të cilave duhet kryer përmbueshmëri, objekti i përmbueshmërisë po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbueshmërisë.
2. Në rast se propozimi për përmbueshmëri nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënime të kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbues do të veprë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.
3. Po qe se bashkë me propozimin për përmbueshmëri është bërë edhe kërkesa për konstatimin e pasurisë së debitorit, për rezultatin e konstatimit të tillë organi përmbues do ta njoftojë kreditorin duke i lënë afat që ta rregullojë propozimin e paraqitur, respektivisht që ta ndryshoj apo plotësoj atë. Propozimi i ndryshuar dorëzohet brenda dhjetë ditëve pasi që organi përmbues të ia dërgojë kreditorit deklaratën e pasurive të debitorit. Megjithatë nëse kreditori kërkon aneks të deklaratës, siç përshkruhet në paragrafin 9 nenin 45 të këtij ligji, brenda afatit kohor të lejuar, koha e lejuar për përmbueshmëri të propozimit të ndryshuar për përmbueshmëri llogaritet nga data në të cilën shtojca e dorëzuar nga debitori i dërgohet kreditorit.

#### **Neni 39**

##### **Përmbueshmëri ndaj debitorit me përgjegjësi solidarë**

1. Në qoftë se në bazë të dokumentit përmbueshmëri dy apo më tepër debitor janë përgjegjës solidarë, organi përmbues, kundër tyre do të nxjerrë vetëm një aktvendim për përmbueshmërinë, me të cilin bëhet sekuestrimi i llogarisë së debitorëve në shumën e caktuar me anë të aktvendimit apo urdhrin për përmbueshmërinë.

2. Propozuesi mund ta caktojë në propozimin për përmbartim radhën e debitorëve sipas të cilës do të bëhet marrja e mjeteve nga debitorët, e në qoftë se ai nuk e ka bërë këtë, marrja e mjeteve do të bëhet sipas asaj radhe që janë përmendur debitorët në propozimin për përmbartim.

3. Nëse në rastin nga paragrafi 2. i këtij neni nuk ka mjete të mjaftueshme në xhirollogarinë e debitorit për përmbushjen e detyrimit, organi përmbartues do të aplikojë vendimin përmbartues kundër pasurisë së debitorit tjetër solidar. Nëse është e nevojshme për arsye të juridiksionit që të dërgohet rasti në organin përmbartues tjetër, organi përmbartues do ta bëjë këtë me shpejtësi me një raport për nivelin e përmbartimit të përfunduar gjer në atë moment.

#### **Neni 40**

##### **Propozimi në bazë të dokumentit të besueshëm**

1. Propozimi për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë:

1.1. kërkesën përmbartimore nga paragrafi 1. i nenit 38 të këtij ligji;

1.2. kërkesën që organi përmbartues ta detyrojë debitorin e përmbartimit që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, kurse në kontestet nga raportet ku ekziston kambiali dhe çeku brenda afatit prej tre (3) ditësh, nga dita në të cilën i dorëzohet aktvendimi ta përmbushë detyrimin bashkë me shpenzimet e caktuara;

1.3. origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit të besueshëm.

2. Nëse propozimi për përmbartim dorëzohet pa dokumentet nga paragrafi 1. i këtij neni, ato hidhen poshtë nga Gjykata apo përmbartuesi privat.

#### **Neni 41**

##### **Përmbartimi në sendet e luajtshme**

Kur propozohet përmbartimi në sendet e luajtshme, në propozimin për përmbartim nuk ka nevojë që më për së afërmi të tregohen sendet e tilla.

#### **Neni 42**

##### **Tërheqja dhe kufizimi i propozimit**

1. Propozimi për përmbartim mund të tërhiqet tërësisht apo pjesërisht nga kreditori gjatë zhvillimit të procedurës përmbartimore pa pëlqimin e debitorit.

2. Në rast të tërheqjes së propozimit për përmbartim organi përmbartues e përfundon përmbartimin në tërësi apo pjesërisht, varësisht nga ajo se a është tërhequr ai në tërësi apo vetëm pjesërisht.

3. Propozimi për përmbartim i tërhequr plotësisht apo pjesërisht mund të paraqitet përsëri në organin përmbartimor.

4. Nëse kreditori deklaron se kërkesa është zgjidhur me ujdi plotësisht apo pjesërisht, konsiderohet se propozimi për kryerjen e përmbartimit është tërhequr për atë pjesë.

#### **Neni 43**

##### **Aktvendimi për përmbartim dhe urdhri për përmbartim**

1. Në aktvendimin për përmbartim dhe urdhrin për përmbartim në bazë të titullit përmbartues duhet të tregohet dokumenti përmbartues, kreditori dhe debitori i përmbartimit, kredia që duhet të realizohet, mjete dhe objekti i përmbartimit, si dhe të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e përmbartimit.

2. Në aktvendimin për përmbartim dhe urdhrin për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm, duhet të tregohet dokumenti i besueshëm në bazë të së cilit urdhërohet përmbartimi, kreditori dhe debitori, kredia që duhet të realizohet, mjete dhe objekti i përmbartimit, urdhri për debitorin për të zgjidhur kredinë dhe kostot tjera brenda afatit shtatë (7) ditor dhe në kontestet në lidhje me kambialin

apo çekun, brenda afatit tre (3) ditor, dhe të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e përbarimit. Vendimi për përbarim apo urdhri për përbarim urdhërojnë përbarimin në pronën e debitorit që është e përshtatshme për objektin e përbarimit, dhe të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e përbarimit.

3. Në qoftë se me anë të aktvendimit për përbarim apo urdhrin për përbarim është caktuar pagimi i kamatave, atëherë llogaritjen e tyre, me shpenzime të kreditorit të përbarimit, e bënë organi përbarues, përpos kur realizimi i kamatave duhet të bëhet nga paratë e depozituara në llogarinë bankare.

4. Përbaruesit privat nxjerrin urdhrin për përbarueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përbushin kushtet për përbarueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përbarueshmërisë së nxjerrë nga përbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përbarim nga përbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim.

#### **Neni 44**

##### **Pjesët përbërëse të aktvendimit për përbarimin dhe urdhrin për përbarim**

1. Aktvendimi për përbarimin apo urdhri për përbarim nuk duhet ta ketë domosdo pjesën arsyetuese. Ky aktvendim apo urdhër mund të nxjerrët edhe duke u vënë vula katrore në propozimin për përbarim.

2. Aktvendimi për përbarimin apo urdhri për përbarim duhet ta përmbajë udhëzimin për mjetin e goditjes të cilin palët kanë të drejtë ta përdorin kundër tij.

3. Aktvendimi me të cilin propozimi për përbarim tërësisht ose pjesërisht refuzohet apo hedhet poshtë, domosdo duhet ta ketë arsyetimin.

#### **Neni 45**

##### **Deklarimi i pasurisë**

1. Kreditori në propozimin e tij që bazohet në dokumentin përbarues mund të kërkojë nga organi përbarues që të urdhërojë debitorin dhe çdo person tjetër të rëndësishëm për procesin e përbarimit të përmendur në propozim, përfshirë organet apo shërbimet administrative, apo institucionet tjera që të sigurojnë të dhëna rreth pasurisë apo të ardhurave të debitorit, në pajtim me këto dispozita.

2. Kërkesa mund të parashtrohet në çdo kohë gjatë tërë përbarimit gjer në përfundimin e tij.

3. Organi përbarues lidhur me kërkesën nga paragrafi 1. i këtij neni vepron si vijon:

3.1. brenda pesë (5) ditëve pas kërkesës nga paragrafi 1. apo 2. i këtij neni, nxjerrë aktvendim që detyron debitorin, apo përfaqësuesin e caktuar të debitorit, nëse është emëruar ai, për të treguar të gjitha të dhënat për pronën e luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, dhe në veçanti në lidhje me llojin dhe nivelin e të hyrave dhe depozitave në të holla, si dhe vendin ku ndodhet pasuria e këtillë. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë e veçantë;

3.2. organi përbarues i dërgon një kopje të kësaj kërkesë debitorit së bashku me aktvendimin, brenda afatit prej tre (3) ditësh nga dita e marrjes së vendimit. Organi përbarues gjithashtu i dërgon debitorit njoftimin se çfarë duhet të përmbajë deklarata e pasurisë dhe të ardhurave, si dhe e paralajmëron debitorin se ai do të sillet me dhunë për të dhënë deklaratën para Gjykatës. Debitori mund të gjobitet nëse refuzon të sigurojë deklaratën siç është urdhëruar nga autoriteti përbarues, si dhe i tërhiqet vërejtja për pasojat e të dhënave false dhe jo të plota në deklaratë;

3.3. kur debitori është person juridik, veprimet e referuara në nënparagrafët 3.1. dhe 3.2. të këtij paragrafi ndërmerren kundër personit të autorizuar që përfaqëson atë entitet sipas ligjit. Kur debitori ka mungesë të aftësisë për veprim, këto veprime ndërmerren kundër

përfaqësuesit të tij ligjor. Nëse autoriteti përmbaues konsideron se përfaqësuesi është duke vepruar kundër interesave të debitorit, ai njofton organin e kujdestarisë.

4. Organi përmbaues mund të urdhërojë dorëzimin e formularit të plotësuar dhe të nënshkruar te organi përmbaues brenda afatit të caktuar kohor, dhe ky formular bëhet pjesë zyrtare e shkresave të lëndës. Organi përmbaues mund të urdhërojë debitorin që të paraqitet para organit përmbaues që të jep deklaratën e pasurive, e cila deklaratë bëhet pjesë zyrtare e shkresave të lëndës.

5. Personat që nuk veprojnë sipas urdhërësës së organit përmbaues mund të gjobiten në mënyrën e paraparë në nenin 15 dhe 16 të këtij ligji. Këto dispozita zbatohen edhe për personat përgjegjës të personit juridik apo organit administrativ, shërbimit administrativ dhe në institucionin tjetër.

6. Personi fizik apo personi përgjegjës i përmendur në paragrafi 5. të këtij neni, përgjigjet edhe penalisht për dhënien e deklaratës së rreme, po qe se jep të dhëna jo të plota ose të pasakta lidhur me pasurinë e debitorit. Për këtë pasojë autoriteti përmbaues duhet ta paralajmërojë subjektin përkatës me anë të konkluzionit me të cilin nga ai kërkohen të dhënat në fjalë.

7. Organi përmbaues mundet të kërkojë plotësimin e formularit përkatës nga debitori që është person fizik, apo nga personi tjetër fizik, apo mund të kërkojë deklaratën verbale në seancë gjyqësore. Po qe se personi i ftuar nuk vjen në seancë apo refuzon të jep deklaratë verbale, organi përmbaues i zbaton dispozitat e paragrafit 5. të këtij neni. Një kopje e vërtetuar e deklaratës së pasurisë apo regjistrave të organit përmbaues që përmbajnë atë deklaratë i dërgohet nga organi përmbaues kreditorit menjëherë. Një deklaratë që tregon datën kur ajo kopje është dërguar kreditorit i bashkëngjitet aktvendimit të Gjykatës nën paragrafin 3.3 të paragrafit 3. të këtij neni, së bashku me deklaratën e pasurisë, dhe futet në dosje të organit përmbaues për atë rast për të cilin është kërkuar deklarata e pasurisë.

8. Organi përmbaues sipas detyrës zyrtare apo me propozim të kreditorit brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i deklaratës së pasurisë mund të kërkojë një shtojcë të deklaratës, nëse ajo deklaratë nuk përmban të dhënat e mjaftueshme për të identifikuar pasuritë e dhëna aty, apo nëse një titull publik apo statusor i vërtetuar mund të përdoret për të dëshmuar se debitori ka komunikuar të dhëna jo komplete dhe të pasakta dhe dëshmon se pasuritë e njohura të debitorit nuk mund të përdoren për të përmbushur plotësisht këtë kërkesë. Nëse debitori nuk i paraqet dokumentet në afatin e caktuar në këtë paragraf, i nënshtrohet gjobave sipas neneve 15 dhe 16 të këtij ligji.

9. Nga kreditori që nuk ka kërkuar shtojcën e deklaratës që përmendet në paragrafin 8. të këtij neni më sipër kërkohet që të propozojë mjetet dhe objektet e përmbaimit brenda dhjetë (10) ditëve pas marrjes së deklaratës së pasurisë apo përmbaimit mund të pezullohet sipas detyrës zyrtare nga Gjykata.

#### **Neni 46 Përmbajtja e deklaramit të pasurisë**

1. Deklarata për pasurinë e debitorit përmban:

1.1. të dhënat për pasuritë dhe të drejtat e debitorit që mund të përmbaohen, në veçanti:

1.1.1. pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme pronë të debitorit;

1.1.2. të hollat në posedim të debitorit në kohën e dhënies së deklaratës;

1.1.3. depozitat e të hollave të debitorit përmbaues në cilindo bankë apo institucion tjetër financiar, në Republikën e Kosovës apo ndonjë vend tjetër;

1.1.4. xhirollogaritë e tjera të parave të gatshme, ose ato të cilat nuk kanë të bëjnë me para të gatshme të debitorit përmbaues;

1.1.5. të drejtat për letra me vlerë dhe të drejtat që rrjedhin nga letrat me vlerë;

1.1.6. të drejtat e themeluesit në kompani dhe të hyrat që kanë rrjedhur nga ato të drejta gjatë viteve të fundit;



1.1.7. paga mesatare mujore e debitorit gjatë gjashtë (6) muajve të fundit, emri i punëdhënësit dhe kohëzgjatja dhe lloji i punësimit;

1.1.8. të hyrat e debitorit, baza për të hyrat e tilla, afatet e këtyre të hyrave;

1.1.9. kamata e letrave me vlerë që mbahen nga debitori dhe kamatat e letrave me vlerë që mbahen nga të tjerët nga pasuritë e debitorit;

1.2. të dhënat për kërkesat kundër debitorit të cilave i ka kaluar afati apo që do t'i vjen afati gjatë vitit të ardhshëm dhe të dhënat për letrat me vlerë të kërkesave të tilla;

1.3. të dhënat për procedurën e përmbaramit në vazhdim e sipër kundër debitorit, përfshirë kërkesat që kanë të bëjnë me mbledhjen e taksave dhe tatimeve që duhet paguar ndonjë autoriteti qeveritar brenda Republikës së Kosovës apo ndonjë qeverie të huaj;

1.4 të dhënat për transaksionet ligjore të ndërmarra nga debitori dhe përfshirja e pasurisë së debitorit pas vendosjes së përgjegjësisë se përmbarami është duke u vendosur (transferimet e të drejtave të pronës me apo pa kompensim, pengjet, sigurimi i sigurisë për vete apo në emër të personave të tjerë);

1.5. adresa e tashme e debitorit apo vendi i afarizmit;

1.6. adresat ku gjenden pasuritë e luajtshme të debitorit;

1.7. të dhënat nga librat kadastral dhe librat tjerë publik për pronën e paluajtshme të debitorit, apo të dhënat në bazën dhe mënyrën e përvetësimit nëse prona e paluajtshme nuk është futur në librat kadastral apo librat tjerë publik;

1.8. të dhënat për llogaritë rrjedhëse apo të kursimeve, depozitat bankare dhe bankat ku mbahen ato llogari, përfshirë numrat e llogarive dhe depozitave;

1.9. të dhënat për palët e treta që janë përfitues të transaksioneve ligjore që përfshijnë pasuritë e debitorit dhe llojin e transaksionit të kryer;

1.10. nënshkrimi i debitorit i vërtetuar nga noteri përveç nëse deklarata jepet para Gjykatës dhe futet në regjistrat e Gjykatës.

2. Kur debitori nuk ka në pronësi kurrfarë prone që mund të përmbarohet, nga ai kërkohet që këtë ta deklarojë shprehimisht në deklaratën e tij.

3. Nëse të dhënat nga deklarata e pasurive apo dokumentet e specifikuar në paragrafin 8 nenin 45. të këtij ligji janë të pamjaftueshme për të përcaktuar pasurinë e debitorit, atëherë organi përmbarues sipas detyrës zyrtare apo me propozim të kreditorit mund të kërkojë që të jepet dëshmia e familjarëve të debitorit apo partnerëve të tij afarist lidhur me vendndodhjen dhe llojin e këtyre pasurive.

4. Organi përmbarues mund të kontestojë të dhënat për pasurinë e debitorit nëse ka arsye dyshimi se përmes veprimeve të tij, debitori ka mashtruar apo ka tentuar të mashtrtojë kreditorin në lidhje me përmbushjen e detyrimit të tij. Organi përmbarues duhet të njoftojë prokurorinë përkatëse lidhur me këtë çështje.

5. Të gjitha institucionet qeverisëse si dhe agjencitë e qeverisë së Kosovës do të sigurojnë informatat e kërkuara nga organi përmbarues, me kërkesë të saj, përveç nëse agjencia e ka të ndaluar në mënyrë të veçantë dërgimin e atyre informatave sipas dispozitave të ndonjë ligji tjetër. Informatat e tilla i sigurohen organit përmbarues pa pagesë.

6. Kreditori mund të kërkojë nga organi përmbarues që të ndihmojë në identifikimin e pasurive të përshkruara nën këtë nen.

## **Neni 47**

### **Dorëzimi i aktvendimit për përmbarrimin dhe urdhri për përmbarrim**

1. Për dorëzimin e aktvendimit për përmbarrim apo urdhrit për përmbarrim zbatohet neni 18 i këtij ligji.
2. Aktvendimi për përmbarrimin apo urdhri për përmbarrim i dërgohet kreditorit dhe debitorit apo përfaqësuesve të tyre. Aktvendimi me të cilin hedhet poshtë apo refuzohet propozimi për përmbarrim i dërgohet vetëm kreditorit.
3. Në qoftë se kreditori për realizimin e kredisë së tij e propozon përmbarrimin për pasurinë në të cilën debitori e ka të drejtën e bashkëpronësisë ose të pronësisë së përbashkët, organi përmbarrues për aktvendimin e dhënë i njofton të gjithë bashkëpronarët, respektivisht titullarët e së drejtës së pronësisë së përbashkët.
4. Aktvendimi për përmbarrimin apo urdhri për përmbarrim mbi kredinë në të holla të debitorit i dërgohet edhe debitorit të debitorit, kurse aktvendimi për përmbarrimin apo urdhri për përmbarrim për mjetet në llogarinë rrjedhëse të debitorit i dërgohet edhe bankës.
5. Aktvendimi për përmbarrimin apo urdhri për përmbarrim në llogari bankare i dërgohet bankës pasi që të bëhet i formës së prerë, përveçse kur përmbarrimi është caktuar në bazë të kambialit dhe çekut me protestë dhe faturë kthyese, po qe se janë të nevojshme për themelimin e kredisë.
6. Aktvendimi për përmbarrimin apo urdhri për përmbarrim i dhënë në bazë të kambialit dhe çekut u dërgohet palëve menjëherë pas nxjerrjes, me qëllim të sekuestrimit të mjeteve në llogarinë rrjedhëse të debitorit.
7. Aktvendimi për përmbarrimin apo urdhri për përmbarrim për sendet e luajtshme i dorëzohet debitorit me rastin e kryerjes së veprimet të parë përmbarrimorë. Po qe se sendi i luajshëm nuk ndodhet në posedimin e debitorit, atëherë vendimi apo urdhri i dorëzohet edhe personit të cili ndodhet sendi i tillë.
8. Aktvendimi për përmbarrim apo urdhri për përmbarrim për sendet e paluajtshme i dërgohet debitorit dhe kadastrës në territorin ku gjendet prona për regjistrimin e të drejtave në paluajtshmëri. Po qe se prona e paluajtshme nuk ndodhet në posedimin e debitorit, atëherë aktvendimi i dorëzohet edhe personit në posedim të pronës së paluajtshme.

## **KREU V**

### **ZBATIMI I PËRMBARRIMIT**

## **Neni 48**

### **Përmbarrimi në bazë të aktvendimit të formës jo të prerë**

1. Përmbarrimi zbatohet edhe para se aktvendimi për përmbarrimin apo urdhri për përmbarrim të bëhet i formës së prerë, në qoftë se për veprimet e caktuara përmbarrimore nuk është paraparë diçka tjetër.
2. Përmbarrimi i caktuar në bazë të dokumentit të besueshëm nuk mund të kryhet para se të ketë marrë formë të prerë aktvendimi për përmbarrimin apo urdhri për përmbarrim.

## **Neni 49**

### **Kufijtë e përmbarrimit**

Përmbarrimi kryhet brenda kufijve të caktuar në aktvendimin për përmbarrimin apo urdhrin për përmbarrim.

## **Neni 50**

### **Koha e përmbarrimit**

1. Përmbartimi kryhet në ditët në të cilat punohet dhe atë gjatë ditës në kohën midis orës 07 - 20.
2. Organi përmbartues mund të vendosë me anë të konkluzionit që përmbartimi të bëhet në ditët kur nuk punohet apo gjatë natës, vetëm kur për një gjë të tillë ekzistojnë shkaqe të justifikueshme.

### **Neni 51** **Veprimet e organit përmbartues**

1. Me rastin e kryerjes së veprimeve përmbartimore në banesën e debitorit, në të cilën nuk është i pranishëm debitori, përfaqësuesi ligjor apo me prokurë i tij, apo personi i moshës madhore i familjes së tij, domosdo duhet të jenë të pranishëm së paku dy (2) qytetar të moshës madhore.
2. Përmbartimi në lokalit afarist apo në lokalit tjetër të personit juridik bëhet gjatë orarit të punës dhe në prani të personit të cilin e cakton organi kompetent i personit juridik, e kur ky i fundit nuk e cakton personin e tillë, veprimet përmbartimore kryhen në praninë e së paku dy (2) qytetarë të moshës madhore.
3. Kur veprimi përmbartimor duhet të kryhet në lokalit që është i mbyllur, kurse debitori nuk është i pranishëm ose nuk pajtohet që ta hapë lokalit vet, atëherë organi përmbartues do ta hapë lokalit në praninë e një (1) qytetari të moshës madhore dhe policisë.
4. Gjatë kryerjes së veprimeve përmbartimore sipas dispozitave të paragrafit 1., 2., dhe 3. të këtij neni, organi përmbartues duhet të përpilojë procesverbal të posaçëm të cilin do ta në nënshkruajnë qytetarët e pranishëm, kurse një kopje e tij ose njoftimi për veprimin përmbartimor të kryer, do të afishohet në derën e banesës apo të lokalit afarist.

### **Neni 52** **Parregullsitë me rastin e kryerjes së përmbartimit**

1. Pala ose pjesëmarrësi tjetër i procedurës mund të kërkojë nga Gjykata me anë të parashtresës që t'i eliminoj parregullsitë e bëra nga organi përmbartues gjatë kryerjes së veprimeve përmbartimore. Kjo kërkesë i bëhet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve nga dita e ndodhjes së parregullsisë së pretenduar.
2. Sipas kërkesës nga paragrafi 1. i këtij neni, po qe se parashtresuesi e ka propozuar këtë, Gjykata nxjerrë aktvendim brenda tre (3) ditësh nga dita e dorëzimit të parashtresës.

### **Neni 53** **Pengimi i organit përmbartues në kryerjen e punës së tij**

1. Organi përmbartues është i autorizuar ta largoj personin nga vendi në të cilin kryhen veprimet e përmbartimore, po qe se ai e pengon kryerjen e tyre.
2. Me rastin e kryerjes së veprimeve të dhunshme të parapara me këtë ligj, dhuna dhe forca e përdorur duhet të jenë në proporcion me rrethanat e rastit konkret.
3. Gjatë procedurës së përmbartimit organet e policisë kanë për detyrë që organit përmbartues t'i japin ndihmën e duhur për kryerjen e veprimeve të përmbartimit. Organi përmbartues, në rast nevojë mund ta urdhërojë marrjen e masave përkatëse ndaj personit që e pengon kryerjen e veprimeve të përmbartimit.
4. Me rastin e veprimit të organeve të policisë sipas urdhrat të organit përmbartues, përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e ligjit për punët e brendshme respektivisht të policisë.
5. Në rast se policia nuk i zbaton urdhrat e organit përmbartues për dhënien e ndihmës gjatë kryerjes së përmbartimit, organi përmbartues ka për detyrë që menjëherë ta njoftojë për një gjë të tillë organin kompetent.

## **KREU VI**

### **PROCEDURA E KUNDËRPËRMBARIMIT**

#### **Neni 54**

#### **Shkaqet për kundër përmbarim**

1. Debitori ka të drejtë që në të njëjtën procedurë përmbarimore edhe pasi të ketë përfunduar përmbarimi, të kërkojë nga Gjykata nxjerrjen e aktvendimit me të cilin i urdhërohet kreditori që t'ia kthejë atë që e ka marrë në bazë të procedurës së përmbarimit, në qoftë se:

1.1. dokumenti përmbarues me anë të vendimit të formës së prerë është prishur, ndryshuar, anuluar, shfuqizuar, ose në ndonjë mënyrë tjetër është konstatuar se është i pa efekt juridik;

1.2. aktvendimi apo urdhri për përmbarim me anë të vendimit të formës së prerë është anuluar apo ndryshuar;

1.3. gjatë kryerjes së procedurave përmbaruese, kreditori ka marrë më shumë sesa vlera e kredisë, përfshirë kostot e përmbarimit dhe kamatat;

1.4. përmbarimi i kryer në një objekt specifik të përmbarimit është i palejuar.

2. Në qoftë se kreditori me anë të përmbarimit e ka realizuar një shumë të hollash, debitori në propozimin për kundër përmbarim mund të kërkojë pagimin e kamatëvonesës që nga dita e pagimit të shumës së tillë.

3. Propozimi për kundër përmbarim nga paragrafi 1. i këtij neni mund të paraqitet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita në të cilën debitori ka marrë dijani për shkakun e kundër përmbarimit por jo më vonë se një (1) vit nga dita e përfundimit të procedurës përmbarimore.

4. Pas skadimit të afatit nga paragrafi 3. i këtij neni, debitori nuk mund të fillojë kundër përmbarimin, por duhet të fillojë procedurën kontestimore për kërkesën e tij.

#### **Neni 55**

#### **Procedura sipas propozimit për kundër përmbarim**

1. Propozimin për kundër përmbarim Gjykata ia dërgon kreditori dhe kërkon nga ai që brenda afatit prej tre (3) ditësh nga dita e dorëzimit të deklarohet lidhur me propozimin e tillë.

2. Nëse procedura e përmbarimit kryhet para përmbaruesit privat, përmbaruesi privat, pa vonesë dërgon një kopje të dosjes te Gjykata kompetente dhe njofton palët se procedura sa i përket propozimit për kundër përmbarim vazhdon para Gjykatës kompetente.

3. Po qe se brenda afatit nga paragrafi 1. i këtij neni, kreditori e kundërshton propozimin për kundër përmbarim, atëherë Gjykata për të vendosë pas mbajtjes së seancës gjyqësore.

4. Me aktvendimin me të cilin miratohet propozimi për kundër përmbarim Gjykata e urdhëron kreditorin që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh t'ia kthejë debitorit, respektivisht personit të tretë atë që e ka marrë me anë të përmbarimit.

5. Aktvendim të këtyllë Gjykata nxjerrë edhe po qe se kreditori i përmbarimit nuk deklarohet fare brenda afatit të caktuar, ose kur deklarohet se nuk e kundërshton propozimin për kundër përmbarim.

#### **Neni 56**

#### **Aktvendimi për kundër përmbarimin**

1. Në bazë të aktvendimit të formës së prerë me të cilin aprovohet propozimi për kundër përbarim, Gjykata sipas propozimit të debitorit do të caktojë me aktvendim të posaçëm mjetet dhe objektet për zbatimin e kundër përbarimit.

2. Në procedurën e mëtejme të kundër përbarimit në mënyrë të përshtatur do të zbatohen dispozitat e këtij ligji sipas të cilave kryhet përbarimi.

#### **Neni 57** **Pamundësia e kundër përbarimit**

Propozimi për kundër përbarim nuk do të pranohet po qe se me të kërkohet kthimi i sendit lidhur me të cilin kanë ndodhur ndryshime të atilla materiale apo juridike të cilat e bëjnë të pamundur kthimin e tij.

#### **Neni 58** **Kundër përbarimi sipas propozimit të personit të tretë**

1. Personi nga pasuria e të cilit është realizuar kredia e kreditorit, e i cili nuk ka qenë i cilësuar si debitor në aktvendimin për përbarimin, ka të drejtë që brenda afateve të përmendura në paragrafin 3. të nenit 54 të këtij ligji, të kërkojë nga Gjykata që ta urdhërojë kreditorin që t'ia kthejë gjithë atë që i është dhënë me anë të përbarimit të përfunduar.

2. Në bazë të propozimit të personit të tretë nga paragrafi 1. i këtij neni zhvillohet procedura e kundër përbarimit sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Në këtë procedurë të kundër përbarimit propozuesi quhet kreditori i përbarimit, kurse kundërshtari i propozuesit quhet debitor.

#### **Neni 59** **Kundër përbarimi sipas propozimit të pjesëmarrësit në përbarim**

1. Pjesëmarrësi në procedurën përbarimore ka të drejtë që brenda afateve të përmendura në këtë pjesë të ligjit, pasi të ndryshohet me anë të vendimit të formës së prerë aktvendimi për përbarimin të kërkojë nga Gjykata që ta urdhërojë personin të cilit i është paguar shuma e caktuar e të hollave, që shuma e tillë t'i kthehet atij.

2. Në bazë të propozimit nga paragrafi 1. i këtij neni, zbatohet procedura e kundër përbarimit sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Në procedurën e kundër përbarimit të këtillë propozuesi quhet kreditor, kurse kundërshtari i propozuesit quhet debitor.

### **KREU VII**

#### **SHTYRJA, PEZULLIMI DHE PËRFUNDIMI I PËRMBARIMIT**

#### **Neni 60** **Shtyrja e përbarimit sipas kërkesës së kreditorit**

1. Po qe se me ligj nuk është paraparë ndryshe, organi përbarues mund të shtyjë pjesërisht apo tërësisht përbarimin sipas kërkesës së kreditorit, por vetëm në qoftë se ende nuk ka filluar të zbatohet aktvendimi për përbarimin apo urdhri për përbarim.

2. Po qe se në procedurën e përbarimit marrin pjesë më tepër kreditor e vetëm ndonjëri nga ta e kërkon shtyrjen, atëherë organi përbarues e shtyn përbarimin vetëm për aq sa i përket kreditorit të tillë.

3. Organi përmbaues vendos për kërkesën për shtyrje me konkluzë.

### **Neni 61**

#### **Shtyrja e përmbaimit sipas kërkesës së debitorit**

1. Në qoftë se debitori argumenton se zbatimi do t'i shkaktojë atij dëm të pariparueshëm, organi përmbaues plotësisht ose pjesërisht do të shtyjë përmbaimit kur:

1.1. është parashtruar ankesë kundër dokumenti përmbaues dhe pala ankuese i demonstroi Gjykatës së shkallës së parë se ka mundësi bindëse për të qenë e suksesshme në ankesë, apo

1.2. Gjykatës i është parashtruar kërkesa për të anuluar një vendim të arbitrazhit në pajtim me Ligjin për Arbitrazhin.

2. Dorëzimi i kërkesës për shtyrje të përmbaimit nuk shtyn zbatimin e përmbaimit.

3. Para lejitimit të shtyrjes së përmbaimit, organi përmbaues do t'i sigurojë kreditorit të drejtën që të deklarohet në lidhje me të dhe të jep dëshmi në kundërshtim të shtyrjes.

4. Organi përmbaues mund plotësisht ose pjesërisht ta shtyjë përmbaimit në situata ku debitori dëshmon përmes dokumenteve publike ose të vërtetuara se përmbaimit do t'i shkaktojë dëm të pariparueshëm dhe jep si garanci shumë e cila së paku korrespondon me shumë e kërkesës.

5. Në rrethana të tjera përveç atyre të përcaktuara në paragrafin 2. të këtij neni, organi përmbaues mundet të kushtëzojë shtyrjen pasi që debitorit të jep si garanci shumë e cila së paku korrespondon me shumë e kërkesës dhe kamatës.

6. Në qoftë se organi përmbaues ka shtyrë përmbaimit e një kërkesë jomonetare me kusht të pagesës së një garancie, ajo përcakton shumë e garancisë në lidhje me të gjitha rrethanat e rastit.

7. Përveç nëse debitori deponon garancionin sipas paragrafit 4. dhe 5. të këtij neni brenda afatit kohor të përcaktuar nga organi përmbaues që kryen përmbaimit, ku afati që nuk tejkalon pesëmbëdhjetë (15) ditë, përndryshe konsiderohet se debitori ka hequr dorë nga kërkesa e tij për shtyrje.

8. Organi përmbaues vendos mbi një kërkesë për shtyrjen e përmbaimit brenda pesë (5) ditëve nga marrja e saj.

9. Rregulla për mbështetjen e kërkesës së debitorit për shtyrjen e përmbaimit dërgohet nga organi përmbaues për debitorit dhe kreditorit.

10. Kundër vendimit lidhur me kërkesën e debitorit nuk lejohet ankesa.

11. Gjykata e shkallës së parë që ka juridiksionin për të vendosur për ankesë kundër urdhrimit për përmbaimit, dhe Gjykata që kryen përmbaimit, mund të shtyjnë përmbaimit me kërkesë të debitorit që mund të mos obligohet që të deponojë pengun kur debitori merr pjesë në procedurë si palë, nëse përcakton gjasën se përmbaimit do t'i shkaktojnë dëmtim të pariparueshëm apo gati të pariparueshëm, apo nëse përcakton gjasën se shtyrja është e domosdoshme me qëllim të parandalimit të dhunës. Gjykata vendos për kërkesën për shtyrje të përmbaimit brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i kërkesës.

12. Nëse vendimi për shtyrje të përmbaimit është brenda juridiksionit të Gjykatës e cila nuk e kryen përmbaimit, Gjykata sipas detyrës zyrtare dërgon vendimin për vazhdimin e përmbaimit të përmbauesi privat.

### **Neni 62**

#### **Shtyrja e përmbaimit në bazë të kërkesës së palës së tretë**

1. Personi i tretë mund të parashtrojë kërkesë për shtyrjen e përbarimit nën kushtet e parapara me dispozitat e paragrafit 2. neni 61 të këtij ligji.

2. Vendimi i organit përbarues për të shtyrë përbarimin në baze të kërkesës së personit të tretë do të dërgohet kreditorit dhe debitorit.

#### **Neni 63**

##### **Koha për të cilën shtyhet përbarimi**

1. Organi përbarues mund të shtyjë përbarimin në bazë të nenit 61 dhe 62 të këtij ligji për kohën të cilën e vlerëson të arsyeshme duke i marrë parasysh rrethanat e rastit konkret, por jo më gjatë se gjashtë (6) muaj, përveç në rastet kur vlen paragrafi 3. i këtij neni.

2. Në qoftë se me ligj është paraparë afati brenda të cilit mund të propozohet përbarimi, atëherë shtyrja e tij nuk mund të bëhet përtej afatit të tillë.

3. Në rast se palët merren vesh për pagesën e kredisë në këste, atëherë kreditori njofton organin përbarues për këtë marrëveshje. Ky njoftim shtynë përbarimin gjer në atë kohë kur kreditori njofton organin përbarues se debitorit nuk respekton kushtet e marrëveshjes së tyre.

#### **Neni 64**

##### **Vazhdimi i procedurës së shtyrë**

Përbarimi i shtyrë mund të rifillojë me kërkesë të palës që ka kërkuar shtyrjen para skadimit të periudhës së shtyrjes. Në ato raste, pala tjetër njoftohet për rifillimin e procedurës përbarimore përmes dërgesës standarde me postë në adresën e fundit të regjistruar të asaj pale. Po që se kreditori nuk e kërkon vazhdimin e procedurës as pas pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e skadimit të afatit për të cilin është shtyrë përbarimi, atëherë organi përbarues do ta ndërpres procedurën e rastit të përbarimit me vendim.

#### **Neni 65**

##### **Pezullimi i procedurës së përbarimit**

1. Përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj, përbarimi pezullohet sipas detyrës zyrtare në këto rrethana:

1.1. kur debitorit apo pasuritë e tij nuk mund të gjenden për qëllime të njoftimit dhe sekuestrimit të pasurisë brenda tre (3) muajve nga fillimi i rastit të përbarimit, përkundër faktit se janë bërë së paku dy (2) tentime nga organin përbarues që të gjej atë person për qëllime të njoftimit apo sekuestrimit të pasurisë;

1.2. kur është tentuar nga organi përbarues që të zbatohet përbarimi i vendimit së paku dy (2) herë pa arritur asnjë rezultat të synuar nga këto veprime;

1.3. kur adresa e debitorit e dhënë në propozimin për përbarim vërtetohet se është e pasaktë ndërsa kreditori nuk mund të argumentojë para organit përbarues saktësinë e adresës.

2. Procedura e pezulluar me konkluzion nga paragrafi 1. i këtij neni mund të vazhdojë nëse kreditori në afatin prej gjashtë (6) muajsh paraqet informata të reja lidhur me çështjen e pezulluar, në të kundërtën procedura konsiderohet e përfunduar.

#### **Neni 66**

##### **Përfundimi i procedurës përbarimore**

1. Në qoftë se me këtë ligj nuk është paraparë ndryshe, përbarimi do të përfundojë sipas detyrës zyrtare në qoftë se dokumenti përbarimor është anuluar, ndryshuar, shfuqizuar, apo në ndonjë mënyrë tjetër është bërë i pa efekt, apo në qoftë se vërtetimi për përbarueshmërinë e tij anulohet me vendim të formës së prerë. Përbarimi do të mbarojë gjithashtu sipas detyrës zyrtare nëse një rast

është pezulluar dy (2) herë dhe për herë i plotëson kriteret për pezullim siç përcaktohet në paragrafin 1. neni 65. të këtij ligji.

2. Përmbartimi do të përfundohet sipas detyrës zyrtare edhe kur në pajtim me dispozitat ligjore me të cilat rregullohen marrëdhëniet detyimore, personi i tretë e përmbushë obligimin në dobi të kreditorit në vend të debitorit.

3. Përmbartimi do të përfundohet edhe kur ai është bërë i pamundshëm apo kur nga shkaqe të tjera nuk mund të zbatohet, si dhe pas kalimit të afatit absolut të parashkrimit për përmbartim.

4. Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbartimore.

## **KREU VIII**

### **MJETET JURIDIKE**

#### **Neni 67**

#### **Mjetet e rregullta juridike**

1. Në procedurën përmbartimore, mjetet e rregullta të goditjes janë:

1.1. Prapësimi dhe

1.2. Ankesa.

#### **Neni 68**

#### **Mjetet e jashtëzakonshme juridike**

1. Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbartimore.

2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimi dhe ankesës kundër vendimeve të përmbartueshëm për përmbartimin me dhunë.

#### **Neni 69**

#### **Prapësimi kundër vendimeve për përmbartim**

1. Prapësimi mund të paraqitet vetëm kundër vendimeve të organit përmbartues me të cilin përmbartimi është i lejuar.

2. Prapësimi duhet të paraqitet me shkrim, në Gjykatën themelore e cila ka lëshuar vendimin përmbartues kundër të cilit prapësimi është paraqitur kur organi përmbartues është Gjykata.

3. Prapësimi duhet të paraqitet me shkrim në Gjykatën themelore, siç është përcaktuar me paragrafin 5. të nenit 5 të këtij ligji kur organin përmbartues është përmbartuesi privat.

4. Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet.

5. Prapësimi kundër vendimit përmbartues ose urdhrit përmbartues mund të paraqitet ekskluzivisht sipas dispozitave të nenit 71 të këtij ligji.

6. Prapësimi do të përmbaj të dhënat e vendimit përmbartimor kundër të cilit është bërë ankesa, arsyet e prapësimi dhe nënshkrimin e debitorit.

7. Vendimi me të cilin refuzohet propozimi për përmbartim mund të goditet vetëm me ankesë të kreditorit të përmbartimit në pajtim me nenin 77 të këtij ligji.



**Neni 70**  
**Afatet ligjore për paraqitjen e prapësimit**

Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrit përmbarues.

**Neni 71**  
**Shkaqet e prapësimit**

1. Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse:

1.1. dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmerisë;

1.2. dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur, anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik;

1.3. palët, përmes dokumentit publik ose dokumentit të certifikuar në pajtim me ligjin, të hartuar pas krijimit të dokumentit përmbarues, janë pajtuar që të mos e kërkojnë përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues për një periudhë kohore të kufizuar ose përgjithmonë;

1.4. ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përmbarimi;

1.5. përmbarimi është caktuar për sendet të cilat janë të përjashtuara nga përmbarimi i detyrueshëm dhe, si rezultat i këtij përjashtimi, mundësit për kryerjen e përmbarimit janë të kufizuara;

1.6. kreditori nuk është i autorizuar të kërkojë përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përmbarimin kundër debitorit;

1.7. kushti i përcaktuar në dokumentin përmbarues nuk është përmbushur, përveç nëse parashikohet ndryshe me ligj;

1.8. kredia është shuar si rezultat i ndonjë fakti të shfaqur në kohën kur debitori me nuk ka mundur të paraqes faktin e tillë gjatë procedurës nga e cila ka derivuar vendimi, pas përmbylljes së një ujdje gjyqësore ose një ujdje administrative ose në ndonjë mënyrë tjetër;

1.9. realizimi i kredisë është shtyrë, ndaluar, ndryshuar ose parandaluar në ndonjë mënyrë tjetër, në mënyrë të përhershme ose për një periudhë të kufizuar kohore, si rezultat i ndonjë ngjarje që ka ndodhur në kohën kur debitori më nuk mund ta bënte të njohur në procedurë në të cilën është nxjerr vendimi, respektivisht kredia është shuar pas lidhjes së një ujdje në Gjykatë ose në organin administrativ;

1.10. kërkesa nga dokumenti përmbarues është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve;

1.11. Gjykata që ka marr vendimin për përmbarim nuk është kompetente;

1.12. përmbaruesi që ka lëshuar urdhrin për përmbarim nuk është kompetent.

**Neni 72**  
**Përgjigjja lidhur me prapësimin**

1. Prapësimin kundër vendimit për përmbarim Gjykata ia dërgon palës kundërshtare në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e dorëzimit të prapësimit.

2. Gjykata u dërgon deklaratën e prapësimit dhe provat mbështetëse palës kundërshtare dhe të gjitha palëve tjera në procedurën e përbarimit në një afat prej tre (3) ditësh, nga dita e pranimit të prapësimit. Në rastet kur prapësimi bëhet kundër veprimit të përbaruesit privat, Gjykata gjithashtu i dërgon deklaratën e prapësimit dhe provat mbështetëse përbaruesit privat.

3. Përgjigjet lidhur me prapësimin duhet të paraqiten me shkrim brenda afatit prej tre (3) ditësh, nga dita e pranimit të prapësimit nga palët.

### **Neni 73** **Vendosja sipas prapësimit**

1. Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përjashtimisht Gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit. Gjykata do të njoftojë të gjitha palët për dëgjimin publik. Nëse Gjykata vendos të mbajë seancë dëgjimore publike, seanca dëgjimore do të mbahet brenda pes (5) ditëve, kur kërkohet që përgjigjet ndaj prapësimit të pranohet nga Gjykata.

2. Vendimi për prapësim nxirret nga një gjyqtar i vetëm.

3. Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar.

### **Neni 74** **Forma e prerë dhe përbarueshmeria e vendimeve në procedurën e përbarimit**

1. Vendimi kundër të cilit nuk është paraqitur brenda afatit ligjor prapësimi, bëhet i formës së prerë dhe i përbarueshem.

2. Vendimi kundër të cilit është refuzuar prapësimi bëhet i përbarueshem, e po që se kundër tij nuk lejohet ankesa, ai bëhet i formës së prerë.

3. Vendimi me të cilin refuzohet prapësimi bëhet i formës së prerë, po që se kundër tij nuk paraqitet ankesë brenda afatit ligjor, ose në qoftë se ankesa refuzohet si e pathemeltë.

### **Neni 75** **Prezumimi për paraqitjen e prapësimit nga pala e tretë**

1. Një person tjetër nga debitori që pretendon se ka të drejtën lidhur me objektin e përbarimit që nuk është në pajtim me përbarimin e atij objekti mund ta paraqes prapësimin kundër përbarimit, me kërkesë që përbarimi për objektin e përbarimit të shpallet i palejueshëm në pjesën me të cilën është përfshirë e drejta e tij.

2. Prapësimi mund të paraqitet deri në përfundimin e procedurës përbarimore.

3. Prapësimi i paraqitur nga pala e tretë nuk e pengon kryerjen e përbarimit dhe realizimin e kredisë së propozuesit të përbarimit, përveçse kur me këtë ligj është parashikuar ndryshe.

4. Prapësimin e personit të tretë Gjykata ia dërgon propozuesit të përbarimit dhe debitorit, me kërkesë që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh të deklarohen lidhur me të.

### **Neni 76** **Vendimet e Gjykatës lidhur me prapësimin e personit të tretë**

1. Për prapësimin e personit të tretë Gjykata që ka caktuar përbarimin do të vendosë në procedurë përbarimore, ose parashtruesin e prapësimit me anë të konkluzionit do ta udhëzojë që të drejtën e pretenduar ta realizojë me anë të padis në procedurë kontestimore.

2. Kur përbarimi është zbatuar nëpërmjet Gjykatës, Gjykata që ka lëshuar titullin ekzekutiv ose aktgjykimin do të vendosë për prapësimin nëse përbarimi i tyre atakohet.

3. Ku përmbartimi është zbatuar nga përmbartuesi privat, Gjykata me juridiksionin përkatës siç është përcaktuar në paragrafin 5. neni 5 të këtij ligji do të vendosë për prapësimin.
4. Gjykata do të vendosë për prapësimin e personit të tretë në procedurë të përmbartimit sa herë që një gjë të tillë e lejojnë rrethanat e rastit konkret, e sidomos kur parashtruesi i prapësimi e provon themelësinë e prapësimi të tij me anë të aktgjykimit të formës së prerë, me anë të dokumentit publik, ose me anë të dokumentit jo-publik të certifikuar sipas ligjit.
5. Prapësimi nuk do ta shtyj procedurën përmbartimore në rastin konkret.
6. Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Gjykatën e shkallës së dytë në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, përmes Gjykatës së shkallës së parë.
7. Ankesa e paraqitur i dërgohet për përgjigje palës kundërshtuese, e cila në afat prej tre (3) ditësh mund të paraqes po në këtë Gjykatë përgjigje në ankesë.
8. Pala që ka paraqitur prapësimin gjithashtu mund të nisë procedurë kontestimore pas skadimit të afatit të caktuar nga Gjykata deri në momentin e përfundimit të procedurës përmbartimore sidoqoftë, në këtë rast pala që ka parashtruar prapësimin do i bartë shpenzimet për tejkallim të afatit kohor.
9. Personi i tretë në procedurë kontestimore sipas paragrafit 1. të këtij neni mund të kërkojë nga Gjykata rivendosjen e të drejtave të tij, nëse ndonjëra palë konteston këto të drejta.

#### **Neni 77**

#### **Ankesa kundër vendimit lidhur me prapësimin**

1. Palët kanë të drejtë ankese kundër vendimit mbi prapësimin.
2. Ankesa kundër vendimit mbi prapësimin parashtrohet përmes Gjykatës së shkallës së parë për Gjykatën e shkallës së dytë, në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit.
3. Një kopje e ankesës u dorëzohet palës kundërshtare dhe pjesëmarrësve tjerë të cilët mund të paraqesin përgjigje në ankesë në afat prej tre (3) ditëve.
4. Pas pranimit të përgjigjes në ankesë ose pas kalimit të afatit për përgjigje, lënda së bashku me të gjitha shkresat tjera i dërgohet Gjykatës së shkallës së dytë në afat prej tre (3) ditësh. Lidhur me ankesën, Gjykata e shkallës së dytë do të vendosë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve.
5. Ankesa kundër vendimit nuk e ndalon procedurën përmbartimore përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas neni 78 të këtij ligji.
6. Në rast se debitori si palë ankuese është i suksesshëm në ankesën e tij dhe nëse pasuria e tij është përmbartuar në pajtim me vendimin përmbartimore, ai mund të kërkojë kundër përmbartim sipas dispozitave të këtij ligji për kundër përmbartimin.

#### **Neni 78**

#### **Garancitë për ankesa kundër vendimit lidhur me prapësimin për një kredi në bazë të dokumentit të besueshëm.**

1. Gjykata e shkallës së parë, në rastet kur debitori dëshiron të parashtrojë ankesë kundër vendimit me të cilin është refuzuar prapësimi i tij në lidhje me propozimin për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm, urdhëron palën ankuese që të paguajnë garancinë në të holla, si parakusht për parashtrimin e ankesës, përveç nëse pagesa e garancisë i shkakton dëm të riparueshëm palës ankuese dhe nëse dëmi është i ndryshëm ose nuk është i lidhur me humbjen që do të shkaktohej me rastin e pagesës së kredisë.
2. Gjykata cakton shumën e pagesës së garancisë duke marrë parasysh interesin e të dyja palëve në lidhje me qeshtjen. Gjykata urdhëron pagesën e garancisë në shumën e plotë të kredisë në çdo ankesë në të cilën titulli ekzekutiv bazohet në dokumentin e besueshëm, përveç nëse pala ankuese

demonstron se ka të drejtë për trajtim social ose që pagesa e garancisë asaj i shkakton dëme të riparueshme që janë të ndryshme dhe nuk kanë lidhje me pagesën e kredisë.

3. Pasi që Gjykata të nxjerrë vendimin e saj për shumën e garancisë dhe nëse pala ankuese dëshmon se nuk mund ta paguajë shumën e garancisë të caktuar nga Gjykata, gjendja financiare e palës ankuese përcaktohet në pajtim me procedurat e përmendura në nenin 45 dhe 46 të këtij ligji. Posedimi i pasurisë së përmbarueshmë në të holla që tejkalon shumën e garancisë do të konsiderohen si disponueshmeri e pasurisë për të plotësuar shumën e garancisë. Nëse përcaktohet se pala ankuese nuk mund të paguajë shumën e garancisë, Gjykata cakton një shumë me të vogël.

4. Nëse pala ankuese dështon të paguajë shumën e garancisë të caktuar nga Gjykata, ankesa konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

5. Ankesa në Gjykatën e shkallës së dytë mund të shqyrtohet pasi që të paguhet shuma e garancisë në Gjykatën e shkallës së parë.

6. Gjykata e shkallës së parë vendos fondet e garancisë në një llogari të veçantë të Gjykatës.

7. Nëse Gjykata e shkallës së dytë vendos se çështjet e ngritura në ankesë duhet të rishqyrtohen serish nga Gjykata e shkallës së parë, fondet e garancisë qëndrojnë në llogarinë e posaçme deri sa të merret vendimi i formës së prerë për atë rast, përveç rasteve kur Gjykata vendos ndryshe.

8. Nëse ankesa pranohet dhe debitori fiton çështjen, Gjykata ia kthen garancinë palës ankuese dhe e ndërprejë përmbarimin. Nëse refuzohet ankesa, vendimi i Gjykatës së apelit konsiderohet titull ekzekutiv sipas paragrafit 1. të nenit 22 të këtij ligji dhe fondet e garancisë sekuestrohen për të mbuluar shpenzimet procedurale të ankesës dhe kërkesën e kreditorit sipas propozimit për përmbarimin. Shumat që duhet të paguheshin por që nuk mund të mbulohej me fondet e sekuestruara, duke përfshirë shpenzimet procedurale të ankesës, përbejnë kredi që duhet të mblihet nga kreditori gjatë një procedure përmbarimore pasuese.

#### **Neni 79**

#### **Ankesat kundër parregullsisë me rastin e kryerjes së përmbarimit**

1. Pala ose pjesëmarrësi tjetër në procedurë mund të parashtrojë një ankesë në Gjykatë, lidhur me parregullsitë që janë kryer nga organi përmbarues gjatë kryerjes së procedurës së përmbarimit. Kjo kërkesë i bëhet Gjykatës me një parashtresë me shkrim në afat prej shtatë (7) ditësh nda dita e ndodhjes së parregullsisë së pretenduar.

2. Sipas kërkesës nga paragrafi 1. i këtij neni, nëse parashtresë e ka propozuar këtë, Gjykata nxjerr vendimin brenda tre (3) ditësh nga dita e dorëzimit të parashtresës.

3. Palët ose pjesëmarrësit tjerë në procedurë kanë të drejtë ankesë kundër vendimit të përmendur në paragrafin 2. të këtij neni në pajtim me dispozitat e nenit 77 të këtij ligji.

### **PJESA E DYTË**

#### **MJETET DHE OBJEKTET E PËRMBARIMIT**

#### **KREU I**

#### **PËRMBARIMI PËR REALIZIMIN E KREDISË NË TË HOLLA DHE PËRMBARIMI PËR SENDET E LUAJTSHME**

#### **Neni 80**

#### **Radha e realizimit të kredive kur janë më shumë kreditor**

1. Në qoftë se janë më shumë se një propozues të përbarimit që duhet t'i realizojnë kreditë e tyre ndaj debitorit të njëjti dhe nga i njëjti objekt i përbarimit, atëherë ata i realizojnë ato sipas radhës me të cilën e kanë fituar të drejtën që nga objekti i tillë ta realizojnë kredinë, përveçse kur me ligj parashihet ndryshe.

#### **Neni 81**

#### **Shtirja e përbarimit në rast kredish në të holla**

Përbarimi për realizimin e kredive në të holla caktohet dhe zbatohet në vëllimin që është i domosdoshëm për realizimin e kërkesave të tilla.

#### **Neni 82**

#### **Kompetenca territoriale në rast të përbarimit gjyqësor**

1. Për të vendosur mbi propozimin për përbarim për sendet e luajtshme, si dhe për zbatimin e përbarimit të tillë, kompetente në pikëpamje territoriale është Gjykata në territorin e së cilës ndodhen ato sende sipas të dhënave të shkruara në propozimin për përbarim.

2. Dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni, zbatohen në mënyrë të përshtatur edhe në rastet në të cilat përbarimi fillohet sipas detyrës zyrtare.

3. Kreditori mund të kërkojë që organi përbarimor të nxjerrë aktvendimin për përbarimin për sendet e luajtshme, duke mos e përmendur vendin e ndodhjes së tyre.

4. Për vendosje për propozimin nga paragrafi 3. i këtij neni, e kompetencës territoriale është Gjykata në territorin e së cilës ndodhet vendbanimi i debitorit, e nëse nuk ka vendbanim në Kosovë, atëherë në territorin e së cilës ndodhet vendqëndrimi i tij, kur kemi të bëjmë me personin fizik. Kur debitori është person juridik e kompetencës territoriale është Gjykata në territorin e së cilës ai e ka selinë e tij.

5. Në rastin nga paragrafi 3. i këtij neni, kreditori i përbarimit aktvendimin për përbarim mund t'ia parashtojë secilës Gjykatë me kompetencë lëndore në territorin e së cilës ndodhen sendet e luajtshme të debitorit, me propozim që kjo Gjykatë ta zbatojë përbarimin.

#### **Neni 83**

#### **Kompetenca në rast të përbarimit nga përbaruesi privat**

Për të vendosur mbi propozimin për përbarim për sendet e luajtshme, si dhe për zbatimin e përbarimit të tillë, përbaruesi privat ka kompetencë për të vendosur për propozimin përbarimor dhe të zbatojë përbarimin për sendet e luajtshme duke përfshirë edhe sendet e luajtshme që nuk i dihet vendi.

#### **Neni 84**

#### **Dërgimi i aktvendimit për përbarimin në Gjykatën tjetër**

Në qoftë se Gjykata e ka caktuar përbarimin për sendet e luajtshme që ndodhen në territorin e saj dhe të Gjykatës tjetër, atëherë pas kryerjes së përbarimit për sendet e luajtshme në territorin e saj, aktvendimin për përbarimin do t'ia dërgojë Gjykatës tjetër për përbarim të mëtejshëm deri në realizimin e plotë të kredisë së kreditorit të përbarimit. Gjykata nga e cila është larguar rasti, me përfundimin e largimit, nuk ka më kompetencë në lidhje me rastin.

#### **Neni 85**

#### **Përfundimi nga përbarimi**

1. Përfundohen nga përbarimi sendet si në vijim:

1.1. veshjet, këpucët, ndërresat dhe gjësendet tjera personale, çarçafët, veglat e kuzhinës, orenditë, stufa, frigoriferi dhe objektet tjera me vlerë të zakonshme që shërbejnë për përmbushjen e nevojave themelore të familjes, nëse janë të nevojshme nga debitori dhe familjarët e tij;

1.2. furnizimi me ushqim për tre (3) muaj dhe materialet për nxehe që shfrytëzohen nga debitori dhe familjarët e tij;

1.3. kafshët e punës dhe mbarështimit, pajisjet bujqësore dhe mjetet tjera, farërat, ushqimi për kafshë, mjetet, makinat dhe objektet tjera që i duhen debitorit, bujkut apo zanatliut për vazhdimin e punës në bujqësi, respektivisht në kryerjen e aktivitetit të zanatit, të nevojshme për të fituar të ardhurat minimale të nevojshme për të mbajtur veten dhe familjarët e tij;

1.4. librat dhe objektet tjera që janë të nevojshme nga debitori që në mënyrë të pavarur dhe me punë personale të kryej një aktivitet shkencor, artistik apo aktivitet tjetër profesional;

1.5. të hollat e gatshme të debitorit i cili ka të hyra mujore të përhershme deri në shumën mujore që sipas ligjit përjashtohet nga përmbartimi e proporcionalisht me afatin kohor deri në pagesën e ardhshme;

1.6. dekorimet, medaljet, certifikatat ushtarake të nderit apo dekoratat tjera të debitorit për vlerësimin e nderit, unazën e martesës, letrat personale, manuskriptet apo dokumentet tjera personale që i përkasin debitorit si dhe fotografit e familjes; dhe

1.7. mjetet mjekësore që i jepen personave me aftësi të kufizuara apo personave tjerë me paaftësi fizike në pajtim me rregulloret, apo që ai ka përvetësuar personalisht dhe që janë të domosdoshme për kryerjen e funksioneve jetësore.

2. Dispozitat nga nënparagrafi 1.3. paragrafi 1. i këtij neni nuk vlejné për përmbartim të realizimit të kërkesave monetare të bankave, në bazë të huave specifike për qëllime të zhvillimit të bujqësisë, respektivisht zanatit, me kusht që ky qëllim është deklaruar në mënyrë të veçantë në kontratën për hua.

3. Pakot postare apo transferimet monetare përmes postës që i janë adresuar debitorit nuk mund të jenë objekt i përmbartimit para se t'i dërgohen debitorit.

### **Neni 86 Veprimet përmbartimore**

Përmbartimi për sendet e luajtshme zbatohet me anë të regjistrimit, dhe vlerësimit të tyre, sekuestrimit, shitjes së sendeve dhe përmbushjen e kredisë së kreditorit nga shuma e fituar nga shitja e atyre sendeve.

### **Neni 87 Njoftimi për sekuestrimin**

1. Organi përmbartues në parim para se të filloj sekuestrimin, debitorit ia dorëzon aktvendimin për përmbartimin dhe e urdhëron që ta paguaj menjëherë shumën e të hollave bashkë me kamatat dhe shpenzimet procedurale, për të cilën është lejuar përmbartimi.

2. Nëse është e pamundshme që t'i dorëzohet debitorit aktvendimi apo urdhri përmbartimor në rastin e sekuestrimit, atëherë lejohet kryerja e njoftimit duke vendosur një njoftim për datën e sekuestrimit në tabelën e shpalljeve të organit përmbartimor dhe të lihet një kopje e vendimit përmbartues në lokalet ku bëhet sekuestrimi.

3. Për kohën dhe vendin e sekuestrimit të sendeve të luajtshme, kreditori do të njoftohet nga organi përmbartimor.

4. Mos prania e palëve nuk e pengon kryerjen e sekuestrimit.

5. Për sekuestrimin e kryer njoftohet pala e cila nuk ka qenë e pranishme në vendin e sekuestrimit të kryer.

### **Neni 88 Objekti i sekuestrimit**

1. Sekuestrimi bëhet me anë të përpilimit të regjistrit të inventarizimit.
2. Inventarizohen sendet e luajtshme që ndodhen në posedim të debitorit, si dhe sendet e debitorit që ndodhen në posedim të kreditorit.
3. Në qoftë se personat e tretë nuk e njoftojnë organin përbarimor për të drejtat e tyre për sendet në posedim të debitorit, e as nuk i provojnë të drejtat e tyre për to në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga data e njoftimit dhe më së voni tre (3) muaj nga data e sekuestrimit, merret se të drejtat e tilla të personave të tretë nuk ekzistojnë dhe se debitori është pronar i sendeve që ndodhen në posedimin e tij.
4. Supozohet se bashkëshortët martesor dhe jashtëmartesor janë bashkëpronar në pjesë të barabarta të gjitha sendeve të luajtshme që gjenden në shtëpinë, banesën ose lokalin afarist të tyre.
5. Sendet e debitorit që ndodhen në posedim të personit të tretë mund të inventarizohen vetëm me pëlqimin e këtij të fundit.
6. Në qoftë se personi i tretë nuk e jep pëlqimin për inventarizim, organi përbarues me propozimin e kreditorit, këtij të fundit ia kalon të drejtën e debitorit që t'i dorëzohen sendet nga i treti.

#### **Neni 89**

##### **Vëllimi i inventarizimit sekuestrues**

1. Me anë të inventarizimit sekuestrues përfshihen aq sende të luajtshme, sa mjaftojnë për përmbushjen e kredisë në të holla të kreditorit të përbarimit dhe për pagimin e shpenzimeve procedurale.
2. Së pari inventarizohen sendet për të cilat nuk ka vërejtje lidhur me ekzistimin e të drejtës që do ta pengonin përbarimin dhe sendet që mund të shiten më lehtë.
3. Me rastin e inventarizimit merren në konsiderim deklaratat dhe provat e palëve dhe të personave të tretë lidhur me ekzistimin e të drejtave nga paragrafi 2. i këtij neni.

#### **Neni 90**

##### **Ruajtja e sendeve të inventarizuara**

1. Sendet e inventarizuara organi përbarues ia lenë për ruajtje debitorit. Me propozimin e kreditorit organi përbarues mund të vendosë që ato t'i dorëzohen për ruajtje atij.
2. Rrezikun e asgjësimit apo të dëmtimit të sendeve të inventarizuara të dhëna për ruajtje kreditorit e bartë ky i fundit, përveçse kur asgjësimi ose dëmtimi është pasojë e fuqisë madhore.
3. Paratë e gatshme, letrat me vlerë dhe sendet e çmueshme të inventarizuara dorëzohen në depozitën e organit përbarues.
4. Në depozitën e autoritetit përbarues mund të dorëzohen edhe sendet tjera me vlerë më të madhe, po qe se janë të përshtatshme për këtë lloj ruajtje.

#### **Neni 91**

##### **Ndalimi i disponimit me sendet e inventarizuara**

1. Secili person që i posedon apo mbikëqyrë sendet e inventarizuara, i ndalohet që të disponojë me sendet e tilla pa urdhrin e organit përbarues. Dispozitat e nenit 15 të këtij ligji vlejnjë në rastet e tilla përveç nëse posedimi i tillë nuk është vepër penale.
2. Në aktvendimin për përbarimin ose urdhrin për përbarim theksohet ndalimi nga paragrafi 1. i këtij neni dhe njoftimi që i bëhet debitorit për pasojat juridiko-penale të veprimit të kundërt me ndalimin në fjalë.

#### **Neni 92**

## **Fitimi i të drejtës së pengut**

1. Kreditori e fiton të drejtën e pengut për sendet e luajtshme të inventarizuara.
2. Në qoftë se inventarizimi është bërë në dobi të më tepër kreditorëve, radha e përparësisë së të drejtës së pengut nga paragrafi 1. i këtij neni, e fituar me anë të inventarizimit apo shënimit në regjistrin e inventarizimit sekuestrues, caktohet sipas ditës në të cilën ka arritur tek organi përmbaues propozimi për përmbarim. Po qe se propozimet e tilla kanë arritur tek organi përmbaues në të njëjtën ditë, atëherë të drejtat e pengut konsiderohen se janë të radhës së njëjtë.
3. Propozimi për përmbarim i dërguar tek organi përmbaues me anë të letrës rekomande, konsiderohet se është dorëzuar tek organi përmbaues në ditën kur ajo i është dorëzuar postës. Propozimi për përmbarim i dorëzuar organi përmbaues përmes komunikimit elektronik, nëse lejohet nga organi përmbaues, konsiderohet se i është dorëzuar organi përmbaues në datën kur është dërguar komunikimi elektronik, në pajtim me ligjin për procedurën kontestimore.

### **Neni 93**

#### **Tentimi i pasuksesshëm për sekuestrim**

1. Po qe se me rastin e sekuestrimit në pasurinë e debitorit nuk gjenden sende të luajtshme që mund të bëhen objekt përmbarimi, organi përmbaues për një gjë të tillë do ta njoftoj kërkuesin e përmbaimit nëse nuk ka qenë i pranishëm gjatë sekuestrimit.
2. Me kërkesën e kreditorit i cili përcakton mundësinë se debitori dinë se ku mund të gjenden pasuritë e padeklaruara të luajtshme, organi përmbaues urdhëron debitorin që në afat prej re (3) ditësh nga dita e dorëzimit të jep informatat për vendndodhjen e pasurive të luajtshme. Nëse debitori nuk respekton këtë detyrim aplikohen dispozitat e neneve 15 dhe 16 të këtij ligji.
3. Kërkuesi i sekuestrimit, brenda afatit prej tre (3) muajsh nga dita në të cilën i është dërguar njoftimi, respektivisht nga dita e tentimit të sekuestrimit me rastin e të cilit ka qenë i pranishëm, mund të propozoj që sekuestrimi përsëri të kryhet.
4. Nëse kërkuesi i përmbaimit brenda afatit nga paragrafi 3. i këtij neni, nuk e propozon kryerjen e serishme të sekuestrimit, apo nëse as me rastin e sekuestrimit të serishëm nuk gjenden sende që mund të bëhen objekt përmbarimi, autoriteti përmbaues do ta pezulloj procedurën e përmbaimit. Pezullimi në këtë rast rregullohet nga dispozitat e paragrafit 1. neni 65, të këtij ligji.

### **Neni 94**

#### **Vlerësimi i sendeve të sekuestruara**

1. Në rastin e sekuestrimit të sendeve, organi përmbaues e bënë edhe vlerësimin e vlerës së sendeve të luajtshme.
2. Vlerësimin e bënë organi përmbaues, po qe se Gjykata nuk e ka caktuar për një gjë të tillë vlerësuesin gjyqësor apo ekspertin e posaçëm, ose përmbauesi privat ka caktuar një ekspert të posaçëm.
3. Pala mund të propozojë që vlerësimin ta bëjë eksperti edhe kur një gjë të tillë nuk e ka paraparë organi përmbaues. Nëse organi përmbaues e miraton propozimin e tillë, shpenzimet e ekspertimit është i detyruar ti parapaguaj propozuesi brenda afatit të caktuar nga organi përmbaues. Nëse parapagimi nuk bëhet brenda afatit të caktuar, nga organi përmbaues, konsiderohet se propozuesi ka hequr dorë nga propozimi i tij.
4. Për propozimin nga paragrafi 3. i këtij neni organi përmbaues vendosë me anë të vendimit që ka formë të konkluzionit.
5. Shpenzimet e ekspertizës nga paragrafi 3. i këtij neni mbetet barrë e propozuesit, pavarësisht se çfarë mund të jetë përfundimi i procedurës përmbaimore.

### **Neni 95**



### **Rivlerësimi i sendeve të sekuestruara**

1. Secila palë ka të drejtë që brenda afatit prej tre (3) ditësh, nga dita e vlerësimit të bërë të sendeve të sekuestruara, që t'i propozojë organi përmbaues caktim të vlerës më të vogël apo më të madhe të sendeve të sekuestruara nga ajo e caktuar më parë, apo caktim të vlerësimit të ri. Një gjë e tillë nuk lejohet po që se vlerësimin e parë e ka bërë eksperti.
2. Për propozimin nga paragrafi 1. i këtij neni, organi përmbaues vendosë me anë të konkluzionit.

### **Neni 96**

#### **Procesverbali për regjistrimin dhe vlerësimin**

1. Për regjistrimin dhe vlerësimin sekuestrues Gjykata përpilon procesverbal.
2. Në procesverbal veç e veç tregohen sendet e sekuestruara dhe vlera e tyre e caktuar, si dhe shënohen deklaratat e palëve dhe të pjesëmarrësve të tjerë të procedurës, e edhe ato të personave të tretë për ekzistimin eventual të të drejtave të tyre që mund ta pengojnë përmbauesin për sendet e sekuestruara.
3. Në sendet e sekuestruara vihet shenja e caktuar nga e cila shihet se janë të sekuestruara.
4. Kreditori ka të drejtë që në procesverbalin e organit përmbaues të përpiluar me rastin e sekuestrimit të sendeve të debitorit ta publikojë në mjetet e informimit publik.

### **Neni 97**

#### **Shënimi në procesverbal i të dhënave nga përmbauesi tjetër**

Në qoftë se pas sekuestrimit të bërë caktohet përmbauesi tjetër për sendet e sekuestruara me qëllim të realizimit të kërkesës tjetër të njëjtit kreditor, apo të kërkesës së kreditorit tjetër, nuk do të bëhet regjistrimi dhe vlerësimi i serishëm i sendeve të sekuestruara, veçse në vazhdimin e procesverbalit do të bëhet vetëm shënimi i të dhënave nga aktvendimi i mëvonshëm për përmbauesin.

### **Neni 98**

#### **Koha e shitjes së sendeve të sekuestruara**

1. Shitja e sendeve të sekuestruara kryhet jo më herët se pesëmbëdhjetë (15) ditë dhe jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e sekuestrimit.
2. Shitja mund të bëhet edhe para skadimit të afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga paragrafi 1. i këtij neni po që se debitori propozon, apo pajtohet me propozimin e kreditorit që shitja e sendeve të sekuestruara të bëhet më herët.
3. Shitja e sendeve të sekuestruara mund të bëhet para skadimit të afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga paragrafi 1. i këtij neni, po që se sendet e këtu prishen shpejtë, apo kur ekziston mundësia që të bie dukshëm çmimi i tyre pas një kohe të shkurtër.
4. Në qoftë se kreditori jep garancinë për dëmin eventual që do të duhej kompensuar debitorit në rast të anulimit të vendimit për përmbauesin, shitja e sendeve të sekuestruara mund të bëhet edhe para skadimit të afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga paragrafi 1. i këtij neni.

### **Neni 99**

#### **Mënyra e shitjes së sendeve të sekuestruara**

1. Shitja e sendeve të sekuestruara bëhet me anë të ankandit verbal publik ose me ujdinë e drejtpërdrejtë midis blerësit, nga njëra anë dhe organi përmbaues, apo subjektit tjetër të autorizuar, nga ana tjetër.
2. Mënyra e shitjes së sendeve caktohet me anë të konkluzionit të organit përmbaues, duke pasur parasysh faktin që të arrihet çmimi më i volitshëm për debitorin.

3. Ankandin publik të shitjes e administron organi përmbarues, apo personi tjetër i caktuar nga organi përmbarues.

4. Shitja me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë bëhet midis blerësit, nga njëra anë dhe organit përmbarues, apo personit që kryen veprime komisioni, nga ana tjetër. Organi përmbarues sendet e sekuestruara i shet në emër dhe llogari të debitorit, kurse personi që merret me veprime komisioni, në emër të vet, por për llogari të debitorit.

5. Shitja me anë të ankandit do të caktohet në qoftë se është fjala për sendet e sekuestruara që kanë vlerë të madhe, ndërkaq mund të pritet se ato do të shiten sipas çmimit më të lartë nga sa është shumata e vlerësuar.

6. Shitja e sendeve do të publikohet në tabelën e shpalljeve të organit përmbarues së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para se të mbahet seanca për shitjen e tyre. Publikimi i shitjes mund të bëhet edhe në mënyrën e paraparë për publikimin e shitjes së sendeve të paluajtshme. Pala mund të përcaktojë se, përveç këtyre mjeteve të shpalljes së shitjes publike, mund të përdoren mjetet tjera të shpalljes, në shpenzim të asaj pale, dhe organi përmbarues do të ndihmojnë që shpallja të bëhet edhe me këto mjete shitesë.

7. Kreditori dhe debitori do të informohen për vendin, ditën dhe orën e shitjes së sendeve të sekuestruara.

#### **Neni 100** **Seanca e parë e shitjes publike**

1. Sendet e sekuestruara mund të shiten në ankandin e parë me çmim më të vogël se ai i caktuar, por jo me çmimin më të vogël se tetëdhjetë përqind (80%) e vlerës së caktuar me rastin e regjistrimit dhe vlerësimit të sendeve të luajtshme të debitorit, respektivisht në afatin që e ka caktuar organi përmbarues për shitjen e tyre me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë.

2. Ankandi i parë mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e sekuestrimit.

3. Nëse sendet e sekuestruara nuk shiten me çmimin minimal të lejuar nga paragrafi 1. i këtij neni, organi përmbarues konstaton dështimin e shitjes dhe fton kreditorin që të propozojë ankandin e dytë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

#### **Neni 101** **Seanca e dytë e shitjes publike**

1. Me propozimin nga palët, organi përmbarues e cakton ankandin e ri në të cilin sendet e sekuestruara mund të shiten me çmim jo më të vogël se sa pesëdhjetë përqind (50%) e çmimit të përcaktuar gjatë vlerësimit të tyre.

2. Propozimin për ankandin tjetër, ose për shitjen me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë, pala mund ta paraqesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e ankandit të parë, respektivisht nga dita e skadimit të afatit të caktuar nga organi përmbarues për shitje me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë. Ankandi i dytë mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve të propozimit për ankandin e dytë.

3. Dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni, zbatohen në mënyrë të përshtatshme edhe kur sendet e sekuestruara nuk kanë mundur të shiten në vlerën e çmuar me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë në afatin e caktuar nga organi përmbarues.

4. Në qoftë se pasuritë nga paragrafi 1. i këtij neni nuk shiten brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e ofertës së parë për shitje apo në rast të tentimit të pasuksesshëm për shitje nga paragrafi 2., atëherë kreditori mund të kërkojë transferimin e sendeve në pronësi të tij, për mbulim të pjesshëm apo të plotë të kredisë në çmim të vlerësuar të atyre sendeve.

5. Dispozitat e lartë përmendura të këtij neni do të aplikohen përshtatshëm edhe për shitjen e sendeve të sekuestruara përmes marrëveshjes së drejtpërdrejtë.

## **Neni 102**

### **Pezullimi i procedurës**

1. Organi përmbareues e pezullon përmbarimin në qoftë se asnjëra nga palët nuk paraqet propozim për ankandin e dytë, apo për shitjen me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë, sipas paragrafit 2. neni 101 të këtij ligji respektivisht nëse kreditori nuk paraqet propozim për transferin e sendeve në pronësi të kreditorit, brenda afatit të paraparë në paragrafin 4. neni 101 të këtij ligji.
2. Dispozitat e sipërme të këtij neni zbatohen në mënyrë të përshtatshme edhe për shitjen e sendeve të sekuestruara me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë.

## **Neni 103**

### **Të drejtat dhe detyrimet e blerësit**

1. Blerësi ka për detyrë ta depozitojë çmimin blerës dhe sendet t'i marrë përsipër menjëherë pas përfundimit të ankandit, apo të shitjes me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë.
2. Organi përmbareues t'ia dorëzojë blerësit sendet edhe para se do ta ketë depozituar shumën e të hollave në emër të çmimit blerës, në qoftë se për këtë gjë në rrezik të vet e jep pëlqimin kreditori brenda suazave të shumës që do t'i takonte nga çmimi i realizuar i shitjes.
3. Në qoftë se blerësi nuk e depoziton shumën e të hollave në emër të çmimit blerës, personat nga paragrafi 2. i këtij neni, mund të kërkojnë nga organi përmbareues në të njëjtën procedurë që me aktvendim të urdhërohet blerësi ta bëjë depozitimin e saj dhe pasi të bëhet i formës së prerë, të propozohet përmbarimi i sajë.

## **Neni 104**

### **Momenti në të cilin blerësi bëhet pronar**

1. Në momentin në të cilin blerësi merr sendet e sekuestruara në posedim, ai bëhet edhe pronar i tyre pasi ta ketë depozituar çmimin e plotë.
2. Blerësi nuk ka të drejtë ankese për të metat fizike dhe juridike të sendi.

## **Neni 105**

### **Pagimi i kreditorit të përmbarimit**

1. Në qoftë se nga të hollat e fituara me anë të shitjes së sendeve, e realizon kërkesën e tij vetëm një kreditor, atëherë organi përmbareues pa caktuar seancë gjyqësore, me anë të aktvendimit urdhëron që nga shuma e të hollave të fituara me anë të shitjes së sendeve, të paguhen me radhë: shpenzimet procedurale, shpenzimet e caktuara në dokumentin përmbareues, kamatat deri në ditën e shitjes së sendeve dhe kërkesa kryesore për realizimin e të cilës është filluar procedura përmbareimore.
2. Të hollat që teprojnë pas përmbushjes së kërkesës kryesore i dorëzohen debitorit, po qe se për një gjë të tillë nuk ka pengesa.

## **Neni 106**

### **Pagimi kur janë më shumë kreditorë**

1. Po qe se në procedurën përmbareimore i realizojnë kërkesat e tyre më tepër kreditorë, gjegjësisht nëse përpos kreditorit i realizojnë kërkesat e tyre edhe personat të drejtat e të cilëve shuhen në momentin e shitjes së sendeve të luajtshme, atëherë ata i realizojnë të drejtat e tyre sipas radhës me të cilën e kanë fituar të drejtën e pengut, apo të drejtën tjetër që shuhet në momentin e shitjes për sendet e sekuestruara dhe të shitura.
2. Realizimi i kërkesave në mënyrën e caktuar në paragrafin 1. të këtij neni, bëhet vetëm po qe se me ligj për kërkesat e caktuara nuk është paraparë e drejta e realizimit me përparësi.

**Neni 107**  
**Realizimi proporcionalisht i kredive**

1. Kreditorët të radhës së njëjtë të cilët nga shuma e të hollave të fituara me anë të shitjes së sendeve nuk mund të paguhen plotësisht, paguhen përpjesëtimisht me madhësinë e kërkesave të tyre.
2. Me rastin e nxjerrjes së aktvendimit për pagimin, organi përbarues do të marrë parasysh vetëm ato kërkesa në bazë të cilave aktvendimi për përbarimin ose urdhri përbarues ka marrë formë të prerë në ditën e shitjes së sendeve të sekuestruara.
3. Shpenzimet e procedurës së përbarimit, shpenzimet e caktuara në dokumentin përbarues dhe kamatat kanë të njëjtën radhë të pagimit, sikurse kërkesa kryesore për të cilën janë të lidhura.
4. Të hollat që teprojnë pas përmbushjes së kërkesave i dorëzohen debitorit në procedurën e përbarimit, po qe se për një gjë të tillë nuk ka pengesa juridike.

**Neni 108**  
**Zbatimi i dispozitave për përbarimin për sendet e paluajtshme**

Dispozitat e këtij ligji për përbarimin për sendet e paluajtshme që kanë të bëjnë me çështjen se kush nuk mund të jetë blerës, mandej ato që kanë të bëjnë me çështjen e kontestimit të kredive, me udhëzimin për në procedurë kontestimore, si dhe me aktvendimin për përmbushjen e detyrimeve të debitorit në procedurën përbarimore, zbatohen në mënyrë të përshtatshme edhe në pikëpamje të përbarimit për sendet e luajtshme me qëllim të realizimit të kredive në të holla.

**KREU II**  
**PËRMBARIMI PËR KREDITË E DEBITORIT**

**Neni 109**  
**Kompetenca territoriale në rastet e përbarimit të kredive të debitorit**

1. Vendosja për propozimin për përbarimin lidhur me kredinë në të holla të debitorit dhe për aplikimin e këtij lloji të përbarimit, kompetencë territoriale ka Gjykata në territorin e së cilës ndodhet vendbanimi i debitorit. Në qoftë se debitori nuk ka vendbanim në Kosovë, atëherë është kompetente Gjykata në territorin e së cilës ndodhet vendqëndrimi i debitorit
2. Në qoftë se debitori nuk ka në Kosovë as vendbanim e as vendqëndrim, kompetencë ka Gjykata në territorin e së cilës ndodhet vendbanimi i debitorit të debitorit në procedurën përbarimore. Në qoftë se debitori i debitorit nuk ka në Kosovë vendbanim, atëherë është kompetente Gjykata në territorin e së cilës ndodhet vendqëndrimi i debitorit të debitorit.
3. Për debitorin si person juridik kompetente territorial është Gjykata ku gjendet selia e personit juridik ose selia e njësisë organizative të tij, si dhe Gjykata në territorin që ka nxjerrë dokumentin përbarues.
4. Vendosja për propozimin për përbarimin lidhur me kredinë në të holla të debitorit dhe për aplikimin e këtij lloji të përbarimit, përbaruesi privat ka kompetencë territoriale për të vendosur mbi propozimin përbarimor dhe të zbatojë përbarimin për kreditë e debitorit.

**Neni 110**  
**Kompetenca territoriale në rast të ushqimit ligjor**

Përrjashtimisht nga neni 109 i këtij Ligji, kreditori i përbarimit të kredisë për ushqimin ligjor, ka të drejtë që propozimin e tij ta paraqesë në Gjykatën në territorin e së cilës ndodhet vendbanimi apo vendqëndrimi i tij.

**Neni 111**  
**Përrjashtimi nga përmbarimi**

1. Përrjashtohen nga përmbarimi të ardhurave nga ushqimi ligjor, po qe se nuk kemi të bëjmë me kreditë e llojit të njëjtë.
2. Objekt përmbarimi nuk mund të bëhen kreditë në bazë të tatimeve dhe të kontributeve të caktuara me anë të ligjit.

**Neni 112**  
**Kufizimi i përmbarimit**

1. Përmbarimi në të ardhurat personale, për shpërblimin në vend të pagës dhe për pensionin, mund të caktohet dhe zbatohet deri në gjysmën e lartësisë së tyre. Shuma që sekuestrohet do të kufizohet në pjesën që tejkalon shumën e ndihmës më të lartë sociale që paguhet brenda territorit ku debitori ka vendbanimin.
2. Përmbarimi për fitimin e garantuar i cili i takon debitorit në procedurën e përmbarimit, në bazë të kontratës kolektive dhe ligjit, mund të caktohet dhe zbatohet vetëm deri në një të tretën (1/3) e sasisë së tij.
3. Dispozitat e paragrafit 2. të këtij neni zbatohen edhe në rast të përmbarimit për të ardhurat në bazë të shpërblimit për shkak të dëmtimit të trupit sipas dispozitave për sigurimin invalidor, për të ardhurat në bazë të ndihmës sociale, për të ardhurat në bazë papunësisë së përkohshme, për të ardhurat në bazë të shtesave për fëmijë, për të ardhurat në bazë të bursës studentore dhe ndihmës studentëve dhe nxënësve, si dhe për të ardhurat nga puna e personave të dënuar me burgim.
4. Përmbarimi për të ardhurat në bazë të kontratës për ushqimin e përjetshëm dhe për rentën e përjetshme, si dhe për të ardhurat në bazë të kontratës për sigurimin e jetës, mund të zbatohet vetëm në atë pjesë që e tejkalon shumën e ndihmës më të lartë të përhershme sociale që paguhet në territorin ku debitori ka vendbanimin e vet.
5. Përmbarimi për të ardhurat e invalidëve të luftës, dhe ato në bazë të shtesës invalidore, mund të zbatohet vetëm për përmbushjen e kredive në bazë të ushqimit ligjor, shpërblimit të dëmit të krijuar për shkak të humbjes së aftësisë për punë dhe shpërblimit të dëmit për humbjen e ushqimit për shkak të vdekjes së dhënësit të ushqimit, deri në shumën e gjysmës së këtyre të ardhurave.

**Neni 113**  
**Veprimet përmbaruese**

Përmbarimi për kredinë në të holla të debitorit në procedurën përmbarimore zbatohet me anë të sekuestrimit dhe kalimit (transferimit) të tij, po qe se me këtë ligj për rastet e veçanta nuk është paraparë ndryshe.

**Neni 114**  
**Vëllimi i përmbarimit**

1. Sekuestrimi dhe kalimi i kredisë në të holla, mund të caktohen vetëm në shumën që nevojitet për realizimin e kredisë së kreditorit, përveç në qoftë se është fjala për kredinë e papjesëtueshme.
2. Në qoftë se më tepër kreditorë e kërkojnë përmbarimin për të njëjtën kredi të debitorit që është e ndashme, sekuestrimi dhe kalimi caktohen në shumat përkatëse veç e veç në dobi të secilit propozues.

**Neni 115**  
**Sekuestrimi i kredisë së debitorit**

1. Me aktvendimin me të cilin caktohet sekuestrimi i kredisë në të holla të debitorit, i ndalohet debitorit të debitorit që t'ia paguajë borxhin debitorit, kurse këtij të fundit i ndalohet që kredinë e këtitillë ta realizojë, apo që me të disponojë në ndonjë mënyrë tjetër.
2. Ndalimi e përfshinë edhe disponimin me pengun e kontraktuar për sigurimin e kredisë së sekuestruar.

#### **Neni 116** **Efekti i sekuestrimit të kredisë**

1. Sekuestrimi i kredisë në të holla të debitorit quhet i kryer në ditën në të cilën debitorit të debitorit i është dorëzuar aktvendimi për sekuestrimin.
2. Kreditori me anë të sekuestrimit të kryer e fiton të drejtën e pengut për kredinë e debitorit.
3. Debitori i debitorit nuk ka as të drejtë prapësimi, e as të drejtë ankimi kundër vendimit për sekuestrimin e kredisë së kreditorit të tij.

#### **Neni 117** **Sekuestrimi i kredisë së bazuar në letrën me vlerë**

1. Sekuestrimin e kredisë të bazuar në letrën me vlerë e cila kalohet me anë të vërtetimit, apo për realizimin e së cilës është e nevojshme letra e tillë, e kryen organi përmbarues, duke ia marrë letrën me vlerë debitorit dhe duke ia dorëzuar atë Gjykatës.
2. Sekuestrimi quhet i kryer në momentin kur i merret letra me vlerë debitorit në procedurën e përmbarimit.
3. Veprimet juridike të nevojshme për ruajtjen apo realizimin e të drejtës nga letra me vlerë, i kryen në emër të debitorit organi përmbarues në mbështetje të konkluzionit të nxjerrë nga organi përmbarues.

#### **Neni 118** **Sekuestrimi i kredisë në bazë të depozitës së kursimit**

1. Përjashtimisht nga dispozitat e nenit 115 të këtij ligji, sekuestrimi i kredisë të bazuar në depozitën e kursimit të banka, apo të ndonjë organizatë financiare tjetër, mund të bëhet edhe pa iu marrë paraprakisht librezat e kursimit debitorit.
2. Në qoftë se kreditori i përmbarimit në propozimin e tij nuk i ka treguar të dhënat lidhur me depozitën e kursimit të debitorit, atëherë organi përmbarues të dhënat e tilla do t'i kërkojë nga banka në të cilën ndodhet depozita e kursimit, të cilën bankë kreditori duhet ta tregojë në propozimin e tij.
3. Banka të e cila ndodhet depozita e kursimit, ka detyrë që brenda një (1) dite pune t'ia dërgoj organi përmbarues të dhënat e kërkuara dhe i ndalohet ta njoftojë debitorin e përmbarimit lidhur me kërkesën e të dhënave në fjalë nga autoriteti përmbarues.

#### **Neni 119** **Kryerja e sekuestrimit**

1. Sekuestrimi kryhet duke iu dërguar aktvendimi apo urdhri për sekuestrim, bankës të e cila ndodhet depozita e kursimit.
2. Organi përmbarues ia dërgon aktvendimin apo urdhrin për sekuestrimin e depozitës së kursimit debitorit të përmbarimit, vetëm pas njoftimit nga banka të e cila ndodhet depozita e kursimit, se është kryer sekuestrimi.

#### **Neni 120** **E drejta e pengut për kamatat**

E drejta e pengut e fituar për kredinë e debitorit nga e cila rrjedhin kamatat, i përket edhe kamatave që bëhen të kërkueshme pas sekuestrimit të bërë.

**Neni 121**  
**Radha e përparësisë**

1. Radha e përparësisë së të drejtave të pengut të më tepër kreditorëve të përbarimit, caktohet sipas datës së arritjes së propozimeve për përbarim tek organi përbarues.
2. Në qoftë se propozimi për përbarimin i është dërguar organi përbarues nëpërmjet postës me letër rekomande, dita e dorëzimit të saj në postë konsiderohet ditë e dorëzimit të saj te organi përbarues.
3. Në qoftë se propozimet për përbarim të më tepër kreditorëve kanë arritur në organi përbarues në të njëjtën ditë, atëherë të drejtat e pengut e kanë të njëjtën radhë përparësie.
4. Kreditë me të njëjtën radhë të prioritetit realizohen proporcionalisht, po qe se nuk mund të realizohen në tërësi për shkak të mos mjaftësisë së kredisë së debitorit që e ka ndaj personit të tretë.

**Neni 122**  
**Radha e përparësisë për të drejtën e pengut**

Në qoftë se nga shkak i zbatimit të përbarimit për kredinë në të holla të debitorit, shuhen të drejtat e pengut, dhe të drejtat tjera që janë fituar para fillimit të procedurës përbarimore, radha e prioritetit të realizimit të drejtave të tilla caktohet sipas dispozitave me të cilat rregullohet fitimi i radhës së prioritetit të tyre jashtë procedurës përbarimore.

**Neni 123**  
**Sekuestrimi i kredisë së siguruar me të drejtën e pengut të regjistruar në regjistrin publik**

1. Sekuestrimi i kredisë së siguruar me anë të së drejtës së pengut të regjistruar në regjistrin publik, kryhet duke u shënuar sekuestrimi në regjistrin e tillë.
2. Regjistrimin e bënë sipas detyrës zyrtare organi përbarues, duke u theksuar se sekuestrimi në bazë të cilit është fituar e drejta e pengut për kredinë, është bërë me qëllim që të realizohet kredia e kreditorit.
3. Po qe se ekzistojnë më tepër kreditorë, radha e prioritetit të kredive të tyre caktohet sipas kohës së regjistrimit.

**Neni 124**  
**Deklarimi i debitorit të debitorit**

1. Organi përbarues me propozimin e kreditorit, do të kërkojë nga debitori i debitorit që brenda dhjetë (10) ditëve nga dorëzimi i urdhrin nga organi përbarues të deklarohet për faktin nëse dhe në çfarë shume e pranon kredinë e sekuestruar dhe se a është i gatshëm ta shlyej borxhin, si dhe nëse detyrimi i tij për ta shlyer borxhin është i kushtëzuar nga përmbushja e ndonjë detyrimi tjetër.
2. Propozimin për deklarimin e debitorit të debitorit, kreditori mund ta bashkojë me propozimin për përbarim, ose ta japë me parashtrësë të veçantë pas këtij propozimi, por jo më vonë se deri në kalimin e kredisë.
3. Deklarimi i debitorit të debitorit do të dërgohet me postë në adresat e regjistruara të kreditorit dhe debitorit brenda pesë (5) ditëve nga dita e pranimin nga organi përbarues.

**Neni 125**  
**Përgjegjësia e debitorit të debitorit**

1. Debitori i debitorit i përgjigjet kreditorit për dëmin që i ka shkaktuar duke mos u deklaruar fare, apo duke u deklaruar në mënyrë të pasaktë, apo jo të plotë. Kreditori mund të kërkojë kompensim përmes

procedurës kontestimore për të mbuluar dëmet nga debitori i debitorit. Dëmet e vlerësuara përbëhen nga kërkesa e plotë e debitorit, si dhe kompensimi për çfarëdo pagese nëse ka dëme shtesë.

2. Organi përmbaues do ta paralajmërojë debitorin e debitorit për këtë përgjegjësi të tij.

### **KREU III**

#### **KALIMI (TRANSFERI) I KREDISË**

##### **Neni 126**

##### **Llojet e kalimit të kredisë**

1. Kredia e sekuestruar i kalohet kreditorit në pajtim me propozimin e tij për arkëtim ose në vend të pagesës.

2. Në qoftë se kreditori nuk e cakton në mënyrë decitive llojin e kalimit të kredisë, konsiderohet se e propozon kalimin me qëllim arkëtimi.

##### **Neni 127**

##### **Aktvendimi për kalimin e kredisë**

1. Aktvendimi apo urdhri për kalimin e kredisë nxirret vetëm pasi të bëhet i formës së prerë aktvendimi apo urdhri për sekuestrimin.

2. Në qoftë se kreditori ka propozuar që debitori i debitorit të deklarohet për kredinë për të cilën propozohet përmbarimi, organi përmbaues do të nxjerrë aktvendimin apo urdhrin për propozimin për kalimin, pas skadimit të afatit prej tre (3) ditësh, nga dita kur kreditorit i është dërguar njoftimi për deklarimin e debitorit të debitorit.

##### **Neni 128**

##### **Pagimi i shumës në llogarinë e organit përmbaues**

Në aktvendimin për përmbarimin, urdhrin për përmbarim apo në aktvendimin e posaçëm për kalimin e kredisë, do të ftohet debitori i debitorit që shumën e detyruar të hollave t'ia deponojë organit përmbaues duke paguar në llogarinë e caktuar dhe për një gjë të tillë ta njoftojë organin përmbaues.

##### **Neni 129**

##### **Kushtet e posaçme për kalimin e kredisë së papjesëtueshme**

1. Kredia që bazohet në letrën me vlerë, që kalohet me nënshkrim, ose për realizimin e së cilës nevojitet parashtrimi i kësaj letre, ose që për shkaqe tjera nuk mund të pjesëtohet lidhur me kalimin ose realizimin, mund të kalohet vetëm në shumën e saj të plotë.

2. Në qoftë se kjo shumë e tejkalon shumën e kërkesës së kreditorit të ekzekutimit, kredia e sekuestruar do të kalohet vetëm pasi kreditori të depozitoj garancion se këtë tepëriçë do t'ia dorëzojë organi përmbaues.

##### **Neni 130**

##### **Kalimi i kredisë pjesërisht të përjashtuar nga përmbarimi**

1. Kredia që pjesërisht është e përjashtuar nga përmbarimi i detyrueshëm, apo e cila është sekuestruar në dobi të personave të tjerë, kalohet vetëm pasi që kreditori të depozitoj garancion se organi përmbaues do t'ia dorëzojë pjesën që është përjashtuar nga përmbarimi i detyrueshëm.

2. Po qe se më tepër kreditorë kanë paraqitur propozime për kalim të kredisë jo në ditë të njëjtë, organi përmbaues do ta bëjë kalimin e kredisë në kreditorin e përmbarimit që e ka paraqitur propozimin i pari. Në qoftë se më tepër propozues të përmbarimit kanë paraqitur propozimin në të njëjtën ditë, kredia do të kalohet në propozuesin e përmbarimit kërkesa e të cilit është më e madhe.



**Neni 131**  
**Kryerja e kalimit (transferit)**

1. Kalimi i kredisë së bazuar në letrën me vlerë, e cila pas sekuestrimit të bërë i merret debitorit të debitorit, quhet e kryer në momentin kur organi përmbaues letrën në të cilën shënohet vendimi për kalimin i dorëzohet kreditorit.
2. Kalimin e kredisë së bazuar në letrën me vlerë që kalohet me nënshkrim, apo për realizimin e së cilës nevojitet parashtrimi i saj, quhet e kryer në momentin kur organi përmbaues në letrën e tillë e venë vendimin për kalimin dhe letrën e pajisur me vendimin e tillë ia dorëzon kreditorit.

**Neni 132**  
**Detyrimet e debitorit dhe të kreditorit**

1. Debitori ka për detyrë që në afatin e caktuar nga organi përmbaues, e me kërkesën e kreditorit në të cilin është bartur kredia, t'i jep shpjegime kreditorit që i janë të nevojshme për realizimin e kredisë së tillë dhe t'ia dorëzojë dokumentet që kanë të bëjnë me këtë kredi.
2. Kreditori në të cilin është bartur vetëm një pjesë nga kredia, ka për detyrë që në qoftë se debitori e kërkon këtë, brenda afatit të cilin e cakton organi përmbaues të jep garancion se pas realizimit të kredisë së tillë, do t'i kthejë dokumentet që kanë të bëjnë me kredinë.
3. Organi përmbaues, me propozimin e kreditorit, do ta zbatojë përmbarimin e detyrueshëm kundër debitorit për dorëzimin e dokumenteve, po qe se ai vetë nuk i dorëzon.
4. Dorëzimin e dokumenteve që ndodhen të personi i tretë, kreditori mund ta kërkojë me anë të padisë, po qe se këtë të drejtë e ka debitori.
5. Në dokumentin që i dorëzohet kreditorit, organi përmbaues do të shënoj se është kryer kalimi i kredisë për të cilën është caktuar përmbarimi.

**Neni 133**  
**Depozitimi i të hollave te organi përmbaues**

1. Debitori i debitorit të cilit i është dorëzuar aktvendimi për përmbarimin, apo urdhri për përmbarim, ose aktvendimi i posaçëm për kalimin, e përmbushë obligimin e vet duke depozituar shumën e të hollave, apo letrat me vlerë, te organi përmbaues.
2. Në qoftë se me qëllim të realizimit të kredisë në të holla të kaluara, kreditori është dashur të fillojë procedurë gjyqësore apo procedurë tjetër, atëherë Gjykata apo organi tjetër që zhvillon procedurën, në vendimin me të cilin e miraton kërkesën e kreditorit të përmbarimit do ta urdhërojë debitorin e debitorit që shumën e detyruar ta depozitoj te organi përmbaues.
3. Në bazë të vendimit me të cilin debitori i debitorit është urdhëruar që shumën e detyruar ta depozitoj te organi përmbaues, sipas kreditorit të propozuesit të përmbarimit në të cilin është bartur kredia, do të zbatohet përmbarimi kundër debitorit të debitorit dhe të hollat e realizuar me këtë përmbarim pas pagimit të shpenzimeve procedurale sipas detyrës zyrtare, do t'i dërgohen organit përmbaues.

**Neni 134**  
**Autorizimet e kreditorit të përmbarimit**

1. Me kalimin e kredisë me qëllim arkëtimi, dhe për qëllim të njoftimit të debitorit të debitorit për transferimin, autorizohet kreditori që të kërkojë nga debitori i debitorit përmbarimor pagimin e shumës së shënuar në aktvendimin apo urdhrin e përmbarimit, apo në aktvendimin e posaçëm për kalimin, në qoftë se kjo shumë është bërë e kërkueshme, t'i kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për ruajtjen

dhe realizimin e kredisë së kaluar, si dhe t'i shfrytëzojë të gjitha të drejtat lidhur me pengun të dhënë për sigurimin e kredisë së këtillë.

2. Me kalimin e kredisë me qëllim arkëtimi, kreditori nuk ka të drejtë që në barrë të debitorit të lidhë ujdë, apo që debitorit të debitorit t'ia falë borxhin, ose që të disponoj me kredinë e kaluar, si dhe që me debitorin e debitorit të merret vesh që vendimin për kredinë, po qe se është kontestuese ajo ta nxjerrë arbitrazhi.

3. Kreditorit në të cilin është bartur kredia për arkëtim, debitori i debitorit mund t'ia bëjë vetëm ato prapësime që do të mund t'ia bënte debitorit.

4. Cedimi i kredisë së bartur i bërë nga debitori pas kalimit të saj, nuk ka efekt juridik kundrejt të drejtave që i ka fituar kreditori në momentin e kalimit të saj.

#### **Neni 135**

#### **Kalimi për arkëtim të kredisë së regjistruar në librin publik**

Kalimi me qëllim arkëtimi të kredisë së regjistruar në librin publik, shënohet në të sipas detyrës zyrtare.

#### **Neni 136**

#### **Kushtëzimi i debisë së debitorit të debitorit me dorëzimin e sendit**

1. Në qoftë se debia e debitorit të debitorit për pagimin e borxhit varet nga detyrimi i debitorit që t'ia dorëzojë sendin e caktuar i cili ndodhet në posedimin e debitorit, e ky detyrim është vërtetuar se ekziston me vendim të formës së prerë, organi përmbaues me propozimin e kreditorit të cilit i është kaluar kredia me qëllim të arkëtitimit, do ta urdhërojë debitorin e përmbaimit që t'ia dorëzojë sendin organit përmbaues me qëllim që kjo t'ia dorëzojë atë debitorit të debitorit.

2. Me kërkesën e kreditorit, organi përmbaues, ndaj debitorit që nuk e ka dorëzuar sendin brenda afatit të caktuar, do të zbatojë përmbaimit me qëllim të dorëzimit të sendit.

#### **Neni 137**

#### **Njoftimi i debitorit për padinë me qëllim arkëtimi të kredisë së kaluar**

Kreditori që e ka ngritur padinë me qëllim të arkëtitimit të kredisë që i është kaluar, ka për detyrë që brenda pesë ditësh ta njoftojë debitorin për procesin kontestimor të filluar, sepse në të kundërtën i përgjigjet debitorit për dëmin që i është shkaktuar nga mos njoftimi.

#### **Neni 138**

#### **Vonesa në arkëtimin e kredisë së kaluar**

1. Kreditori që nuk kujdeset si duhet për arkëtimin e kredisë së bartur, përgjigjet për dëmin që me këtë gjë i është shkaktuar kreditorit tjetër të përmbaimit që e ka të drejtën e pengut, apo të drejtën tjetër që shlyhet nga kredia.

2. Në rastin nga paragrafi 1. i këtij neni, organi përmbaues me propozim të kreditorit tjetër, mund ta prishë aktvendimin apo urdhrin për kalimin e kredisë në kreditorin e parë dhe kredinë t'ia kalojë kreditorit tjetër.

#### **Neni 139**

#### **Pagimi i kreditorit**

Kreditori në të cilin është kaluar kredia për arkëtim, konsiderohet i përmbushur në lartësinë në të cilën e ka arkëtuar kredinë e këtillë.

#### **Neni 140**

#### **Arkëtimi i shumës më të madhe se që i takon kreditorit**

1. Kreditori i cili nga kredia që i është kaluar e ka arkëtuar shumën ma të madhe se që është kërkesa e tij, ka për detyrë që atë pjesë të kredisë ta depozitojë te organi përmbarues.
2. Tepricën e tillë organi përmbarues ua dorëzon kreditorëve të tjerë të siguruar me anë të pengut, si dhe debitorit, po që se u takon e drejta për një gjë të tillë.
3. Kreditorit që e ka depozituar tepricën e shumës së arkëtuar, organi përmbarues ia kthen garancionin e depozituar.

**Neni 141**  
**Kalimi i kredisë së sekuestruar**

1. Kredia e sekuestruar kalon me bartjen në vend të pagesës te kreditori , deri në shumën e bartur me efekt të cedimit të kredisë me shpërblim.
2. Në qoftë se kredia e bartur është e siguruar me të drejtën e pengut të regjistruar në librin publik, organi përmbarues sipas detyrës zyrtare, do t'i kalojë të drejtat e debitorit të kreditori dhe do ta fshijë të drejtën e pengut të regjistruar në dobi të debitorit.
3. Kreditori në të cilin është bërë kalimi i kredisë në vend të pagimit, konsiderohet i përmbushur edhe me vetë faktin e kalimit, në lartësinë e kësaj kredie të bartur.
4. Me dispozitat e paragrafit 3. të këtij neni, nuk preken rregullat për përgjegjësinë e debitorit për vërtetësinë dhe realizueshmërinë e kredisë së bartur.

**KREU IV**

**PËRMBARIMI NË TË ARDHURAT PERSONALE DHE NË TË ARDHURAT TJERA TË PËRHERSHME NË TË HOLLA**

**Neni 142**  
**Aplikimi i dispozitave lidhur me Përmbarimin për Kreditë të Debitorit**

Lidhur me përmbarimin për të ardhurat personale dhe për të ardhurat tjera të përhershme në të holla, aplikohen dispozitat e nenit 109 deri 141 të këtij ligji, po që se me dispozitat e nenit 143 deri në nenin 151 të këtij ligji, nuk është paraparë diç tjetër.

**Neni 143**  
**Aktvendimi për përmbarimin ose Urdhri për përmbarim**

1. Me aktvendimin për përmbarimin ose urdhrin për përmbarim në të ardhurat personale caktohet sekuestrimi i pjesës së caktuar i të ardhurave personale dhe urdhërohet punëdhënësi i cili debitorit, ia paguan ato që shuma e të hollave për të cilën është caktuar përmbarimi t'i paguhet kreditorit të përmbarimit që nga momenti në të cilin bëhet i formës së prerë aktvendimi për përmbarimin ose urdhri për përmbarim, po që se me këtë ligj nuk parashihet ndonjë mënyrë tjetër e veprimit.
2. Punëdhënës sipas këtij ligji quhet organi shtetëror, personi juridik, apo personi tjetër i cili debitorit të përmbarimit i paguan të ardhura personale.
3. Aktvendimi për përmbarimin i përket edhe rritjes së të ardhurave që mund të bëhet pas dorëzimit të aktvendimit për përmbarimin ose urdhrin për përmbarim, si dhe të gjitha të ardhurave të tjera të debitorit në bazë të punës.
4. Të ardhura personale në kuptimin e këtij ligji quhen të ardhurat e caktuara me anë të dispozitave për punën.

**Neni 144**  
**Informatat nga punëdhënësi**

Punëdhënësi është i obliguar të informojë organin përbarues nëse debitori është punonjës i tij, dhe për lartësinë e pagës së debitorit tek ky punëdhënësi. Ky informacion duhet të sigurohet brenda pesë (5) ditëve prej ditës së kërkesës nga organi përbarues.

#### **Neni 145**

#### **Përbarimi kur të drejtën e ushqimit ligjor e kanë më tepër persona**

1. Në qoftë se të drejtën e ushqimit ligjor, respektivisht të drejtën e rentës për ushqimin e humbur për shkak të vdekjes së dhënësit të ushqimit ndaj të njëjtit debitor e kanë disa persona, ndërsa shuma e gjithëmbarshme e kërkesave të tyre e tejkalon pjesën e të ardhurave personale që mund të jetë objekt përbarimi të detyrueshëm, atëherë përbarimi caktohet dhe zbatohet në dobi të secilit nga ta, në përpjesëtim me madhësinë e kërkesave të tyre.

2. Në qoftë se pas fillimit të zbatimit të përbarimit për të ardhurat personale, respektivisht për të ardhurat e tjera të përhershme në të holla, paraqitet propozimi i ri për përbarim për kredinë nga paragrafi 1. i këtij neni, organi përbarues do ta ndryshojë sipas detyrës zyrtare aktvendimin apo urdhrin e nxjerrë më parë për përbarimin në kuptimin e paragrafit 1. të këtij neni dhe do ta caktojë shumën e cila në të ardhmen do t'i paguhet secilit nga kreditorët.

3. Në rastin nga paragrafi 2. i këtij neni, aktvendimi për përbarimin ose urdhri për përbarim duhet t'i dorëzohet edhe kreditorit të mëhershëm, i cili kundër këtij aktvendimi apo urdhri ka të drejtë prapësimi.

#### **Neni 146**

#### **Vendi i pagesës**

1. Kreditë për të cilat nuk është parashikuar pagesa në para jo të gatshme, kreditori i arkëton drejtpërdrejt në arkën në të cilën debitorit i paguhet të ardhurat personale.

2. Kreditori ka të drejtë të kërkojë që shuma e ndalur t'i paguhet me anë të postës në adresën që e tregon, apo në llogarinë e caktuar bankare, pas zbritjes së shpenzimeve të postës.

#### **Neni 147**

#### **Pushimi i marrëdhënies së punës**

1. Në qoftë se debitorit i pushon marrëdhënia e punës, aktvendimi për përbarimin ose urdhri për përbarim prodhon efekt juridik edhe ndaj punëdhënësit tjetër të i cili debitori krijon marrëdhënie pune, dhe atë prej ditës në të cilën punëdhënësit të këtillë i është dorëzuar aktvendimi për përbarimin ose urdhrin për përbarim.

2. Punëdhënësi i mëparshëm i debitorit, ka për detyrë që pa vonesë me anë të letrës rekomande t'ia dërgojë aktvendimin për përbarimin ose urdhrin për përbarim punëdhënësit të ri dhe për një gjë të tillë ta njoftojë organin përbarues.

3. Punëdhënësi i mëparshëm ka për detyrë që ta njoftojë organin përbarues pa vonesë për pushimin e marrëdhënies së punës me debitorin, po qe se nuk i është i njohur punëdhënësi i ri, për të cilën gjë organi përbarues do ta njoftojë kreditorin, duke ia caktuar një afat brenda të cilit ky i fundit duhet të mbledhë të dhëna për punëdhënësin e ri të debitorit.

4. Po qe se kreditori nuk e njofton organin përbarues për punëdhënësin e dytë brenda afatit që ia ka caktuar, atëherë organin përbarues e pezullon procedurën e përbarimit.

#### **Neni 148**

#### **Përgjegjësia e punëdhënësit për mospagimin e kësteve të kërkueshme**

1. Kreditori mund t'i propozojë organin përbarues në procedurën e ekzekutimit që me anë të aktvendimit apo urdhrit, ta urdhërojë punëdhënësin e debitorit të përbarimit që t'ia paguajë të gjitha këstet të cilat nuk ia ka ndalur debitorit sipas aktvendimit apo urdhrit për përbarim.

2. Kërkesën nga paragrafi 1. të këtij neni, kreditori mund ta paraqesë deri në përfundimin e procedurës përbarimore.

3. Aktvendimi apo urdhri me të cilin miratohet kërkesa e kreditorit të përmbarrimit e ka efektin juridik të aktvendimit për përmbarrimin ose urdhrin për përmbarrim.

#### **Neni 149**

#### **Përgjegjësia e punëdhënësit për mos ndalimin e kësteve**

Punëdhënësi i cili nuk ka vepruar sipas aktvendimit apo urdhrin për përmbarrimin, ose që nuk ka vepruar sipas paragrafit 2 dhe 3. të nenit 147 të këtij ligji, përgjigjet për dëmin që e ka pësuar kreditori nga mosveprimi i tillë i tij.

#### **Neni 150**

#### **Sekuestrimi me pëlqimin e debitorit**

1. Debitori ka të drejtë që me anë të dokumentit të vërtetuar ta jep pëlqimin që me qëllim të realizimit të kërkesës së kreditorit të tij, të sekuestrohet një pjesë e të ardhurave personale të tij dhe t'i paguhet drejtpërdrejt kreditorit në mënyrën e caktuar në dokumentin e tillë.

2. Dokumenti nga paragrafi 1. i këtij neni e ka efektin juridik të aktvendimit për përmbarrim ose urdhrin për përmbarrim.

3. Dokumentin nga paragrafi 1. të këtij neni, me efekte të dorëzimit të aktvendimit për përmbarrimin ose urdhrin për përmbarrim, punëdhënësit të debitorit ia dërgon kreditori me anë të letrës rekomande. Përkrahimisht nga dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni, sekuestrimi në bazë të pëlqimit të debitorit nuk prodhon efekte juridike në zbatimin e përmbarrimit për të ardhurat personale për përmbushjen e kredisë në bazë të ushqimit ligjor, shpërblimit të dëmit të shkaktuar, cenimit të shëndetit, ose zvogëlimin, respektivisht humbjes së aftësisë punuese dhe të shpërblimit të dëmit për bazën e humbjes së ushqimit për shkak të vdekjes së dhënësit të ushqimit.

#### **Neni 151**

#### **Zbatimi i dispozitave të këtij kreu**

Dispozitat e këtij ligji për përmbarrimin në të ardhura personale dhe mjete tjera monetare të përhershme zbatohen në mënyrë të përshtatshme edhe në procedurën e përmbarrimit për të ardhurat tjera të përhershme në të holla të debitorit.

### **KREU V**

### **PËRMBARRIMI PËR KREDINË SIPAS LLOGARISË NË BANKË**

#### **Neni 152**

#### **Përmbarrimi i detyrueshëm**

1. Përmbarrimi për realizimin e kredisë në të holla kundër debitorit, mundë të zbatohet për të gjitha mjetet monetare që i ka në llogaritë e tija në bankë, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe.

2. Me aktvendimin për përmbarrimin ose urdhrin për përmbarrim në mjetet monetare që evidentohen në llogarinë e transaksionit të debitorit, urdhërohet banka që shumën e të hollave për të cilën është caktuar përmbarrimi, ta kalojë nga llogaria e transaksioneve të debitorit në llogarinë e transaksioneve të kreditorit, kurse për kreditë për të cilat nuk është paraparë pagimi nëpërmjet llogarisë në bankë, që t'ia paguajë shumën e tillë kreditorit me para të gatshme.

3. Përmbarrimi për kredinë në të holla, e cila sipas kursimit të depozituar, llogarisë rrjedhëse, llogarisë devizore, apo llogarisë tjetër në bankë, duke përjashtuar llogarinë e transaksionit të debitorit, i takon debitorit dhe caktohet ashtu që me anë të aktvendimit apo urdhrin për përmbarrimin, urdhërohet banka që shumën e të hollave për të cilën është caktuar përmbarrimi, t'ia paguajë kreditorit shumën e përcaktuar për përmbarrim.

4. Aktvendimi apo urdhri nga paragrafi 3. i këtij neni, i ka efektet e aktvendimit apo urdhrimit për përbarimin me të cilin caktohet sekuestrimi i kredisë në të holla dhe kalimi për arkëtim.

5. Në aktvendimin apo urdhrin për përbarimin nga paragrafi 1., 2. dhe 3. të këtij neni, shënohet numri i llogarisë së debitorit nga i cili duhet bërë pagesa dhe numri i llogarisë së propozuesit të përbarimit në të cilin duhet bërë pagesa, apo mënyra tjetër e kryerjes së pagesës.

#### **Neni 153**

#### **Kompetenca territoriale në rast të përbarimit gjyqësor**

Kërkesa për përbarim në para të gatshme në xhirollogarinë e debitorit futet në juridiksionit të Gjykatës ku gjendet selia e bankës apo në territorin ku gjendet njësia organizative e bankës në të cilën debitori mban xhirollogarinë e tij.

#### **Neni 154**

#### **Kompetenca në rast të përbarimit nga përbaruesi privat**

Per të vendosur për propozimin përbarimor për përbarim në para të gatshme në xhirollogarinë, përbaruesi privat ka kompetencë për të vendosur mbi propozimin përbarimor dhe ta zbatojë përbarimin.

#### **Neni 155**

#### **Detyrimi i dërgimit të dhënave për llogarinë**

1. Organi përbarues do t'ia dorëzojë drejtpërdrejt bankës vendimin për përbarim ose urdhrin për përbarim. Personi zyrtar i bankës do të regjistron datën dhe kohën kur i është dorëzuar bankës aktvendimi apo urdhri për përbarim. Një kopje e këtij aktvendimit apo urdhrin për përbarim i dërgohet edhe Bankës Qendrore të Kosovës.

2. Me aktvendimin për përbarim ose urdhrin për përbarim, organi përbarues e obligon bankën që të informojë me kohë organin përbarues se a ka debitori llogari në bankë dhe që t'ia zbulojë asaj të gjithë numrat e llogarive që i ka debitori në bankë. Nëse debitori i cili është borxhli vërtetohet që është klient apo ka qenë klient, se ka ndonjë llogari në atë bankë, banka është e obliguar që t'ia dërgojë organit përbarues të gjithë historinë e transaksioneve në të gjitha llogaritë e debitorit në atë bankë së paku për periudhën që fillon tridhjetë (30) ditë para datës së nxjerrjes së aktvendimit apo urdhrin për përbarim nga ana e organit përbarues e që përfundon me përfundimin e orarit të punës një ditë para datës kur i dërgohet organit përbarues historia e transaksioneve. Kjo histori e transaksioneve do të jetë transkript i saktë i shënimeve normale të bankës për llogaritë, e përpiluar nga banka gjatë aktiviteteve të tyre të rregullta të punës, dhe do të përmbajë çdo transaksion në ato llogari, duke përfshirë edhe tërheqjen e parave të gatshme, shumat e zbritura ose tërheqjet nga llogaritë e debitorit, e po ashtu edhe transferet brenda bankës dhe ndërmjet bankave.

3. Banka është e obliguar të përgjigjet në kërkesën e organit përbarues për informacione, sipas paragrafi 2. të këtij neni, për ekzistencën e llogarive në bankë që janë në pronësi të debitorit, jo më larg se njëzet e katër (24) orë pas pranimit të kërkesës nga organi përbarues. Banka është e obliguar të paraqes historinë e transaksioneve për secilin llogari, sipas paragrafit 2. të këtij neni brenda tre (3) ditësh nga pranimi i kërkesës. Banka do të mbajë shënime ku tregohet data dhe koha kur janë pranuar të gjitha urdhrat e organit përbarues.

4. Banka do ti dërgoj organit përbarues njoftimin për të gjitha ndryshimet e bëra pas datës në të cilën historia e transaksioneve, sipas paragrafit 2. të këtij neni, i është dërguar bankës. Këto njoftime do ti dërgohen organi përbarues brenda një dite pune për secilin transaksion në llogari, përfshirë edhe depozitat ose tërheqjet e parave të gatshme, shumat e zbritura apo tërheqjet nga llogaritë e debitorit, si dhe transferet e tyre brenda bankës apo ndërmjet bankave.

5. Pasi banka të ketë marrë nga organi përbarues urdhrin për transferet, sipas nenit 152 të këtij ligji, agjenti i bankës që pranon urdhrin e regjistron kohën dhe datën e saktë në të cilën është pranuar urdhri për transferet, dhe ai informacion do të regjistrohet në shënime normale të punës së bankës.

6. Nëse ka fonde të mjaftueshme në ndonjërin apo në të gjitha llogaritë e debitorit për të paguar kredinë në kohën kur merret urdhri për transferet, banka, brenda gjashtëdhjetë (60) minutash nga koha e pranimit të urdhrit për transferet, do t'i transferojë fondet nga llogaria e debitorit në llogarinë e organit përmbarues në emër të kreditorit të shënuar në urdhrin për transferet; koha e saktë e transferit regjistrohet në shënimet e zakonshme të punës së bankës, dhe i raportohet organit përmbarues si pjesë e raportit që banka ia dërgon organit përmbarues duke shënuar kohën e marrjes së urdhrit të organit përmbarues, kohën dhe shumën e transferit, numrin ose numrat e llogarive nga të cilat janë tërhequr fondet dhe pala ose numri i llogarisë që e pranon transferin.

7. Nëse fondet në llogari janë të pamjaftueshme për të përmbushur urdhrin për transfer, banka do të bëjë menjëherë bllokimin e të gjitha llogarive të debitorit në fjalë, duke parandaluar çdo tërheqje të fondeve, për çfarëdo qëllimi apo në çfarëdo forme, derisa banka të ketë përmbushur shumën e cekur në urdhrin e organit përmbarues ose derisa të hiqet urdhri i organit përmbarues. Ky bllokim i llogarive nuk do të parandalojë deponimin fondeve në llogari. Banka e informon organin përmbarues për vendosjen e bllokimit, do të theksojë numrin e llogarisë apo llogarive që janë bllokuar, kohën dhe datën kur është bërë bllokimi i atyre llogarive, dhe për shumën që gjendet në secilën llogari. Pas marrjes së urdhrit për transfer, debitori i përmendur në urdhër nuk do të lejohet të hap llogari të tjera në bankë derisa të jetë përmbushur urdhri, ose derisa të hiqen urdhrat e organit përmbarues për bllokimin e llogarisë. Banka nuk mund të përmbush asnjë urdhër të debitorit deri sa ai t'ia ketë paguar organit përmbarues shumën e plotë të kredisë ose deri sa të informohet nga organi përmbarues se është hequr urdhri.

8. Organi përmbarues e njofton bankën për lirimin e llogarive të debitorit pas pagesës së plotë të kredisë, ose pas përfundimit të procesit përmbarimit.

9. Më kërkesën e organit përmbarues, banka është e obliguar që të ofrojë sqarime dhe dokumente Gjykatës që demonstrojnë se ajo ka respektuar urdhrin e transferit dhe të gjithë urdhrat e tjerë të organit përmbarues.

10. Të dhënat që banka ia dërgon organit përmbarues dhe që kanë të bëjnë me transferin e mjeteve monetare ndërmjet bankave duhet të përmbajnë, mes tjerash, edhe emrin e marrësit dhe numrin e llogarisë së tij në bankën që ka pranuar transferin.

11. Nëse banka dhe personat zyrtarë të saj nuk veprojnë në përputhje me këto dispozita do ti nënshtrihen ndëshkimeve sipas nenit 15 të këtij ligji.

#### **Neni 156 Radha e pagesave**

1. Banka e bënë pagesën me radhë sipas kohës së dorëzimit të aktvendimeve apo urdhrave për përmbarimin, përveç se kur me ligj parashikohet ndryshe.

2. Banka mbanë evidencë të veçantë për radhitjen e aktvendimeve apo urdhrave për përmbarimin, sipas ditës dhe kohës së pranimit dhe kreditorit sipas kërkesës së tij, i jep vërtetim për vendin e kredisë së tij në radhitjen e tillë.

3. Banka nuk mund ta zbatojë urdhrin e debitorit para se ta përmbushë kredinë e caktuar me aktvendimin për përmbarimin ose urdhrin për përmbarim, po qe se me ligj nuk është paraparë ndryshe

4. Me aktvendimin për përmbarimin ose urdhrin për përmbarim barazohet dokumenti publik, për të cilin një gjë e tillë parashihet me ligj të veçantë.

#### **Neni 157 Pagesat periodike**

1. Në qoftë se me anë të aktvendimit për përmbarimin ose urdhrin për përmbarim, banka është urdhëruar që të bëjë pagesa të shumave të caktuara në periudha kohore të caktuara, atëherë debitori duhet bërë pagesat në pajtim me urdhëresën nga aktvendimi për përmbarimin ose urdhri për

përmbaram. Llogaritë e debitorit duhet të mbesin të bllokuara derisa nuk është transferuar shuma e plotë e borxhit apo derisa organi përmbarues nuk ka urdhëruar zhblokimin e llogarive.

2. Në rastet nga paragrafi 1. të këtij neni, radha e pagesave të kësteve të ardhshme llogaritet sipas kohës së dorëzimit të aktvendimit për përmbarimin ose urdhrin për përmbarim.

3. Banka e mbanë evidencën e posaçme të aktvendimeve për përmbarimin dhe urdhrin për përmbarim me të cilat janë urdhëruar pagesat e ardhshme periodike.

4. Banka duhet të informojë organin përmbarues apo personin zyrtar të Gjykatës për çfarëdo pengesash në lidhje me pagesën, veçanërisht me mos vazhdimësinë e depozitimit periodik të pagesave në llogarinë e debitorit

#### **Neni 158**

##### **Veprimi në rastet kur nuk ka mjete në llogari**

1. Në qoftë se në llogarinë e shënuar në aktvendimin për përmbarimin ose urdhrin për përmbarim nuk ka mjete, banka në llogarinë e tillë do t'i bartë mjetet monetare të debitorit nga llogaritë tjera që ai i ka të kjo bankë. Një gjë të tillë banka e bënë sipas radhës që e cakton kreditori dhe në shumat e caktuara me aktvendimin për përmbarimin ose urdhrin për përmbarim.

2. Po qe se banka nuk arrin që në tërësi ta përmbushë kredinë përmbarimore nga shkak i mosekzistimit të mjeteve të mjaftueshme në llogarinë e debitorit, atëherë ajo do ta mbajë në evidencë të posaçme dhe sipas tij do ta bëjë bartjen posa të arrijnë mjete në llogari, përveç se kur me aktvendimin për përmbarimin ose urdhrin për përmbarim parashihet ndryshe.

3. Për faktin e mosekzistimit të mjeteve në llogarinë e debitorit, banka pa vonesë duhet ta njoftojë organin për përmbarim. Bashkë me njoftimin banka ia dërgon organit për përmbarim edhe njoftimin për ndryshimet në gjendjen e llogarisë së debitorit.

#### **Neni 159**

##### **Veprimi në rast të pengesave për kryerjen e përmbarimit**

1. Nëse banka konsideron se ekzistojnë pengesa ligjore, për përmbarimin sipas dispozitave të këtij kreu të këtij ligji, atëherë ajo do ta mbajë aktvendimin për përmbarimin ose urdhrin për përmbarim, do ta kryejë sekuestrumin e mjeteve të debitorit dhe do ta njoftojë organin përmbarues për ekzistimin e pengesave për përmbarim.

2. Po qe se është fjala për pengesa të natyrës afatgjata, organi për përmbarim do ta pezullojë procedurën përmbarimore, kurse në rastet e shkaqeve të tjera ajo e njofton kreditorin dhe bankën për veprimet e mëtutjeshme.

#### **Neni 160**

##### **Përmbarimi ndaj debitorit me përgjegjësi solidarë**

1. Në qoftë se në bazë të dokumentit përmbarimorë dy apo më tepër debitor janë përgjegjës solidar, atëherë organi për përmbarim sipas kërkesës së kreditorit, kundër tyre e nxjerrë vetëm një aktvendim për përmbarimin ose urdhrin për përmbarim, me të cilin bëhet sekuestrimi i llogarisë së debitorëve në shumat e caktuara me anë të aktvendimit për përmbarimin ose urdhrin për përmbarim.

2. Propozuesi mund ta caktojë në propozimin për përmbarimin radhën e debitorëve sipas të cilës do të bëhet marrja e mjeteve nga debitorët, e në qoftë se ai nuk e ka bërë këtë, marrja e mjeteve do të bëhet sipas asaj radhe që janë përmendur debitorët në propozimin për përmbarim.

3. Në qoftë se në rastin nga paragrafi 2. i këtij neni, në llogarinë e debitorit solidar nuk ka mjete të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimit, banka ia dërgon aktvendimin për përmbarimin ose urdhrin për përmbarim për zbatim bankës së debitorit tjetër solidar, bashkë me raportin për përmbarimin e kryer deri në atë moment, dhe për këtë ajo duhet ta njoftojë pa vonesë edhe organin përmbarues.

#### **Neni 161**

##### **Përmbarimi në disa llogari**



1. Në qoftë se debitori ka mjete monetare në disa llogari të një banke apo më tepër sosh, atëherë propozuesi mund të caktojë në propozimin e tij për përmburim radhën sipas së cilës duhet të ngarkohen llogaritë dhe në rast se propozuesi nuk e bën këtë atëherë llogaritë ngarkohen me radhë siç janë përmendur në propozimin për përmburim.

2. Në qoftë se propozimi për përmburim identifikon më shumë se një bankë në të cilën debitori ka llogari, propozuesi mund të caktojë në propozimin për përmburim mënyrë në të cilën bankat do të ngarkohen dhe po qe se propozuesi nuk e bën këtë, llogaritë duhet të ngarkohen në bazë të mënyrës në të cilat janë përmendur në propozimin për përmburim. Në qoftë se llogaritë e debitorit në bankën e parë nuk përmbajnë mjete të mjaftueshme për të përmbushur detyrimin, banka do të njoftojë organin përmburues dhe organin përmburues do të dërgojë aktvendimin apo urdhrin për përmburimin në bankën tjetër të përcaktuar nga propozuesi ose bankën e radhës të përmendur në aktvendimin apo urdhrin për përmburimin.

3. Propozuesi i përmburimit mund të propozojë pagesën e llogarive në bankat e shumta në të njëjtën kohë dhe organin përmburues mund të akordojë të drejtën për ta bërë këtë. organi për përmburim mundet të zgjedhe që llogaritë në bankat e ndryshme të ngarkohet proporcionalisht me vlerën totale të llogarive të debitorit që mbahet në ato banka

#### **Neni 162**

#### **Përmburimi për mjetet në llogarinë devizore**

Nëse përmburimi është i një kredie në vlerë të valutës së huaj, mjetet në llogarinë bankare të debitorit duhet të konvertohen sipas kursit të këmbimit referues të bankës qendrore Evropiane siç është në ditën e transferit në llogarinë e kreditorit.

#### **Neni 163**

#### **Përmburimi për realizimin e kredisë në valutë të huaj**

1. Në qoftë se kredia e konstatuar në dokumentin përmburues përbëhet nga të hollat në valutë të huajë dhe po qe se debitori e ka llogarinë devizore në valutë të tillë, me aktvendimin për përmburim ose urdhrin për përmburim urdhërohet banka të e cila ndodhet llogaria devizore e debitorit, që ta bartë shumën përkatëse në valutë të huajë, nga llogaria e debitorit në llogarinë e kreditorit, ose që pagesën në valutë të huaj ta bëjë në ndonjë mënyrë tjetër të lejueshme me ligj.

2. Kreditori mund të kërkojë që përmburimi për përmbushjen e kredisë së tij në valutën e huajë të caktuar, të lejohet dhe zbatohet në llogaritë tjera, apo në sendet tjera të debitorit, si përmburim për realizimin e kredisë së tij në shumën që është e nevojshme për blerjen e mjeteve devizore të detyruara nga personi i autorizuar.

3. Dispozitat e paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni, zbatohen edhe në rastet në të cilat përmburimi caktohet kundër debitorëve që nuk janë persona juridik.

#### **Neni 164**

#### **Sekuestrimi i llogarisë me pëlqimin e debitorit**

1. Debitori ka të drejtë që me anë të dokumentit të vërtetuar ta jep pëlqimin që me qëllim të përmbushjes së kërkesës së kreditorit, të sekuestrohet llogaria e caktuar e tij te banka dhe që mjetet në të holla nga llogaria e tillë, në pajtim me deklaratën e tij të përmbajtur në dokumentin e vërtetuar, drejtpërdrejtë nga llogaria t'i paguhen kreditorit. Dokumenti i verifikuar i prodhon efektet juridike që i prodhon aktvendimi i formës së prerë për përmburimin ose urdhrin të prerë për përmburim me të cilin sekuestrohet kredia sipas llogarisë dhe bartet te kreditori për arkëtim.

2. Dokumentin nga paragrafi 1. të këtij neni, bankës ia dorëzon kreditori me efekt të dorëzimit të aktvendimit gjyqësor të përmburimit ose urdhrin përmburimor, drejtpërdrejtë në administratën e saj, apo me anë të letrës rekomande.

3. Në përmburimin nga paragrafi 1. të këtij neni, në mënyrë të përshtatshme aplikohen dispozitat e nenit 150 të këtij ligji.

#### **Neni 165**

## **Përgjegjësia e bankës për dëmin e shkaktuar**

Banka e cila nuk vepron në pajtim me aktvendimin apo urdhrin për përmbartimin dhe urdhëresat tjera të organit përmbartues, përgjigjet për dëmin që i shkaktohet kreditorit të përmbartimit sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës civile për shpërbllimin e dëmit.

### **Neni 166**

#### **Zbatimi i dispozitave të Përmbartimit për kredinë në të holla të debitorit të përmbartimit**

Në procedurën e përmbartimit për kredinë sipas llogarisë në bankë, në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat e këtij ligji për përmbartimin për kredinë në të holla të debitorit nga nenet 109 – 141 të këtij ligji .

## **KREU VI**

### **PËRMBARTIMI MBI LETRAT ME VLERË DHE PJESËT NË SHOQËRITË TREGTARE**

#### **Neni 167**

##### **Kompetenca territoriale në rast të përmbartimit gjyqësor**

1. Për vendosje mbi propozimin për përmbartim kundër aksioneve në pronësi dhe letrave tjera me vlerë të regjistruara (në testin e mëposhtëm: letrat me vlerë), si dhe për kapitalin themelues ose kapitalin shtesë në një kompani aksionare apo çfarëdo forme tjetër ligjore të biznesit (në tekstin e mëtejshëm “shoqëritë tregtare”), kompetencë territoriale ka Gjykata në rajonin e të cilës ndodhet vendbanimi apo selia e debitorit si pronar i letrave me vlerë apo pjesëve të shoqërisë tregtare.

2. Në rast se debitori nuk e ka vendbanimin, vendqëndrimin, apo selinë në territorin e Kosovës, kompetencën territoriale e ka Gjykata në rajonin ku është selia e lëshuesit të letrave me vlerë apo selia e personit juridik në të cilin debitori e ka pjesën e pronësisë.

#### **Neni 168**

##### **Kompetenca në rast të përmbartimit nga përmbartuesi privat**

Për të vendosur për propozimin përmbartimor ndaj aksioneve në pronësi dhe letrave tjera me vlerë të regjistruara (në testin e mëposhtëm: letrat me vlerë), si dhe për kapitalin themelues ose kapitalin shtesë në një kompani aksionare apo çfarëdo forme tjetër ligjore të biznesit (në tekstin e mëtejshëm “shoqëritë tregtare”), përmbartuesi privat ka kompetencë për të vendosur mbi propozimin përmbartimor dhe të zbatojë përmbartimin.

#### **Neni 169**

##### **Veprimet përmbartimore**

1. Kundër letrave me vlerë, përmbartimi zbatohet me anë të sekuestrimit të letrave me vlerë, me vlerësimin e tyre dhe me përmbushjen e kredisë së propozuesit të përmbartimit. Përbartimisht, letra me vlerë me kërkesë të propozuesit të përmbartimit dhe me pëlqimin e debitorit mund të kalohet të propozuesit i përmbartimit në vlerën e saj të tregut, në datën e sekuestrimit, në vend të pagesës.

2. Për pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare, përmbartimi zbatohet me anë të sekuestrimit të pjesës, me vlerësimin dhe shitjen e saj, si dhe me përmbushjen e kredisë së kreditorit.

3. Veprimet përmbartimore të parapara në këtë nen, kryhen edhe po qe se me anë të kontratës, apo me anë të rregullave të tjera juridike të personit juridik është kufizuar, apo ndaluar tjetërsimi i letrave me vlerë, apo pjesëve në shoqërinë tregtare.

#### **Neni 170**

##### **Sekuestrimi i letrave me vlerë**

1. Sekuestrimi i letrave me vlerë bëhet me dorëzim të aktvendimit për përmbartimin ose urdhrin për përmbartim, institucionit që mbanë regjistrin e letrave me vlerë. Në të njëjtën kohë aktvendimi për përmbartimin i dërgohet edhe depozitarit dhe emetuesit të letrave me vlerë.

2. Aktvendimi përmbarues ose urdhri për përmbarim për kryerjen e përmbarimit kundër letrave me vlerë i dërgohet kreditorit dhe debitorit.
3. Në momentin e kryerjes së sekuestrimit, propozuesi i përmbarimit e fiton të drejtën e pengut mbi letrave me vlerë të sekuestruara.
4. Regjistri i letrave me vlerë, ka për detyrë që në Regjistër të konstatoj se është krijuar e drejta e pengut në dobi të propozuesit të përmbarimit në momentin kur i është dorëzuar aktvendimi për përmbarimin ose urdhri për përmbarim. Regjistri i letrave me vlerë ka për detyrë që pa vonesë ta njoftojë organin s përmbarues për pengesat ligjore për themelimin e të drejtës së pengut.
5. Pas regjistrimit të sekuestrimit në regjistrin e letrave me vlerë, Regjistruesi nuk guxon që në lidhje me letrat e sekuestruara me vlerë të bëjë në të kurrfarë regjistrimi në bazë të tjetërsimit të tyre nga ana e debitorit.
6. Regjistruesi ka për detyrë që pa vonesë, ta njoftojë organin përmbarues për cilindo ndryshim lidhur me letrat e sekuestruara me vlerë, posaçërisht për përmbarimin e detyrueshëm me qëllim të përmbushjes së ndonjë kredie tjetër, apo për sigurimin e kredisë së tillë.
7. Debitorit nuk i lejohet disponimi me letrat e sekuestruara me vlerë pas momentit të marrjes së aktvendimit apo urdhrin për përmbarim me vërejtjen për ndalimin e tillë dhe për pasojat juridike ndëshkuese. Në rast të mosrespektimit të vërejtjes së tillë do të shënohet në aktvendimin për përmbarimin ose urdhrin për përmbarim.

#### **Neni 171**

#### **Vlerësimi dhe shitja e letrave të sekuestruara me vlerë**

1. Letrat me vlerë të cilat sipas ligjit dhe akteve tjera juridike për letrat me vlerë duhet të vihen në qarkullim në bursë e aksioneve, apo në ndonjë treg publik tjetër, shiten ashtu siç është paraparë me Ligjin për letrat me vlerë, me ndërmjetësimin tregtar të një ndërmjetësi që e zgjedhë organi përmbarues pasi të bëhet i përmbarueshëm aktvendimi për përmbarimin ose urdhri për përmbarim.
2. Letrat me vlerë të cilat sipas ligjit dhe akteve tjera juridike për letrat me vlerë nuk mund të vihen në qarkullim në bursë apo në tregun tjetër publik, shiten në ankand publik apo me anë ujdisë së drejtpërdrejt. Me anë të ujdisë së drejtpërdrejt letrat me vlerë i shet organi përmbarues ose personi i autorizuar për shitjen e letrave me vlerë të cilit Gjykata ia ka besuar shitjen.
3. Organi përmbarues apo personi i autorizuar për shitjen e letrave me vlerë, lidhin kontratën për shitjen e letrave me vlerë në emër të debitorit në mbështetje të konkluzionit të organit përmbarues i cili i autorizon për një gjë të tillë.
4. Nëse letrat me vlerë shiten përmes bursës apo tregut tjetër publik për letrat me vlerë, atëherë letrat me vlerë shiten në mesataren e çmimeve të tregut në hapje dhe në mbyllje për ato letra me vlerë në ditën e shitjes në bursë apo treg në të cilën ato zakonisht shiten.
5. Po qe se letrat me vlerë shiten në ankand publik, apo me anë të ujdisë së drejtpërdrejt, atëherë vlerësimi, caktimi i çmimit të shitjes dhe shitja e letrave me vlerë, bëhet duke u zbatuar në mënyrë të përshtatshme dispozitat e Kreut 1 Pjesa 2, të këtij ligji për përmbarimin në sendet e luajtshme të debitorit. Vlerësimi i aksioneve që kërkohet nga Kreu 1 Pjesa 2 e këtij ligji bëhet nga një ekspert me njohuri në vlerësim të afarizmit. Eksperti emërohet nga organi përmbarues me miratim nga të dyja palët.
6. Në qoftë se letrat me vlerë nga paragrafi 1. i këtij neni nuk shiten brenda afatit tre (3) mujor nga dita e ofertës së parë për shitje në bursë, apo në rast të tentimit të pasuksesshëm për shitje nga paragrafi 2. i këtij neni, atëherë propozuesi i përmbarimit mund ta kërkojë përmbarimin me anë të kalimit të letrave me vlerë në pronësi të tij, në vend të pagesës.
7. Aktvendimi apo urdhër për kalimin e letrave me vlerë në pronësi të propozuesit të përmbarimit i bashkëngjitet regjistrin të letrave me vlerë.

8. Organi përmbarues ka për detyrë që ta njoftojë propozuesin e përmbarimit për të drejtën që ta propozoj kalimin e letrave me vlerë në pronësi të tij, po që se ato nuk shiten brenda afatit të paraparë në paragrafin 6. të këtij neni. Me atë rast organi përmbarues e thërret propozuesin e përmbarimit që brenda afatit të cilin ia cakton ta paraqesë kërkesën për kalimin e letrave me vlerë në pronësi të tij në çmimin e dhënë për to nga eksperti.

9. Në qoftë se propozuesi i përmbarimit nuk e paraqet kërkesën nga paragrafi 7. i këtij neni, organi përmbarues e pezullon procedurën e përmbarimit, nën nenin 102 të këtij ligji.

#### **Neni 172**

#### **Përmbushja e kredisë së propozuesit të përmbarimit**

1. Përmbushja e kredive në procedurën e sekuestrimit dhe shitjes së letrave me vlerë të debitorit bëhet me anë të zbatimit të përshtatshëm të dispozitave të Kreut 1 Pjesa 2 të këtij ligji, të parapara për përmbarimin për sendet e luajtshme të debitorit.

2. Në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat e Kreut 1, Pjesa 2 e këtij ligji, të parapara për përmbarimin për sendet e luajtshme edhe kur vendoset kalimi i letrave me vlerë të debitorit, që nuk kanë mundur të shiten në pronësi të propozuesit të përmbarimit.

#### **Neni 173**

#### **Përmbarimi për pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare**

1. Sekuestrimi i pjesës së pasurisë në shoqërinë tregtare pronë e debitorit, bëhet me anë të dorëzimit të aktvendimit apo urdhrit për përmbarimin në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (Regjistrin e pengjeve) dhe në organin kompetent tjetër regjistruar si dhe shoqërive përkatëse tregtare, me qëllim të shënimit të së drejtës së pengut.

2. Aktvendimi apo urdhri përmbarues për kryerjen e përmbarimit kundër pronësisë së pjesës në shoqërisë tregtare i dërgohet kreditorit dhe debitorit.

3. Debitori nuk ka të drejtë të disponoj me pjesën e sekuestruar të pasurisë së tij në shoqërinë tregtare.

4. Vlerësimi dhe shitja e pjesës së pasurisë në shoqërinë tregtare bëhet duke u zbatuar në mënyrë të përshtatshme me dispozitat e këtij ligji që vlejnë për vlerësimin dhe shitjen e sendeve të debitorit, por më parë organi përmbarues duhet t'i njoftojë pjesëtarët e shoqërisë tregtare për caktimin e shitjes së pjesës së pasurisë, duke i thirrur njëherit që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e njoftimit, që të deklarohen për ekzistimin e interesit për blerjen e pjesës së pasurisë së debitorit.

### **KREU VII**

#### **PËRMBARIMI NË KREDINË PËR DORËZIMIN E SENDEVE**

#### **Neni 174**

#### **Kompetenca territoriale në rast të përmbarimit gjyqësor**

Për të vendosur për propozimin për përmbarimin për kredinë e debitorit që t'i dorëzohet sendi i caktuar i luajtshëm ose i paluajtshëm, apo sasia e caktuar e sendeve të luajtshme dhe për zbatimin e këtij përmbarimi, e kompetencës tokësore është Gjykata në territorin e së cilës ndodhen këto sende.

#### **Neni 175**

#### **Kompetenca në rast të përmbarimit nga përmbaruesi privat**

Për të vendosur për propozimin për përmbarimin për kredinë e debitorit që t'i dorëzohet sendi i caktuar i luajtshëm ose i paluajtshëm, apo sasia e caktuar e sendeve të luajtshme dhe për zbatimin e këtij përmbarimi, përmbaruesi privat ka kompetencë për të vendosur mbi propozimin përmbarimor dhe të zbatojë përmbarimin.

#### **Neni 176**

#### **Aplikimi i dispozitave për përmbarrimin për kredinë në të holla**

Dispozitat e këtij ligji për përmbarrimin për kredinë në të holla zbatohen përshtatshmërisht edhe në rastin e përmbarrimit për kredinë që të dorëzohen sendet e luajtshme ose paluajtshme, po që se me dispozitat e këtij kreu nuk është caktuar ndryshe.

#### **Neni 177**

#### **Mënyra e zbatimit të përmbarrimit**

1. Përmbarrimi në kredinë e debitorit për dorëzimin e sendeve, zbatohet me sekuestrimin e kësaj kredie, me kalimin e saj në kreditorin e përmbarrimit dhe me shitjen e sendeve të tilla.

2. Nëse kërkohen sendet e luajtshme dhe ato nuk gjenden në posedim të debitorit apo të personit të tretë, kreditori në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas ditës së tentimit të parë të sekuestrimit, në atë rast zgjedh nëse dëshiron të kërkojë tentimin e dytë për të gjetur sendet në fjalë, apo në vend të tyre të pranojë kompensim monetar në shumën e vlerës së sendeve në fjalë. Nëse kreditori përmbarrues zgjedh kompensimin monetar, organi përmbarrues cakton një ekspert i cili do të përcaktojë vlerën e sendeve në fjalë.

3. Nëse njëra palë nuk është e kënaqur me vlerësimin, ajo palë mundet brenda tri (3) ditëve nga data e pranimit të vlerësimit të parë, me shpenzime të veta, të kërkojë nga organi përmbarrues, një vlerësim nga një ekspert tjetër.

#### **Neni 178**

#### **Efekti i kalimit**

Kalimi i kredisë së sekuestruar të debitorit për dorëzimin e sendeve ka efekt juridik të kalimit të kredisë në të holla të debitorit për arsye të arkëtimit.

#### **Neni 179**

#### **Pa arritshmeria e kredisë**

Në qoftë se kredia e debitorit ende nuk është bërë e arritshme, atëherë organi përmbarrues do të urdhërojë debitorin që sendet t'i dorëzojë pasi të bëhet e arritshme kredia.

#### **Neni 180**

#### **Padia kundër debitorit të debitorit**

Kundër debitorit të debitorit i cili nuk tregohet i gatshëm që sendet të ia dorëzojë kreditorit, atëherë ky i fundit ka të drejtë që pasi të bëhet i formës së prerë aktvendimi apo urdhri për kalimin e kredisë, me padi ta kërkojë dorëzimin e sendeve, po që se për detyrimin e dorëzimit nuk ka dokument përmbarrimorë.

#### **Neni 181**

#### **Dorëzimi i sendeve të luajtshme për ruajtje**

Me aktvendimin me të cilin caktohet kalimi i kredisë së debitorit, organi përmbarrues do ta urdhërojë debitorin e debitorit me kërkesën e kreditorit, që sendet e luajtshme me të cilat ka të bëjë kredia t'i ruajë vetë po që se dëshiron, respektivisht t'ia dorëzojë ato personit zyrtar ose personit tjetër për ruajtje.

#### **Neni 182**

#### **Zbatimi i dispozitave për ruajtjen e sendeve të inventarizuara**

Për ruajtjen e sendeve të luajtshme nga neni 181 i këtij ligji, në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat e nenit 90 të këtij ligji, të parapara për ruajtjen e sendeve të luajtshme të debitorit të inventarizuara.

**Neni 183**  
**Shitja e sendeve dhe realizimi i kredisë së kreditorit**

Shitja e sendeve të luajtshme që i janë dorëzuar organit përmbaues, ose personit tjetër nga neni 182 i këtij ligji, si dhe realizimi i kredisë së kreditorit, bëhet sipas dispozitave të parapara në Kreun 1, Pjesa 2 e këtij ligji.

**Neni 184**  
**Dorëzimi i sendit të paluajtshëm kreditorit**

1. Me aktvendimin apo urdhrin me të cilin caktohet kalimi i kredisë së debitorit, organi përmbaues e urdhëron debitorin e debitorit që paluajtshmërinë me të cilën ka të bëjë kredia e këtillë, t'i dorëzojë kreditorit.

2. Kreditori ka për detyrë që me paluajtshmërinë të administrojë në emër dhe për llogari të debitorit si ekonomist i mirë, respektivisht si nikoqir i mirë dhe që organi përmbaues me kërkesën e saj, t'i japë llogari për administrimin.

**Neni 185**  
**Shitja e paluajtshmërisë**

1. Kreditori ka të drejtë që me qëllim të realizimit të kredisë së tij, brenda afatit që nuk mund të jetë më i gjatë se tridhjetë (30) ditë nga dita në të cilën i është dorëzuar paluajtshmëria, t'i propozojë organit përmbaues shitjen e kësaj paluajtshmërie.

2. Në qoftë se kreditori nuk e kërkon shitjen e paluajtshmërisë brenda afatit të paraparë në paragrafin 1. të këtij neni, organi përmbaues do ta pezulloj përbarimin dhe do t'i anulojë të gjitha veprimet përbarimore të kryera.

**Neni 186**  
**Aplikimi i dispozitave për përbarimin për paluajtshmëritë**

Shitja e sendit të paluajtshëm dhe realizimi i kredisë së kreditorit të përbarimit bëhet sipas dispozitave të këtij ligji, të parapara për përbarimin për paluajtshmëritë.

**KREU VIII**  
**PËRMBARIMI PËR TË DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE DHE TË DREJTAT TJERA PRONËSORE**

**Neni 187**  
**Kompetenca territoriale**

1. Për të vendosur për propozimin për përbarim për të drejtën e autorit dhe të drejtat tjera pronësore patentat, perfeksionimin, ose përbarimin teknik, uzufuktin, ose për ndonjë të drejtë tjetër të ngjashme pasurore të debitorit dhe për zbatimin e këtij përbarimi, e kompetencës tokësore është Gjykata në territorin e së cilës ndodhet vendbanimi i debitorit të përbarimit, e nëse debitori i përbarimit nuk ka vendbanim në Kosovë, është kompetente Gjykata në territorin e së cilës ndodhet vendqëndrimi i tij.

2. Dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni, që kanë të bëjnë me vendbanimin dhe vendqëndrimin, në mënyrë të përshtatshme zbatohen edhe lidhur me selinë e personit juridik.

**Neni 188**

## **Kompetenca në rast të përmbarimit nga përmbaruesi privat**

Për të vendosur për propozimin për përmbarim për të drejtën e patentat, perfeksionimin, ose përmbarimin teknik, uzufuktin, ose për ndonjë të drejtë tjetër të ngjashme pasurore të debitorit dhe për zbatimin e këtij përmbarimi, përmbaruesi privat ka kompetencë për të vendosur mbi propozimin përmbarimor dhe për të zbatuar përmbarimin.

### **Neni 189**

#### **Mënyra e zbatimit të përmbarimit**

Përmbarimi për të drejtat pasurore nga neni 187 i këtij ligji zbatohet me anë të sekuestrimit të tyre, si dhe me shndërrimin e tyre në para, konform dispozitave nga Kreu 1, Pjesa 2, e këtij ligji.

## **KREU IX**

### **PËRMBARIMI PËR SENDET E PALUAJTSHME**

#### **Neni 190**

##### **Kompetenca territorial në rast të përmbarimit gjyqësor**

Për të vendosur për propozimin për përmbarimin për sendin e paluajtshëm dhe për zbatimin e aktvendimit për përmbarimin, e kompetencës tokësore është Gjykata në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria.

#### **Neni 191**

##### **Kompetenca në rast të përmbarimit nga përmbaruesi privat**

Për të vendosur për propozimin për përmbarimin për sendet e paluajtshme dhe për zbatimin e aktvendimit për përmbarimin, përmbaruesi privat ka kompetencë për të vendosur mbi propozimin përmbarimor dhe të zbatojë përmbarimin.

#### **Neni 192**

##### **Veprimet ekzekutive**

Përmbarimi për paluajtshmërinë zbatohet me shënimin e përmbarimit në librin publik të paluajtshmërive, me përcaktimin e vlerës së paluajtshmërisë, me shitjen e paluajtshmërisë dhe me pagimin e kreditorit të përmbarimit nga shuma e të hollave e fituar nga shitja.

#### **Neni 193**

##### **Paluajtshmëria si objekt i përmbarimit**

1. Po qe se me dispozita ligjore nuk është paraparë ndryshe, objekt përmbarimi mund të bëhet vetëm paluajtshmëria si tërësi e caktuar me anë të dispozitave të cilat e rregullojnë pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore, si dhe librat publik të paluajtshmërive.

2. Pjesa në bashkëpronësi e paluajtshmërisë mund të bëhet objekt i posaçëm i përmbarimit (pjesa ideale e bashkëpronësisë në paluajtshmërinë) lidhur me të cilën në mënyrë të përshtatshme aplikohen rregullat e këtij ligji për përmbarimin për sendet e paluajtshme.

#### **Neni 194**

##### **Paluajtshmëria në bashkëpronësi të debitorit**

1. Në rast të procedurës përmbarimore për pjesën e bashkëpronësisë, e me kërkesë të kreditorit, debitorit apo të bashkëpronarit tjetër, organi përmbarues në aktvendimin për përmbarimin ose urdhërit për përmbarim do të caktojë që për shitje të ofrohet sikurse sendi i paluajtshëm në tërësi, ashtu edhe pjesa e bashkëpronësisë që është objekt përmbarimi.

2. Në aktvendimin për përmbarimin ose urdhrin për përmbarim, organi përmbarues duhet të theksojë se do të vendosë varësisht nga përmbushja e kushteve nga paragrafi 3. i këtij neni, me anë të konkluzionit se a do të shitet e gjithë paluajtshmëria, apo vetëm pjesa në bashkëpronësi e tij.

3. Po qe se çmimi i shitjes së pjesës në bashkëpronësi të paluajtshmërisë, do të ishte dukshëm më i lartë në rast të shitjes së gjithë sendit të paluajtshëm, atëherë organ i përmbarues do ta caktojë shitjen e gjithë sendit të paluajtshëm, duke vepruar sikur të ishte fjala për kërkesën e bashkëpronarit për ndarjen e sendit të pandashëm fizikisht, ashtu siç është paraparë me rregullat me të cilat janë të rregulluara marrëdhëniet bashkëpronësore. Në aktvendimin për përmbarimin ose urdhrin për përmbarim, organi përmbarues do të theksojë se shënimi i përmbarimit i përket paluajtshmërisë si tërësi.

4. Në rastin nga paragrafi 3. i këtij neni, bashkëpronari që nuk është debitor i përmbarimit ka të drejtë që t'i paguhet vlera e pjesës së tij nga shuma e të hollave të fituara me shitjen e paluajtshmërisë para se t'i përmbushet kredia kreditorit të përmbarimit dhe personave të tjerë të cilët realizojnë kërkesa në procedurën e përmbarimit, si dhe para se të paguhen shpenzimet e procedurës përmbarimore.

5. Bashkëpronarët që nuk janë debitor në procedurën e përmbarimit kanë të drejtë që të kërkojnë që paluajtshmëria që është objekt përmbarimi t'u jepet atyre po qe se e depozitojnë shumën e cila i përgjigjet vlerës së pjesës së debitorit në paluajtshmërinë e tillë.

#### **Neni 195**

#### **Udhëzimi për fillim të procedurës kontestimore**

1. Bashkëpronarin që nuk është debitor të cilit i është kontestuar pjesa në paluajtshmërinë që është bërë objekt përmbarimi, organi përmbarues e udhëzon që të paraqet padi kundër kreditorëve, por edhe kundër debitorit, po qe se edhe ky ia konteston të drejtën e tij me qëllim që në procesin kontestimor ta provojë të drejtën e pretenduar. Nuk bëhet udhëzimi për ngritje të padisë, po qe se bashkëpronari i tillë ka mundësi që në vetë procedurën përmbarimore ta provojë ekzistimin e së drejtës së tij me anë të aktgjykimit të formës së prerë, dokumentit publik, ose dokumentit jopublik, të vërtetuar sipas ligjit.

2. Për procesin kontestimor të filluar me padi, si dhe për të drejtën e bashkëpronarit që në të ta kërkojnë shtyrjen e procedurës së përmbarimit të filluar, në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat e këtij ligji me të cilat rregullohet veprimi i Gjykatës sipas prapësimit të personit të tretë.

#### **Neni 196**

#### **Pronarët e pasurisë së përbashkët**

1. Dispozitat e neneve 194 dhe 195 të këtij ligji në mënyrë të përshtatur zbatohen edhe për pronarët (bashkëpjesëtarët) e pasurisë së përbashkët. Në qoftë se midis debitorit dhe pronarëve të tjerë të pasurisë së përbashkët ka mosmarrëveshje lidhur me të drejtat e tyre në paluajtshmërinë e përbashkët, atëherë organi përmbarues pronarin e pasurisë së përbashkët i cili i konteston të drejtat e debitorit për paluajtshmërinë e përbashkët, e udhëzon që të drejtat e veta t'i vërtetoj në procedurë kontestimore.

2. Në procesin kontestimor të filluar me padi, si dhe lidhur me të drejtat e pronarëve që në të ta kërkojnë shtyrjen e procedurës së përmbarimit, në mënyrë të përshtatur zbatohen dispozitat e këtij ligji, me të cilat është rregulluar veprimi i Gjykatës sipas prapësimit të personit të tretë.

#### **Neni 197**

#### **Veprimi në rast të ekzistimit të uzufuktit**

Në qoftë se për sendin e paluajtshëm, ose në pjesën ideale të tij ekziston e drejta e uzufuktit, atëherë e drejta e uzufuktit mund të bëhet objekt i përmbarimit të pavarur dhe debitori mund ta realizojë kërkesën e tij nga të ardhurat që i jep e drejta e tillë në bazë të ndonjë raporti juridik dhe lidhur me këtë zbatohen në mënyrë të përshtatur dispozitat e këtij ligji për përmbarimin për të drejtat (si objekt përmbarimi).

#### **Neni 198**

#### **Prova për pronësinë e debitorit**



1. Bashkë me propozimin për përmbarrimin për sendin e paluajtshëm, nevojitet që kreditori të paraqesë ekstraktin nga libri publik i paluajtshmërive, si provë se paluajtshmëria është regjistruar si pronësi e debitorit.

2. Në qoftë se e drejta në paluajtshmërinë nga paragrafi 1. i këtij neni, është regjistruar në librin publik të paluajtshmërive në personin tjetër e jo në debitorin, atëherë mund të miratohet propozimi për përmbarrim, vetëm pasi të jetë konstatuar pronësia e debitorit sipas dispozitave të nenit 45 dhe 46 të këtij ligji dhe të jenë plotësuar kushtet për ndryshimin e gjendjes në librin publik të paluajtshmërive.

3. Në qoftë se sendi i paluajtshëm nuk është i regjistruar në librin publik të paluajtshmërive, atëherë në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat e këtij ligji që vlejné për territoret ku nuk ekzistojné librat e tilla.

#### **Neni 199** **Ndryshimi i objektit të përmbarrimit**

1. Debitori ka të drejtë që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar aktvendimi për përmbarrimin ose urdhri për përmbarrim, t'i propozojë organi autoritetit përmbarrues caktimin e përmbarrimit në ndonjë objekt tjetër përmbarrimi. Nëse debitori propozon një objekt tjetër, propozimit të këtillë debitori ka për detyrë t'ia bashkangjesë provën e duhur nga e cila shihet se atij i takon e drejta e pretenduar për paluajtshmërinë tjetër, në bazë të cilës provë mund të caktohet përmbarrimi për paluajtshmërinë e këtillë kundër debitorit.

2. Organi përmbarrues do t'ia dërgojë propozimin e debitorit, kreditorit i cili mund të deklarohet rreth tij brenda shtatë (7) ditësh nga dita e dorëzimit.

3. Brenda afatit nga paragrafi 2. i këtij neni, kreditori ka të drejtë që të paraqesë kërkesë për pagimin e shpenzimeve të procedurës së filluar në paluajtshmërinë, si dhe të kërkojë depozitim të garancionit për shpërbllimin e dëmit që mund ta pësojë nga shkaku i ndryshimit të objektit të përmbarrimit.

4. Për propozimin e debitorit organi përmbarrues vendosë me anë të aktvendimit apo urdhrin, pasi t'i arrijë deklarimi i kreditorit të përmbarrimit, respektivisht pasi të skadojë afati i caktuar nga paragrafi 2. i këtij neni, për paraqitjen e deklarimit.

#### **Neni 200** **Miratimi i propozimit për ndryshimin e objektit**

1. Organ i përmbarrues mund ta miratoj propozimin e debitorit për ndryshimin e objektit të ekzekutimit në qoftë se bën të besueshëm se:

1.1. përmbarrimi në sendin e paluajtshëm të propozuar nga kreditori, për të do të jetë shumë i pavolitshëm, ose

1.2. për shkaqe të arsyeshme nuk ka mundur personalisht ta shëndrrojë në të holla paluajtshmërinë të cilën e propozon si objekt të ri përmbarrimi (dhe ta përmbushë kredinë e kreditorit, ose

1.3. kredia e kreditorit mund të paguhet plotësisht nga objekti i ri propozuar;

1.4. organi përmbarrues me vendimin e vet do të refuzoj propozimin për ndërrimin e objektit përmbarrues, nëse vlerësohet se për këtë gjë përmbarrimi do të shtyhet ose vështirësohet dukshëm, respektivisht nëse kreditori me ndërrimin e objektit të përmbarrimit do të pësoj dëme të dukshme.

2. Në qoftë se kreditori në paluajtshmërinë për të cilën e ka kërkuar përmbarrimin, e ka fituar para se ta ketë filluar procedurën për përmbarrim të drejtën e pengut për sigurimin e kredisë së vet, atëherë pa pëlqimin e tij, përmbarrimi nuk mund të caktohet në ndonjë objekt tjetër përmbarrimi.

3. Në aktvendimin për ndryshimin e objektit të përmbarrimit, organi përmbarrues e cakton përmbarrimin në objektin tjetër të propozuar për përmbarrim

**Neni 201**  
**Ndryshimi i mjetit përbarues**

1. Në qoftë se debitori si mjet tjetër përbarimi e ka propozuar përbarimin mbi pagën, pensionin, pensionin invalidor, apo për ndonjë burim tjetër të të ardhurave të përhershme, organi përbarues mund ta aprovojë propozimin, me kusht që debitori ta bëjë të besueshëm faktin se kredia do të realizohet brenda afatit një (1) vjeçar, nga dita e nxjerrjes së aktvendimit për propozimin e tij.

2. Dispozitat e paragrafit 2. dhe 4. të nenit 199 të këtij ligji aplikohen përshtatshëm për zbatimin e këtij neni.

**Neni 202**  
**Aktvendimi për propozimin për ndryshimin e objektit**

Kundër aktvendimit me të cilin refuzohet propozimi i debitorit për ndryshimin e objektit të përbarimit nuk lejohet asnjë mjet goditës juridik .

**Neni 203**  
**Efekti i shënimit në rast ndryshimi të objektit të përbarimit**

Në qoftë se me vendim të organit përbarues është caktuar mjeti tjetër përbarimor, respektivisht objekti tjetër përbarimorë, atëherë shënimi i përbarimit për paluajtshmërinë si objekt i parë, përbarimi mbetet në fuqi deri në realizimin e kredisë së kreditorit të ekzekutimit. Pasi të realizohet kredia e kreditorit, organi përbarues sipas detyrës zyrtare e urdhëron shlyerjen e shënimit të përbarimit.

**Neni 204**  
**Shënimi i përbarimit**

1. Pas dhënies së aktvendimit për përbarimin ose urdhrin për përbarim, organi përbarues sipas detyrës zyrtare e urdhëron shënimin e përbarimit në librin publik të paluajtshmërive.

2. Me shënimin nga paragrafi 1. të këtij neni, kreditori e fiton të drejtën që kredinë e tij ta realizojë nga paluajtshmëria (e drejta për realizim), kurse personi i cili pasi të jetë bërë shënimi i përbarimit, e fiton ndonjë të drejtë për paluajtshmërinë e kështu, ka për detyrë t'ia njohë kreditorit, të drejtën e realizimit me prioritet të kredisë së tij të arritur me anë të shënimit.

**Neni 205**  
**Ndryshimi i pronarit të paluajtshmërisë**

1. Ndryshimi i pronarit të sendit të paluajtshëm gjatë zhvillimit të procedurës përbarimore, nuk e pengon vazhdimin e saj kundër pronarit të ri si debitor. Të gjitha veprimet përbarimore të kryera më parë mbeten të vlefshme dhe pronari i ri nuk mundet gjatë zhvillimit të mëtejshëm të përbarimit, t'i kryejë veprimet të cilat nuk do të mund t'i kryente pronari i mëparshëm.

2. Me propozimin e kreditorit organi përbarues e nxjerrë aktvendimin apo urdhrin për vazhdimin e procedurës së përbarimit, kundër pronarit të ri si debitor në atë procedurë. Kundër aktvendimit apo urdhrin të tillë pronari i ri nuk ka të drejtë ankimi.

3. Kreditori i cili nuk e ka fituar të drejtën e pengut para se të jetë filluar përbarimi, në momentin e shënimit të përbarimit në librin publik të paluajtshmërive, e fiton të drejtën që nga paluajtshmëria ta realizojë kredinë para personit që në paluajtshmërinë e tillë e ka fituar më vonë të drejtën e pengut, apo të drejtën e realizimit të kredisë së vet.

4. Pasi të jetë bërë shënimi i përbarimit në librin publik të paluajtshmërive, nuk lejohet regjistrimi i ndryshimit të së drejtës së pronësisë të mbështetur në disponimin e debitorit, pa marrë parasysh se kur është bërë ky disponim.

#### **Neni 206**

##### **Publikimi i aktvendimit për përbarimin**

1. Në territoret në të cilat nuk ekzistojnë librat publik të paluajtshmërive, ose kur ato janë asgjësuar apo zhdukur, organi përbarues me propozimin dhe shpenzimet e kreditorit do ta publikojë aktvendimin apo urdhrin për përbarimin në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe së paku në një gazetë të përditshme që shpërndahet në gjithë territorin e Kosovës.

2. Në rastin e publikimit të aktvendimit apo urdhrin për përbarimin në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, shënimi i përbarimit pas evidentimit të saj në librin publik të paluajtshmërive, prodhon efekte juridike që nga momenti kur aktvendimi për përbarimin ose urdhrin për përbarim është publikuar për herë të parë në mjetet e informimit.

#### **Neni 207**

##### **Fillimi i zbatimit të përbarimit**

1. Pas regjistrimit të shënimit të përbarimit në librin publik të paluajtshmërive, për realizimin e kredisë tjetër të njëjtit kreditor, apo të kreditorit tjetër, nuk mund të zbatohet procedurë tjetër e posaçme për të njëjtën paluajtshmëri e cila është bërë objekt përbarimi.

2. Propozuesi i përbarimit për kredinë e të cilit më vonë është caktuar përbarimi për të njëjtën paluajtshmëri hyn në procedurën e përbarimit tanimë të filluar.

3. Në procedurën e përbarimit që ka filluar mund të hyjë propozuesi tjetër i përbarimit deri në momentin kur organi përbarues e nxjerrë konkluzionin, me të cilin caktohet blerësi i paluajtshmërisë në ankandin publik.

4. Për hyrjen në procedurën e përbarimit të filluar të kreditorit tjetër, organi përbarues do ta njoftojë kreditorin në dobi të cilit është bërë më parë shënimi i përbarimit.

#### **Neni 208**

##### **Efekti i moslejimit apo i shtyrjes së përbarimit për disa nga kreditorët**

1. Shkaqet për të cilat përbarimi nuk është lejuar në dobi të disave nga shumë propozues të përbarimit për të njëjtën paluajtshmëri, respektivisht shkaqet për pezullimin e përbarimit në relacion me ndonjërin nga propozuesit e përbarimit, janë pa ndikim në zhvillimin e procedurës në dobi të propozuesve të tjerë të përbarimit.

2. Në qoftë se shkak për shtyrjen e përbarimit i përket vetëm ndonjërit nga propozuesit e përbarimit, përbarimi nuk do të shtyhet, veçse organi përbarues me rastin e dhënies së aktvendimit apo urdhrin për përmbushjen e kredive do ta caktojë shtyrjen e realizimit të kredisë së tij derisa mos të vazhdohet procedura përbarimore për kredinë e tij. Të hollat e dedikuara për përmbushjen e kredisë së tij, do të depozitohen dhe ruhen te organi përbarues deri në vazhdimin e procedurës. Në qoftë se kjo procedurë nuk vazhdohet, mjetet e përmendura do të përdoren për përmbushjen e kredive të propozuesve të tjerë të përbarimit, ose do t'i dorëzohen debitorit.

#### **Neni 209**

##### **Realizimi i kërkesave të siguruara me peng**

Në procedurën e përbarimit në paluajtshmërinë, i realizojnë kërkesat e tyre edhe kreditorët që i kanë siguruar kreditë e tyre me peng, edhe pse nuk e kanë filluar procedurën përbarimore në përputhje me rregullat që e caktojnë radhën e realizimit të kërkesave të tyre. Kërkesat e kreditorit të siguruar kanë përparësi ndaj kërkesave nga propozuesi i përbarimit.

**Neni 210**  
**Shuarja e të drejtës së pengut**

1. E drejta e pengut për sendin e paluajtshëm e regjistruar në librin publik të paluajtshmërive, shuhet në ditën kur zbatohet aktvendimi apo urdhri për shitjen e sendit të paluajtshëm, megjithëse ndoshta kreditorët e siguruar me peng nuk i kanë realizuar kreditë e tyre plotësisht, përveç kur ekziston marrëveshja nga paragrafi 2. të këtij neni.

2. Blerësi i sendit të paluajtshëm dhe kreditori i siguruar me peng mund të merren vesh më së voni në seancën për shitjen e tij, që e drejta e pengut për paluajtshëmërinë të mbetet edhe pas zbatimit të aktvendimit apo urdhrimit për shitjen, kurse blerësi ta marrë për vete borxhin e debitorit ndaj këtij kreditori në shumën që do t'i takonte në procedurën e përmbarimit. Në këtë rast çmimi i blerjes së sendit të paluajtshëm pakësohet për shumën e borxhit të marrë përsipër.

3. Blerësi dhe kreditori i siguruar me peng, marrëveshjen nga paragrafi 2. të këtij neni e lidhin në formë të marrëveshjes të organit përmbarues në procedurën përmbarimore ose të dokumentit noterial.

**Neni 211**  
**Servitutet dhe barrët sendore**

1. Servitutet sendore, barrët sendore dhe të drejtat e ndërtimit në sendin e paluajtshëm nuk shuhen me shitjen e paluajtshmërisë.

2. Me shitjen e sendit të paluajtshëm nuk shuhen as servitutet personale që janë regjistruar në librin publik të paluajtshmërive, para së drejtës për realizimin e së cilës është duke u zhvilluar procedura përmbarimore.

3. Servitutet tjera personale shuhen me zbatimin e aktvendimit apo urdhrimit për shitjen e sendit të paluajtshëm.

4. Lidhur me servitutet personale nga paragrafi 3. të këtij neni, në mënyrë të përshtatur zbatohen dispozitat e paragrafit 2. dhe 3. të nenit 210 të këtij ligji.

**Neni 212**  
**Kontrata e qirasë për sendet e paluajtshme**

1. Kontrata e qirasë për sendet e paluajtshme që janë lidhur dhe regjistruar në librin publik të paluajtshmërive para fitimit të së drejtës së pengut apo të drejtës së përmbushjes për realizimin e të cilës propozohet përmbarimi, nuk shuhet me faktin e shitjes së paluajtshmërisë.

2. Kontratat e qirasë që nuk janë regjistruar në librin publik të paluajtshmërive para fitimit të së drejtës së pengut apo të drejtës së përmbushjes për realizimin e të cilës propozohet përmbarimi, shuhet në momentin kur bëhet i formës së prerë aktvendimi apo urdhri për shitjen e paluajtshmërisë, po qe se midis blerësit dhe qiramarrësit nuk është kontraktuar ndonjë gjë tjetër. Blerësi trashëgon të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit.

3. Qiradhënësi i mëparshëm përgjigjet për gjithë dëmin që e ka pësuar qiramarrësi me shuarjen e kontratave nga paragrafi 2. i këtij neni. Qiramarrësi nuk ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit në procedurën e përmbarimit.

**Neni 213**  
**E drejta e banimit**

1. E drejta e banimit e fituar para fitimit të së drejtës së pengut, apo të drejtës së përmbushjes për realizimin e të cilës propozohet përmbarimi, nuk shuhet me shitjen e paluajtshmërisë. Blerësi i paluajtshmërisë hyn në vendin e dhënësit të banesës nga momenti kur e fiton të drejtën e pronësisë për paluajtshëmërinë.

2. Aktvendimi apo urdhri i formës së prerë me të cilin është konstatuar shitja e paluajtshmërisë, përbënë dokument përbarimorë për shpërngulje.

3. Pamundësia e shpërnguljes së qiramarrësit në mbështetje të dokumentit ekzekutiv nga paragrafi 2. i këtij neni, nuk e pengon blerësin që të drejtat e veta kundër tij t'i realizojë në procedurë kontestimore.

#### **Neni 214** **Këqyrja e sendit të paluajtshëm**

1. Organi përbarues do t'i japë personit të interesuar për blerjen e paluajtshmërisë me konkluzion të posaçëm lejen e këqyrjes së paluajtshmërisë. Lejen e kështu organi përbarues e jep vetëm kur personi i interesuar për blerjen e paluajtshmërisë e kërkon atë. Me konkluzion caktohet koha dhe mënyra e këqyrjes së paluajtshmërisë.

2. Në qoftë se debitori ose personi tjetër e pamundëson apo pengon këqyrjen e paluajtshmërisë, organi përbarues me anë të konkluzionit urdhëron që debitori, ose personi i tillë të largohet nga paluajtshmëria në kohën e këqyrjes së paluajtshmërisë. Konkluzionin për largimin e zbaton organi përbarues, po që së është nevoja me ndihmën e policisë.

3. Personit nga paragrafi 2. i këtij neni, organi përbarues mund t'i shqiptojë gjobat dhe masat e parapara në nenin 15 dhe 16 të këtij ligji.

#### **Neni 215** **Sigurimi i paluajtshmërisë**

1. Me qëllim të pengimit të dëmtimit të paluajtshmërisë, mundësimin të vlerësimit të saj, këqyrjes dhe mbrojtjes, organi përbarues me konkluzion, me kërkesën e propozuesit të përbarimit në dobi të të cilit është caktuar përbarimi, mund ta urdhërojë :

1.1 largimin e përkohshëm nga paluajtshmëria të debitorit dhe personave të tjerë;

1.2 lënien për ruajtje të paluajtshmërisë kreditorit ose personit të tretë;

1.3 caktimin e masave të tjera të nevojshme për mbrojtjen e paluajtshmërisë, respektivisht për zbatimin pa pengesa të përbarimit;

2. Kundër personave që e pamundësojnë ose pengojnë zbatimin pa pengesa të përbarimit, Gjykata mund të shqiptoj gjobat dhe masat e parashikuara me nenin 15 dhe 16 të këtij ligji.

3. Mjetet e nevojshme për zbatimin e gjobave dhe masave nga paragrafi 2. i këtij neni, që më parë duhet t'i depozitoj kreditori.

#### **Neni 216** **Paluajtshmëritë që nuk mund të bëhen objekt përbarimi**

1. Nuk mund të jetë objekt përbarimi toka bujqësore e bujkut në sipërfaqe prej gjysmë hektari.

2. Dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni, nuk kanë të bëjnë me përbarimin për realizimin e kredive të siguruara me të drejtën e pengut të kontraktuar për sendin e paluajtshëm (me hipotekë).

#### **Neni 217** **Mënyra e caktimit të vlerës**

1. Për mënyrën e caktimit të vlerës së paluajtshmërisë organi përbarues vendosë me konkluzion, menjëherë pasi ta nxjerrë aktvendimin për përbarimin ose urdhrin për përbarim. Nëse e do nevoja, para se të nxjerrë konkluzionin, organi përbarues do të mbajë seancë dëgjimore me palët.

2. Përcaktimi i vlerës së paluajtshmërisë bëhet pasi të bëhet i përbarueshëm aktvendimi për përbarimin ose urdhri për përbarim.

3. Përcaktimi i vlerës do të bëhet edhe para momentit të përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni, në qoftë se këtë e kërkon kreditori dhe i paguhen shpenzimet e përcaktimit të vlerës së paluajtshmërisë edhe për rastin nëse procedura përbarimore pezullohet.

4. Vlera e paluajtshmërisë përcaktohet në bazë të çmuarjes së ekspertit dhe të fakteve të tjera në lartësinë e çmimit të tij të tregut në ditën e çmuarjes.

5. Me rastin e përcaktimit të vlerës së paluajtshmërisë merret parasysht edhe fakti se sa vlen ajo më pak, për shkak se në të mbeten të drejtat e caktuara edhe pas shitjes.

#### **Neni 218**

#### **Caktimi i vlerës nga administrata tatimore**

Përveç mënyrës së vlerësimit të paluajtshmërisë në mënyrën e caktuar në nenin 217 të këtij ligji, organi përbarues mund të kërkojë nga organi kompetent i administratës tatimore të dhënat për vlerën e paluajtshmërisë.

#### **Neni 219**

#### **Përcaktimi i vlerës së pjesës në bashkëpronësi**

Në procedurën e përbarimit për pjesën në bashkëpronësi, vlerësimi do t'i përmbaj vlerat e konstatuara edhe për gjithë paluajtshmerinë, e edhe për pjesën në bashkëpronësi, si dhe vlerën e pjesës në bashkëpronësi që do të fitohet në rast të shitjes së gjithë paluajtshmërisë, në pajtim me paragrafin 2. të nenit 193 të këtij ligji.

#### **Neni 220**

#### **Përcaktimi i vlerës me anë të marrëveshje**

Dispozitat e nenit 217 dhe 218 të këtij ligji nuk aplikohen po qe se palët dhe personat e tjerë që në procedurën përbarimore i realizojnë të drejtat e tyre me anë të marrëveshjes e caktojnë vlerën e paluajtshmërisë.

#### **Neni 221**

#### **Kthimi për shkak të pamjaftueshmëris së mjeteve**

1. Çdo person që ka të drejtë të paguhet nga çmimi i shitjes së paluajtshmërisë, e që sipas radhës së përparësisë vjen përpara kreditorit, mund të propozojë pezullimin e përbarimit, në qoftë se vlera e përcaktuar e paluajtshmërisë nuk mund ta mbulojë shumën e kredisë së kreditorit të përbarimit.

2. Propozimi për pezullimin e përbarimit mund të paraqitet brenda shtatë (7) ditësh nga dita e dorëzimit të konkluzionit për shitjen.

3. Me propozim të titullarit të një të drejte dhe pas përmbushjes së kushteve nga paragrafi 1. i këtij neni, organi përbarues me aktvendim apo urdhër do ta pezullojë procedurën përbarimore.

#### **Neni 222**

#### **Konkluzioni për shitjen**

1. Pasi të kryhet procedura për përcaktimin e vlerës së paluajtshmërisë, organi përbarues jep konkluzionin për shitjen e paluajtshmërisë me të cilin cakton vlerën e paluajtshmërisë dhe mënyrën dhe kushtet e shitjes, si dhe kohën dhe vendin e shitjes, po qe se shitja bëhet me anë të ankandit publik.

2. Në procedurën e përbarimit për pjesën në bashkëpronësi nga neni 193 i këtij ligji, konkluzioni për shitjen do t'i përmbajë posaçërisht të dhënat edhe për gjithë paluajtshmerinë, e edhe për pjesën në bashkëpronësi që është objekt përbarimi, por edhe shënimin se organi përbarues për objektin definitiv të shitjes do të vendosë në pajtim me dispozitat për seancën e ankandit dhe shitjes së paluajtshmërisë.

#### **Neni 223**

#### **Publikimi i konkluzionit për shitjen**

1. Konkluzioni për shitjen e paluajtshmërisë shpallet në tabelën e organit përbarues, e me vendimin e organit përbarues edhe në mënyrë tjetër përkatëse.

2. Pala apo kushdo tjetër me interesa pronësore në atë pronë ka të drejtën që me shpenzimet e tij ta publikojë konkluzionin për shitjen në mjetet e informimit publik, dhe t'i njoftojë personat që merren me ndërmjetësimin në shitjen e sendeve të paluajtshme për atë konkluzion.

3. Prej shpalljes së konkluzionit për shitjen në tabelën e organit përbarues deri në ditën kur duhet të bëhet shitja e paluajtshmërisë duhet të kalojnë të paktën tridhjetë (30) ditë.

4. Konkluzioni për shitjen u dërgohet palëve, personave të cilët kanë të drejtën e realizimit me prioritet të kredive, apo të drejtën e realizimit të rangut të njëjtë me kreditorin, personave që kanë të drejtën e regjistruar, ose të drejtën ligjore të parablerjes dhe organit kompetent administrativ të tatimeve.

#### **Neni 224**

#### **E drejta përparësisë për blerje**

1. Personi që ka të drejtën e përparësisë për blerje të pronës së paluajtshme që është objekt i përbarimit me shitje, ka përparësi mbi ofertuesin më të mirë, nëse menjëherë pas përfundimit të ofertimit, ai jep deklaratën se ai person do të blejë pronën e paluajtshme me kushte të njëjta.

2. Nëse personi që është mbajtës i të drejtës së përparësisë për blerjen e pronës së paluajtshme nuk ka pranuar aktvendimin apo urdhrin për shitje, organi përbarues e njofton atë për çmimin e ofruar për blerje të pronës së paluajtshme, dhe personi që është mbajtës i të drejtës së përparësisë bën deklaratën e tij brenda tri (3) ditëve nga data e pranimit të njoftimit.

3. Nëse personi që mban të drejtën e përparësisë për blerje nuk e jep deklaratën brenda afatit të parashkruar në paragrafin 2. të këtij neni, ai humbë të drejtën e përparësisë për blerje. Në këtë rast ai paguan çmimin e blerjes brenda afatit të caktuar me aktvendimin apo urdhrin për shitje.

4. Personi që ka të drejtën kontraktuale të përparësisë ushtron të drejtën e tij në kuptim të paragrafit 1. të këtij neni ku nuk ka të drejta ligjore apo ku mbajtësi i titullit nuk e ka shfrytëzuar ato.

#### **Neni 225**

#### **Gjykimi i të drejtës së përparësisë së kreditorit për blerje**

1. Kur nuk ka pasur të drejtën ligjore apo kontraktuale të përparësisë për blerje, apo kur mbajtësi i kësaj të drejte nuk e ka shfrytëzuar atë të drejtë, e drejta e blerjes me përparësi i përket kreditorit.

2. Kreditori përvetëson të drejtën e përparësisë së blerjes kur e regjistron aktvendimin ose urdhrin për përbarim atë në regjistrin përkatës.

3. Nëse personi që ka përvetësuar të drejtën e përparësisë së blerjes së pronës së paluajtshme jep këtë deklaratë para kreditorit se nuk do e shfrytëzojnë këtë të drejtë, kreditori merr precedencë para ofertuesit të parë nëse menjëherë pas përmbylljes së shitjes ai jep deklaratën se ai blen pronën e paluajtshme me kushte të njëjta.

#### **Neni 226**

#### **Deklarata e mbajtësit të përparësisë për blerje**

Nëse prona e paluajtshme shitet me marrëveshje të drejtpërdrejtë, organi përbarues fton mbajtësin ligjor të së drejtës së përparësisë për blerje, mbajtësin e të drejtës kontraktuale të përparësisë për blerje që është futur në regjistrat publik, dhe kreditorin për të bërë deklaratë me shkrim nëse dëshirojnë që të shfrytëzojnë këtë të drejtë apo jo.

#### **Neni 227**

#### **Mënyra e shitjes së paluajtshmërisë**

1. Shitja e paluajtshmërisë bëhet me anë të ankandit publik verbal.

2. Seanca për shitjen e paluajtshmërisë mbahet në ndërtesën e Gjykatës, në qoftë se organi përmbarues nuk ka caktuar vend tjetër të shitjes.

3. Seanca për shitje mbahet para organit përmbarues.

#### **Neni 228**

#### **Marrëveshja për shitje me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë**

1. Palët dhe kreditorët e siguruar me peng e drejta për realizimin e kredive të të cilëve është së paku e rangut të njëjtë në relacion me propozuesin e përmbarimit, mund të merren vesh më së voni deri në momentin e shitjes së paluajtshmërisë në ankandin publik, që shitja e paluajtshmërisë të bëhet brenda afatit të caktuar me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë nëpërmjet personit të autorizuar për shitjen e paluajtshmërive dhe organit përmbarues, ose në ndonjë mënyrë tjetër.

2. Kontrata e shitjes nëpërmjet të ujdisë së drejtpërdrejtë lidhet me shkrim.

3. Kontratën në emër dhe llogari të debitorit e lidhë personi të cilit i është besuar shitja me konkluzionin e organit përmbarues. Nënshkrimet e personave që lidhin kontratën, duhet të verifikohen të organi kompetent.

4. Kjo kontratë prodhon efekt juridik prej ditës kur nxjerrët aktvendimi apo urdhri për dorëzimin e paluajtshmërisë së shitur.

#### **Neni 229**

#### **Kushtet e shitjes**

1. Kushtet e shitjes së paluajtshmërisë inkorporohen në konkluzionin për shitjen dhe përpos të informatave të tjera përmbajnë:

1.1. përshkrimin më të hollësishëm të paluajtshmërisë me sendet që i takojnë;

1.2. emërtimi i të drejtave të personave të tretë të cilat nuk shuhet me shitjen e sendit të paluajtshëm;

1.3. të dhënat se a është e liruar paluajtshmëria nga personat dhe gjësendet, apo është duke u shfrytëzuar dhe nëse po, atëherë për cilën bazë juridike;

1.4. vlerën e paluajtshmërisë;

1.5. çmimin me të cilin mund të shitet paluajtshmëria dhe kush është i detyruar t'i pa guajt tatimet dhe harxhimet lidhur me shitjen;

1.6. afatin brenda të cilit blerësi ka për detyrë ta paguajë shumën e të hollave në emër të çmimit blerës;

1.7. mënyrën e shitjes;

1.8. shumën e garancionit, afatin brenda të cilit duhet dhënë ai, të cili dhe si duhet të jepet garancioni;

1.9. kushtet e posaçme që duhet t'i plotësojë blerësi për të fituar të drejtën e pronësisë për paluajtshmërinë e blerë;

1.10. natyrën e pronës së shitur.

2. Në procedurën e përmbarimit për pjesën në bashkëpronësi nga neni 193 të këtij ligji, kushtet e shitjes nga paragrafi 1. i këtij neni, do t'i përfshijnë kushtet e shitjes sikurse për gjithë paluajtshmërinë ashtu edhe për pjesën në bashkëpronësi që është objekt i përmbarimit.



**Neni 230**  
**Pagesa e çmimit të blerjes**

Afati brenda të cilit blerësi ka për detyrë ta depozitojë çmimin nuk mund të jetë më i gjatë se tridhjetë (30) ditë nga dita e shitjes, pavarësisht nëse çmimi paguhet menjëherë ose me këste

**Neni 231**  
**Paradhënia**

1. Në ankandin publik si blerës mund të marrin pjesë vetëm personat që më parë e kanë depozituar garancionin.
2. Përveç personave të cilët sipas këtij ligji nuk kanë për detyrë të japin garanci në procedurën përbarimore, atë nuk kanë për detyrë ta jep as kreditori, e as titullarët e të drejtave të regjistruara në librin publik të palujtshmerive të cilat shuhen me shitjen e palujtshmërisë, po qe se kreditë e tyre janë të barabarta me shumën e garancisë dhe po qe se kur merret parasysh radha e prioritetit të tyre dhe vlera e caktuar e palujtshmërisë, shuma e tillë do të mund të paguhej nga çmimi blerës.
3. Shuma e garancionit duhet të jetë e barabartë me një të dhjetën e vlerës së përcaktuar të palujtshmërisë, por nuk mund të jetë më e madhe se pesëmijë (5.000) Euro.
4. Ofertuesve, oferta e të cilëve nuk është pranuar, përveç tre (3) ofertuesve më të volitshëm, do t'u kthehet shuma e depozituar menjëherë pas përfundimit të ankandit.

**Neni 232**  
**Rasti kur paraqitet vetëm një ofertues**

1. Seanca për ankandin publik do të mbahet edhe po qe se në te merr pjesë vetëm një ofertues i vetëm.
2. Organi përbarues me propozimin e personit që e ka të drejtën e realizimit me prioritet të kredisë, me anë të konkluzionit do të shtyj seancën e ankandit, po qe se në të merr pjesë vetëm një ofertues.

**Neni 233**  
**Pamundësia për të qenë blerës**

Blerës i palujtshmërisë nuk mund të jetë Gjykatësi, ose personi tjetër që merr pjesë zyrtarisht në procedurën e shitjes, bashkëshorti i tyre dhe personat që janë gjini gjaku me ta (paraardhësit, pasardhësit, vëllezërit e motrat dhe bashkëshortët e tyre), debitori dhe bashkëshorti i tij, vlerësuesi i tij, por as personi i cili sipas ligjit nuk mund ta fitojë të drejtën e pronësisë për palujtshmërinë që është objekt i përbarimit.

**Neni 234**  
**Çmimi i shitjes së palujtshmërisë**

1. Në seancën e parë të ankandit të shitjes palujtshmëria nuk mund të shitet me çmimin që është më i ulët se tetëdhjetë përqind (80%) e vlerës së përcaktuar. Ofertat fillestare për seancën e parë, që janë më të vogla se tetëdhjetë përqind (80%) së përcaktuar nuk do të shqyrtohen.
2. Pa pëlqimin e personave të cilët në procedurën përbarimore e kanë të drejtën që t'i realizojnë kreditë e tyre para kreditorit, palujtshmëria në seancën e ankandit nuk mund të shitet për çmimin i cili nuk e mbulon as pjesërisht shumën e kredisë së propozuesit të përbarimit.
3. Në qoftë se palujtshmëria nuk ka mundur të shitet në seancën e parë, organi përbarues do ta caktojë seancën e dytë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh.

4. Organi përbarues e cakton seancën e dytë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh edhe kur tre (3) ofertuesit më të volitshëm në seancën e parë nuk e kanë paguar çmimin blerës, brenda afateve të caktuara.

5. Në seancën e dytë paluajtshmëria nuk mund të shitet për çmimin që është më i vogël se gjysma e vlerës së përcaktuar me konkluzionin për shitjen. Oferta fillestare në seancën e dytë nuk mund të jetë më e vogël se gjysma e vlerës së përcaktuar.

6. Në qoftë se paluajtshmëria nuk shitet në seancën e dytë, organi përbarues e cakton seancën e tretë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) deri tridhjetë (30) ditë. Në këtë seancë paluajtshmëria nuk mund të shitet me çmim më të vogël se një e treta e vlerës së përcaktuar të paluajtshmerise.

7. Po qe se nuk ekzistojnë persona me të drejtë parablerjeje ligjore, apo kontraktuale, atëherë personi i cili sipas këtij ligji e ka të drejtën e realizimit me prioritet të kredisë së tij nga çmimi i shitjes, e fiton të drejtën e parablerjes së paluajtshmërisë me çmimin e arritur në seancën e tretë.

### **Neni 235**

#### **Caktimi i çmimit me marrëveshjen e palëve**

1. Në qoftë se palët para se të ketë filluar procedura përbarimore kanë bërë marrëveshje me organin përbarues, që paluajtshmëria të shitet për çmimin më të ulët se ai nga paragrafi 1., 2. dhe 6. të nenit 234 të këtij ligji, atëherë paluajtshmëria mund të shitet me çmimin e tillë që në seancën e parë të shitjes. Kjo marrëveshje quhet e vlefshme vetëm në qoftë se në procedurën përbarimore nuk marrin pjesë personat me të drejta të regjistruara në librin publik të paluajtshmërive, para regjistrimit të së drejtës së propozuesit të përbarimit.

2. Çmimi më i ulët me të cilin mund të shitet paluajtshmëria sipas dispozitave të paragrafit 1. të këtij neni, nuk mund të jetë më i ulët se një e treta (1/3) e vlerës së përcaktuar.

3. Palët dhe personat e siguruar me peng mund të merren vesh nëpërmjet deklaratave të dhëna në procesverbal, që paluajtshmëria të shitet me çmim më të ulët se ai që është përmendur në paragrafin 1., 2. dhe 5. të nenit 234 të këtij ligji.

4. Dispozitat e paragrafit 1., 2. dhe 6. të nenit 234 të këtij ligji dhe paragrafit 1. të këtij neni, zbatohen përshtatshëmish edhe në rastin kur paluajtshmëria shitet sipas ujdisë të drejtpërdrejtë

### **Neni 236**

#### **Seanca për shitjen dhe shitja e paluajtshmërisë**

1. Në qoftë se në ditën e mbajtjes së seancës, aktvendimi apo urdhri për përbarimin nuk është bërë i përbarueshëm, organi përbarues mund ta shtyjë mbajtjen e seancës për ankand dhe shitje, për më së shumti tridhjetë (30) ditë.

2. Pasi të ketë konstatuar se janë përmbushur kushtet për mbajtjen e seancës për ankand, organi përbarues shpall se fillon ankandi.

3. Në qoftë se procedura e përbarimit zbatohet për pjesën në bashkëpronësi nga neni 194 i këtij ligji, organi përbarues njëkohësisht e ofron për shitje edhe pjesën në bashkëpronësi, e edhe paluajtshmërinë në tërësi. Pas deponimit të ofertave më të volitshme për të dy objektet e shitjes dhe pas vlerësimit të kushteve nga paragrafi 3. i nenit 194 të këtij ligji, organi përbarues me anë të konkluzionit vendosë për objektin definitiv të shitjes.

4. Ankandi i shitjes përfundon pasi të kenë kaluar pesë minuta pas paraqitjes së ofertës më të favorshme.

5. Pas përfundimit të ankandit organi përbarues konstaton se cilët janë ofertuesit që kanë ofruar çmimin mbi minimumin dhe njëherit konstaton se paluajtshmëria i shitet ofertuesit më të favorshëm nga të gjithë të tjerët, po qe se janë plotësuar kushtet e tjera.

6. Në seancën e ankandit për shitjen e paluajtshmërisë mbahet procesverbal.

**Neni 237**  
**Shpallja e konkluzionit për shitjen**

Për shitjen e paluajtshmëris ofertuesit më të favorshëm, organi përmbaues nxjerrë konkluzion të shkruar të cilin e shpallë në tabelën e organit përmbaues dhe ua dërgon nga një ekzemplar palëve dhe personave që kanë marrë pjesë në ankand si ofertues të blerjes.

**Neni 238**  
**Shitja në rast të ujdisë së drejtpërdrejtë**

1. Në rast të shitjes së paluajtshmërisë me ujdinë e drejtpërdrejtë, organi përmbaues e nxjerrë konkluzionin nga neni 237 të këtij ligji, pasi që të vërtetojë se janë plotësuar kushtet për shitje të vlefshme.

2. Në qoftë se në momentin e nxjerrjes së konkluzionit nga paragrafi 1. i këtij neni, aktvendimi apo urdhri për përbarimin nuk është bërë ende i përmbaueshëm, Gjykata mund ta shtyjë nxjerrjen e tij për më së shumti tridhjetë (30) ditë.

3. Dispozitat e paragrafit 3. të nenit 236 të këtij ligji, në mënyrë të përshtatur aplikohen edhe për shitjen me ujdinë e drejtpërdrejtë.

4. Konkluzioni nga paragrafi 1. i këtij neni, publikohet në tabelën e organit përmbaues dhe u dërgohet të gjithë personave të cilëve u dërgohet konkluzioni për shitjen, si dhe blerësit të paluajtshmërisë.

**Neni 239**  
**Depozitimi i çmimit blerës**

1. Sigurimin e depozituar duke depozituar te organi përmbaues brenda afatit të caktuar nga organi përmbaues, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se tridhjetë (30) ditë nga dita e publikimit të konkluzionit për shitjen.

2. Në qoftë se ofertuesi i ofertës më të madhe nuk e deponon çmimin blerës brenda afatit të caktuar, organi përmbaues me anë të konkluzionit e shpallë të pavlefshme shitjen që i është bërë këtij ofertuesi dhe me konkluzion të ri konstaton se paluajtshmëria i është shitur ofertuesit të dytë të radhës, i cili brenda afatit që e cakton organi përmbaues, e i cili afat nuk mund të jetë më i gjatë se tridhjetë (30) ditë nga dita në të cilën i dorëzohet konkluzioni, duhet ta depozitojë në organin përmbaues çmimin blerës. Po qe se as ofertuesi i dytë nuk e depoziton çmimin brenda afatit të caktuar nga organi përmbaues, organi përmbaues i zbaton rregullat në fjalë edhe për ofertuesin e tretë me radhë.

3. Në qoftë se asnjëri nga tre (3) ofertuesit nga paragrafi 2. i këtij neni, nuk e përmbushë detyrimin e depozitimit të çmimit blerës brenda afateve të caktuara, organi përmbaues mund ta konsiderojë të pasuksesshme seancën e parë dhe të caktojë seancë të re, ashtu siç është paraparë me nenet 227 deri 236 të këtij ligji.

**Neni 240**  
**Shpenzimet e seancës së pasuksesshme**

1. Nga sigurimi i depozituar nga ofertuesi i parë të cilit i është shitur paluajtshmëria dhe i cili brenda afatit të caktuar nuk e paguan çmimin blerës, paguhet shpenzimet e seancës së pasuksesshme. Po qe se këto shpenzime nuk mund të mbulohen në tërësi nga shumat siguroese të cilën e ka depozituar ofertuesi i parë, dallimi paguhet nga sigurimi i ofertuesit të dytë, po qe se edhe ky heqë dorë nga blerja e paluajtshmërisë. Këto rregulla zbatohen në mënyrë të përshtatur edhe në rastin e heqjes dorë nga blerja e ofertuesit të tretë.

2. Shpenzimet e seancës së ardhshme paguhen proporcionalisht nga sigurimi i ofertuesve të cilëve u është shitur paluajtshmëria, por të cilët nuk e kanë depozituar çmimin blerës brenda afatit të caktuar nga organi përmbarues .

3. Shuma e mbetur pas pagimit të shpenzimeve procedurale i kthehet depozituesit të sigurimit.

#### **Neni 241**

##### **Kthimi i sigurimeve të depozituara**

1. Pasi të depozitohet te organi përmbarues çmimi i plotë i paluajtshmërisë së shitur, sigurimet e depozituara të ofertuesve të tjerë kthehen brenda afatit prej tre (3) ditësh nga dita e depozitimit të çmimit te organi përmbarues.

2. Në qoftë se blerës i sendit është kreditori dhe po qe se nuk ekzistojnë persona të tjerë, kreditë e të cilëve përmbushen para kredisë së tij nga çmimi me të cilin i është shitur paluajtshmëria, atëherë ai nuk është i detyruar ta depozitojë çmimin te organi përmbarues që i korrespondon shumës së kredisë së tij.

3. Në qoftë se çmimi blerës është më i madh se kredia e tij përmbarimore, kreditori duhet ta depozitoj dallimin ndërmjet çmimit dhe kredisë së tij.

4. Dispozitat e paragrafëve 1., 2. dhe 3. të këtij neni, zbatohen edhe kur kredia e kreditorit të përmbarimit sipas ligjit përmbushet përpara se të përmbushen kreditë e kreditorëve tjerë, që kanë të drejtë për përmbushje nga i njëjti çmim i shitjes së paluajtshmërisë së debitorit.

#### **Neni 242**

##### **Dorëzimi i paluajtshmërisë blerësit**

1. Pas depozitimit të çmimit organi përmbarues nxjerrë aktvendimin apo urdhrin në të cilin konstaton se paluajtshmëria i është shitur blerësit të caktuar.

2. Me aktvendimin apo urdhërin nga paragrafi 1. i këtij neni, organi përmbarues vendosë që paluajtshmëria t'i dorëzohet blerësit, kurse mbajtësi i librit publik të paluajtshmërive urdhërohet që në të të regjistrohet e drejta e pronësisë së blerësit për paluajtshmërinë e blerë. Po me këtë aktvendim apo urdhër organi përmbarues e caktton fshirjen e të drejtave për të cilat është thënë se do të fshihen me aktvendimin apo urdhër për shitjen e paluajtshmërisë.

3. Kundër aktvendimit ose urdhrin nga paragrafi 1. i këtij neni, nuk lejohet prapësimi, por goditja e tij mund të bëhet me ankesë.

4. Aktvendimi ose urdhri nga paragrafi 1. i këtij neni, publikohet në tabelën e organit përmbarues. Pas kalmit të tre (3) ditëve pas ditës së publikimit në tabelën e organit përmbarues, konsiderohet se aktvendimi ose urdhri u është dorëzuar të gjithë personave të cilëve duhet dorëzuar konkluzioni për shitjen dhe pjesëmarrësve në ankand.

#### **Neni 243**

##### **Humbja e të drejtës së posedimit të paluajtshmërisë**

Në momentin e shitjes së paluajtshmërisë debitori e humbë të drejtën e posedimit të paluajtshmërisë dhe ka për detyrë që atë t'i dorëzojë blerësit menjëherë pasi t'i dorëzohet aktvendimi ose urdhri për shitjen e paluajtshmërisë, po qe se me ligj, apo me marrëveshjen me blerësin nuk është paraparë ndryshe.

#### **Neni 244**

##### **Shpërngulja e debitorit**

1. Pasi që të nxjerrë aktvendimin ose urdhri për dorëzimin e paluajtshmërisë, organi përmbarues me kërkesën e blerësit, me konkluzion e urdhëron debitorin që ta zbrazë paluajtshmërinë dhe t'i dorëzojë blerësit.

2. Përmbartimi nga paragrafi 1. i këtij neni, kryhet sipas dispozitave të Kreut 7, Pjesës 2 të këtij ligji.

3. Në procedurën e përmbartimit nga paragrafi 2. i këtij neni, blerësi i paluajtshmërisë e fiton pozitën procedurale të propozuesit të përmbartimit, në momentin e paraqitjes së propozimit për përmbartim me qëllim zbrazjeje dhe dorëzimi të paluajtshmërisë.

#### **Neni 245**

##### **Shpërngulja e personave të tjerë**

1. Pas nxjerrjes së aktvendimit ose urdhërit me të cilin konstatohet se është shitur paluajtshmëria, organi përmbartues sipas propozimit të blerësit, me anë të aktvendimit ose urdhërit i urdhëron personat tjerë që ndodhen në paluajtshmërinë e shitur, që ta zbrazin dhe dorëzojnë atë blerësit, po qe se nuk e posedojnë dokumentin e vlefshëm që shërben si bazë juridike për shfrytëzimin e paluajtshmërisë. Me të njëjtin aktvendim ose urdhër kundër personave të këtillë, caktohet përmbartimi me anë të zbrazjes dhe dorëzimit të paluajtshmërisë.

2. Organi përmbartues do ta filloj zbatimin e përmbartimit të aktvendimit ose urdhërit nga paragrafi 1. i këtij neni, menjëherë pas nxjerrjes së tij. Përmbartimi zbatohet sipas rregullave të këtij ligji për përmbartimin për zbrazjen dhe dorëzimin e paluajtshmërive.

3. Në procedurën që kryhet sipas paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni, blerësi e ka pozitën procedurale të propozuesit të përmbartimit.

#### **Neni 246**

##### **Mbrojtja e të drejtave të blerësit**

Anulimi ose ndryshimi i aktvendimit ose urdhërit të përmbartimit pasi të jetë zbatuar aktvendimi ose urdhëri me të cilin është konstatuar shitja e paluajtshmërisë, nuk ndikon në të drejtën e pronësisë së blerësit të fituar në bazë të aktvendimit për dorëzimin e paluajtshmërisë.

#### **Neni 247**

##### **Përmbushja e kredisë me dorëzimin e paluajtshmërisë kreditorit**

1. Në qoftë se paluajtshmëria nuk shitet as në seancën e tretë të ankandit publik, ose me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë brenda afatit të caktuar nga organi përmbartues, me kërkesën e propozuesit të përmbartimit, organi përmbartues me aktvendim mund t'ia dorëzojë paluajtshmërinë vetë propozuesit të përmbartimit.

2. Në rastin nga paragrafi 1. i këtij neni, konsiderohet se kredia e kreditorit është përmbushur deri në shumën e cila i përgjigjet dy të tretave të vlerës së përcaktuar të paluajtshmërisë.

#### **Neni 248**

##### **Pezullimi i përmbartimit**

1. Në qoftë se paluajtshmëria nuk ka mundur të shitet as në seancën e tretë, kurse propozuesi i përmbartimit nuk e ka shfrytëzuar të drejtën nga neni 247 i këtij ligji, organi përmbartues do ta pezullojë përmbartimin,

2. Përmbartimi me anë të shitjes nëpërmjet ujdisë së drejtpërdrejtë, do të pezullohet në qoftë se paluajtshmëria nuk ka mundur të shitet në afatin e caktuar me marrëveshjen e palëve dhe personave që i realizojnë kreditë e tyre në të njëjtën procedurë përmbartimi, përveçse kur nga marrëveshja e palëve del diç tjetër.

#### **Neni 249**

##### **Efekti i pezullimit të përmbartimit**

Vendimi për pezullimin e përmbartimit nuk është pengesë që propozuesi i përmbartimit të fillojë rishtas procedurën e përmbartimit për realizimin e të njëjtës kredi për të njëjtën paluajtshmëri.

**Neni 250**  
**Kushtet për dhënie në shfrytëzim**

1. Kur plotësohen kushtet për pezullimin e përmbarimit, organi përmbarues mundet sipas kërkesës së propozuesit të përmbarimit, të cilën kërkesë ai mund ta paraqesë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, me aktvendim ose urdhër të vendosë që atij t'i dorëzohet paluajtshmëria në shfrytëzim me pagesë.

2. Aktvendimin ose urdhrin për dhënien e paluajtshmërisë kreditorit për shfrytëzim, debitori mund ta godet me ankesë.

**Neni 251**  
**Kohëzgjatja e shfrytëzimit dhe shpërblimi**

1. Me aktvendimin ose urdhrin me të cilin organi përmbarues vendosë që propozuesit të përmbarimit t'i dorëzohet paluajtshmëria për shfrytëzim, caktohet kohëzgjatja dhe lartësia e shpërblimit mujor për shfrytëzimin e paluajtshmërisë. Lartësia e shpërblimit caktohet në bazë të mendimit të ekspertit.

2. Koha brenda së cilës paluajtshmëria i jepet për shfrytëzim propozuesit të përmbarimit, caktohet nga organi përmbarues duke pasur parasysh shumën e kredisë në të holla të propozuesit të përmbarimit si dhe lartësia e shpërblimit të caktuar për shfrytëzimin e paluajtshmërisë.

3. Shpërblimi për shfrytëzimin e paluajtshmërisë i llogaritet debitorit në përmbushjen e kredisë së propozuesit të përmbarimit.

4. Pas kalimit të kohës nga paragrafi 2. i këtij neni, propozuesi i përmbarimit ka për detyrë që paluajtshmerinë t'ia kthejë debitorit.

5. Për dorëzimin dhe kthimin e paluajtshmërisë, në mënyrë të përshtatur zbatohen dispozitat e neneve 242 deri 245 të këtij ligji.

**Neni 252**  
**Momenti i pagesës**

Organi përmbarues bënë pagesën e kreditorit menjëherë pasi të jetë depozituar çmimi i blerjes së paluajtshmërisë së shitur.

**Neni 253**  
**Personat që paguhen**

1. Nga çmimi i shitjes paguhet propozuesi i përmbarimit me iniciativën e të cilit është vënë në veprim procedura përmbarimore, kreditorët e siguruar me peng dhe kur nuk i kanë parashtruar kredite e tyre edhe personat që kanë të drejtë shpërblimi për servitutet personale.

2. Teprica e çmimit blerës që mbetet pas përmbushjes së kërkesave të personave nga paragrafi 1. i këtij neni, i dorëzohet debitorit, po qe se për një gjë të tillë nuk ka pengesa juridike.

3. Në qoftë se çmimi i shitjes së paluajtshmërisë nuk është i mjaftueshëm për përmbushje në tërësi të kredive të radhës së njëjtë, përmbushja e tyre bëhet në proporcion me lartësinë e kredive të tilla.

**Neni 254**  
**Përmbushja e kredive me prioritet**

1. Nga shuma e fituar prej shitjes së paluajtshmërisë, paguhen në radhë të parë me këtë renditje:

1.1. shpenzimet e procedurës përmbarimore;

1.2. kërkesat e kreditorëve të siguruar me peng, të cilat sipas radhës së prioritetit realizohen përpara propozuesit të përmbarimit;

1.3. kërkesa e propozuesit të përmbarrimit;

1.4. kërkesat e kreditorëve të siguruar me peng, të cilat sipas radhës së prioritetit realizohen pas propozuesit të përmbarrimit;

1.5. shpërblimet për servitutet personale, të cilat shuhet me shitjen e paluajtshmërisë.

2. Po qe se debitori përveç borxhit kryesor duhet të paguajë edhe kamata, atëherë ato paguhen para se të paguhet borxhi kryesor.

3. Më tepër persona të të njëjtës pikë nga paragrafi 1. i këtij neni, i realizojnë kërkesat e tyre sipas radhës së fitimit të së drejtës së pengut dhe të drejtës së përmbushjes së kredisë së propozuesit të përmbarrimit, përkatësisht sipas radhës së fitimit të servituteve personale, po qe se me marrëveshje nuk është paraparë ndryshe.

#### **Neni 255**

##### **Radha e përmbushjes së kredive të tjera**

1. Dispozitat e nenit 254 të këtij ligji, në mënyrë të përshtatur zbatohen edhe për përmbushjen e të drejtave nga nën hipoteka dhe të drejtave që përbëjnë barrë për kredinë që realizohet.

2. Shpenzimet dhe kamatat për tri (3) vitet e fundit deri në momentin e nxjerrjes së aktvendimit apo urdhrit për dorëzimin e paluajtshmërisë blerësit, të caktuara me anë të dokumentit ekzekutiv, paguhen sipas radhës që i takon kredia kryesore.

#### **Neni 256**

##### **Shpërblimi për servitutet personale dhe të drejtat e tjera**

1. Në qoftë se për lartësinë e shpërblimit për servitutet personale, ose për të drejtat që shuhet në momentin e shitjes së paluajtshmërisë, nuk arrihet marrëveshje midis titullarëve të tyre dhe propozuesit të përmbarrimit, i cili për kah radha e realizimit vije pas tyre, lartësinë e shpërblimit e cakton organi përmbarrues duke marrë parasysh sidomos kohën për të cilën ato do të ekzistojnë, vlerën e tyre dhe moshën e titullarëve të tyre.

2. Blerësi i paluajtshmërisë dhe titullari i të drejtës së servitutit personal, mund të merren vesh që blerësi ta marrë përsipër servitutit, kurse shuma e shpërblimit të caktuar sipas paragrafit 1. të këtij neni, të hiqet nga çmimi blerës i paluajtshmërisë.

#### **Neni 257**

##### **Realizimi i kërkesave në mënyrë proporcionale**

Nëse ekzistojnë më tepër kredi të cilat e kanë të njëjtën radhë të realizimit, përmbushja e tyre bëhet në përpjesëtim të lartësisë që e kanë, po qe se shuma e fituar me anë të shitjes së paluajtshmërisë nuk është e mjaftueshme për përmbushjen e plotë.

#### **Neni 258**

##### **Kontestimi i kredisë**

Propozuesi i përmbarrimit, apo personi tjetër i cili e realizon kredinë e tij nga çmimi i shitjes së paluajtshmërisë, po qe se një gjë e tillë ka ndikim në përmbushjen e kredisë së tij, ka të drejtë që personit tjetër t'ia kontestoj ekzistimin e kredisë, përpos kredisë së caktuar me dokumentin ekzekutiv, lartësinë e saj dhe radhën sipas të cilës duhet të realizohet. Kontestimi mund të bëhet më së voni në seancën për ndarjen e të hollave të fituara me shitjen e paluajtshmërisë.

#### **Neni 259**

##### **Udhëzimi për fillimin e procesit kontestimor**

1. Personin i cili tjetrit ia ka kontestuar kredinë, organi përmbarrues e udhëzon që brenda afatit të caktuar, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se pesëmbëdhjet (15) ditë, që me padi ta fillojë procedurën kontestimore, po qe se vendimi varet nga faktet kontestuese dhe nëse kontestimin nuk e mbështetë

në aktgjykimin e formës së prerë, në dokumentin publik, ose në dokumentin jopublik, por të vërtetuar sipas ligjit.

2. Në qoftë se personi që e konteston kredinë, kontestimin e mbështetë në aktgjykimin e formës së prerë, në dokumentin publik, ose në dokumentin jopublik të vërtetuar sipas ligjit, me kërkesë të asaj pale Gjykata lidhur me kontestimin do të vendosë në procedurën përbarimore.

3. Lidhur me kontestimin e kredisë, Gjykata do të vendosë në procedurën përbarimore edhe kur nuk janë kontestuese faktet nga të cilat varet dhënia e vendimit.

#### **Neni 260**

#### **Rasti kur janë të besueshme shkaqet e kontestimit**

1. Në qoftë se personi i cili tjetrit ia konteston kredinë dhe e bënë të besueshëm ekzistimin e shkaqeve për kontestimin e sajë, organi përbarues me anë të konkluzionit për fillim të procedurës kontestimore, do ta udhëzojë personin të cilit i është kontestuar kredia, kurse dhënien e vendimit për realizimin e kredisë së kontestuar, e shtyn deri në momentin e përfundimit të procesit kontestimor. Përkrahimisht, organi përbarues mund ta kushtëzojë nxjerrjen e vendimit për realizimin e kredisë së kontestuar me depozitimin e garancionit nga ana e titullarit të saj.

2. Shuma e të hollave që ka të bëjë me kredinë e kontestuar do të depozitohet në depozitën e organit përbarues .

3. Në qoftë se personi i udhëzuar që ta filloj me padi procedurën kontestimore në afatin që i është caktuar nga organi përbarues , për një gjë të tillë nuk provon se e ka filluar atë, konsiderohet se kredia nuk është kontestuar, respektivisht se ka hequr dorë nga kërkesa që kredia e tij të realizohet në procedurën e përbarimit.

4. Dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni, nuk e prekin të drejtën e personit të udhëzuar për ngritjen e padisë, që edhe pasi të përfundojë procedura e përbarimit, ta fillojë procesin kontestimor kundër personit të cilit ia ka kontestuar kredinë, respektivisht kundër personit i cili ia ka kontestuar kredinë.

5. Me propozimin e personit të cilit i është kontestuar kredia, organi përbarues mund ta kushtëzojë nxjerrjen e aktvendimit apo urdhrin për realizimin e kredisë së tij, me depozitimin e garancionit për shpërblimin e dëmit që mund ta pësojë ai nga shkak i shtyrjes së realizimit të kredisë. Në qoftë se personi që e ka kontestuar kredinë nuk e depoziton garancionin brenda afatit që i është caktuar, do të konsiderohet se kredia nuk është kontestuar fare.

6. Personi të cilit i është kontestuar kredia, ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit që i është shkaktuar me kontestim të paarsyeshëm të kredisë së tij, po qe se një gjë e tillë i është bërë vetëm me qëllim që t'i shkaktohet dëmi, ose që të pengohet në realizimin e të drejtave të tija.

#### **Neni 261**

#### **Efekti juridik i aktgjykimit të dhënë nga Gjykata kontestimore**

Aktgjykimi i dhënë lidhur me kredinë e kontestuar në procedurën përbarimore prodhon efekt juridik kundër debitorit dhe të gjithë propozuesve të përbarimit.

#### **Neni 262**

#### **Realizimi i kredisë që ende nuk është e kërkueshme**

1. Kërkesa e kreditorit të siguruar me peng, e cila nuk është bërë e kërkueshme deri në ditën e nxjerrjes së aktvendimit apo urdhrin për përmbushjen e saj, e për të cilën nuk është kontraktuar kamata, do të paguhet pas zbritjes së shumës që i përgjigjet kamatëvonesës të caktuar me ligj prej datës së nxjerrjes së aktvendimit apo urdhrin për pagimin deri në ditën në të cilën kredia bëhet e kërkueshme.

2. Kredia që ende nuk është bërë e kërkueshme për të cilën është kontraktuar kamata, do të paguhet së bashku me shumën e kamatës së kontraktuar të përlogaritura deri në ditën e nxjerrjes së aktvendimit apo urdhrin të përmbushjes së saj.



**Neni 263**  
**Realizimi i të ardhurave periodike**

1. Kreditë e të ardhurave periodike për bazën e ushqimit ligjor, për bazën e shpërblimit të dëmit të krijuar për shkak të dëmtimit të shëndetit, ose zvogëlimit, respektivisht humbjes së aftësisë për punë dhe në bazë të shpërblimit të dëmit për ushqimin e humbur për shkak të vdekjes së dhënësit të ushqimit, që janë siguruar me peng e që bëhen të kërkueshme pas ditës së nxjerrjes së aktvendimit apo urdhrit për pagimin, përmbushen me kërkesën shprehimore të propozuesit të përbarimit.
2. Kreditë nga paragrafi 1. i këtij neni, përlogariten konform mënyrës sipas të cilës përlogaritet shpërblimi për servitutit personal.

**Neni 264**  
**Përmbushja e kredive të kushtëzuara**

1. Shuma e kredisë që është siguruar me të drejtën e pengut, e që varet nga kushti, do të veçohet dhe do të vihet në depozitën e organi përbarues dhe do të paguhet kur kushti shtytës të përmbushet, ose kur të jetë e sigurt se kushti zgjidhës nuk do të plotësohet.
2. Në qoftë se kushti shtyrës nuk përmbushet, apo ai zgjidhës plotësohet, shuma e veçuar e çmimit të shitjes së paluajtshmërisë shërben për realizimin e kredisë së propozuesit të përbarimit e cila nuk është realizuar pjesërisht apo plotësisht, e në qoftë se nuk ka kredi të tilla, ose në qoftë se pas përmbushjes së tyre tepron një pjesë e çmimit të shitjes, atëherë pjesa e mbetur i dorëzohet debitorit.

**Neni 265**  
**Para shënimi i pengut dhe shënimi i kontestit**

1. Po qe se në librin publik të paluajtshmërive është regjistruar para shënimi i të drejtës së pengut, kurse personi në dobi të të cilit parashënimi është regjistruar provon se është në zhvillim e sipër procedura kontestimore për justifikimin e saj, respektivisht se ende nuk ka skaduar afati për fillimin e kësaj procedure, kredia me të cilën ka të bëjë para shënimi do të paguhet sipas mënyrës sikurse paguhet kredia me kushtin shtyrës.
2. Kredia për të cilën në librin publik të paluajtshmërive është regjistruar shënimi për fillimin e procesit kontestimor me qëllim të fshirjes së të drejtës së pengut, ose shënimi për ndonjë kontest tjetër, përmbushet në mënyrën në të cilën përmbushet kredia e varur nga kushti zgjidhës.

**Neni 266**  
**Seanca e pjesëtimit**

1. Pasi aktvendimi apo urdhri për dorëzimin e paluajtshmërisë së shitur të ketë marrë formën e prerë, organi përbarues cakton seancën për pjesëtimin e shumës së fituar nga shitja, po qe se ekzistojnë më tepër kreditorë, apo persona të tretë që kanë të drejtë realizimi të kredive të tyre nga shuma në fjalë.
2. Në seancën e caktuar ftohen palët dhe personat të cilët sipas dokumenteve që i janë dorëzuar organi përbarues me të dhëna nga regjistri publik i paluajtshmërive kanë të drejtë të paguhet nga shuma e fituar nga shitja e paluajtshmërisë.
3. Në ftesën e dërguar, këta persona do të paralajmërohen se kreditë e tyre, po qe se nuk vijnë në seancë, do të trajtohen në bazë të gjendjes që del nga regjistri publik i paluajtshmërive dhe dokumenteve ekzistuese dhe se më së voni në seancën e pjesëtimit mund t'ia kontestojnë tjetrit kredinë, lartësinë e saj dhe radhën e realizimit.
4. Në seancë shqyrtohet për realizimin e kredisë së kreditorit dhe të personave të tjerë që shtrojnë kërkesa për realizimin e kredive të tyre.

**Neni 267**  
**Aktvendimi për realizimin e kredive**

1. Për realizimin e kredisë së kreditorit dhe të personave tjerë të cilëve u takon e drejta e realizimit të kredive të tyre, organi përbarues vendosë me anë të aktvendimit apo urdhërit menjëherë pas përfundimit të seancës, duke i marrë parasysh të dhënat nga libri publik i paluajtshmërive dhe dokumenteve ekzistuese, si dhe gjendjes së konstatuar gjatë seancës.
2. Me rastin e nxjerrjes së aktvendimit apo urdhrit nga paragrafi 1. i këtij neni, do të merren parasysh vetëm ato kredi lidhur me të cilat aktvendimi për përbarimin ose urdhri përbarues është bërë i ekzekutueshëm, në ditën e mbajtjes së seancës së pjesëtimit.
3. Po qe se ka kredi lidhur me të cilat aktvendimi për përbarimin ose urdhri përbarues ende nuk është bërë i ekzekutueshëm deri në ditën e seancës së pjesëtimit, atëherë ato do të përmbushen pasi të bëhet i ekzekutueshëm ai nga shuma e mbetur e çmimit të shitjes së paluajtshmërisë, po qe se ekziston mbetja e tillë, kurse teprica do t'i dorëzohet debitorit.
4. Dispozitat e paragrafit 2. dhe 3. të këtij neni, nuk kanë të bëjnë me kreditë e siguruara me anë të pengut.

**Neni 268**  
**Ankesa kundër aktvendimit**

1. Po qe se domosdoshmëria e mbajtjes së seancës dëgjimore të pjesëtimit të organi përbarues nuk del nga ky ligj, aktvendimin apo urdhri për realizimin e kredive organi përbarues do ta publikojë në tabelën e shpalljeve. Me kalimin e ditës së tretë nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve konsiderohet se aktvendimi ose urdhri u është dorëzuar të gjithë personave që kanë të drejtën e realizimit të kredive nga çmimi i paluajtshmërisë së shitur.
2. Kundër aktvendimit ose urdhrit për realizimin e kredive kanë të drejtë anekese palët dhe personat që kanë pretenduar realizimin e kredive të tyre nga çmimi i shitjes së paluajtshmërisë.
3. Në qoftë se ankesa kundër aktvendimit ose urdhrit për realizimin e kredive paraqitet brenda afatit ligjor, atëherë ajo u dërgohet palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë të procedurës përbarimore, kurse aktvendimi ose urdhri do të ekzekutohet në qoftë se kreditori brenda afatit prej tri (3) ditësh nga dita kur i është dorëzuar ankesa nuk e propozon shtyrjen e përbarimit deri në momentin e nxjerrjes së vendimit të Gjykatës së shkallës së dytë.
4. Përbarimi i aktvendimit ose urdhrit për realizimin e kredive bëhet pasi të skadojë afati për paraqitjen e ankesës nga personat të cilëve u takon e drejta e ankimit kundër tij.

**Neni 269**  
**Fshirja e të drejtave dhe e barrëve**

1. Pasi të bëhet i formës së prerë aktvendimi për realizimin e kredive, organi përbarues me aktvendim ose urdhër të posaçëm urdhëron që në librin publik të paluajtshmërive të fshihen të drejtat dhe barrët e regjistruara, përpos atyre që mbeten për paluajtshmërinë edhe pas dorëzimit të saj blerësit ose të cilat ky i fundit i ka marrë përsipër.
2. Blerësi me padi mund ta kërkojë fshirjen e të drejtave dhe barrëve nga paragrafi 1. i këtij neni nëse nuk është bërë nga organi përbarues dhe kadastra.

**Neni 270**  
**Përbarimi në territoret ku nuk ekziston libri publik i paluajtshmërive**

1. Në territorin për të cilin nuk është krijuar kadastra e paluajtshmërive, e as libri publik i paluajtshmërive, respektivisht nuk ekziston regjistri i paraparë me ligj i të drejtave për sendet e paluajtshme, përshtatshëmish do të zbatohen rregullat juridike të cilat vlejné për dokumentet që

parashtrihen bashkë me propozimin për përmbarrimin si provë për të drejtën e pronësisë për paluajtshmërinë që është objekt përmbarrimi, si dhe rregullat juridike për mënyrën tjetër të regjistrimit të aktvendimit për përmbarrimin ose urdhrin për përmbarrim për paluajtshmërinë. Kjo vlen edhe për rastin e asgjësimit apo zhdukjes së regjistrave.

2. Në qoftë se është e pamundshme pajisja me prova për të drejtën e pronësisë në pajtim me rregullat juridike që vlejné në territorin e caktuar, në vend të provës për pronësinë, kreditori ka për detyrë që në propozimin për përmbarrim ta shënojë vendin ku ndodhet paluajtshmëria, emërtimin e saj, kufijtë dhe sipërfaqen.

3. Në rastin nga paragrafi 2. i këtij neni, organi përmbarrues do ta bëjë inventarin sekuestrues të paluajtshmërisë për të cilën është propozuar përmbarrimi dhe për seancën e inventarizimit sekuestrues do ta thërret kreditorin, debitorin dhe personat me paluajtshmëritë e të cilëve kufizohet paluajtshmëria e tillë.

4. Procesverbali për inventarizimin sekuestrues e ka rëndësinë e regjistrimit të përmbarrimit dhe publikohet në tabelën e shpalljeve të organit përmbarrues.

5. Për inventarin sekuestrues të kryer, organi përmbarrues në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe së paku në një gazetë të përditshme, e publikon shpalljen në të cilën tregohet organi përmbarrues që e publikon shpalljen, numri i dosjes së lëndës, emri dhe adresa e palëve, të dhënat për paluajtshmërinë për të cilën zbatohet përmbarrimi, kur dhe ku është mbajtur seanca e inventarizimit sekuestrues dhe kur është publikuar procesverbali për inventarin sekuestrues në tabelën e organit përmbarrues. Pas kalimit të afatit pesëmbëdhjetë (15) ditor nga dita e shpalljes, organi përmbarrues i thërret personat e interesuar që ta njoftojnë organin përmbarrues për shkaqet eventuale të cilat e pengojnë ekzekutimin për paluajtshmërinë në fjalë.

#### **Neni 271**

#### **Përmbarrimi për paluajtshmërinë e paregjistruar**

1. Në qoftë se në territorin në të cilin janë themeluar librat publike të paluajtshmërive, paluajtshmëria nuk është e regjistruar, kreditori bashkë me propozimin për përmbarrim duhet të parashtrijë dokumente në bazë të cilave mund të bëhet regjistrimi.

2. Pasi të dorëzohet te organi përmbarrues propozimi për përmbarrimin dhe dokumentet në bazë të të cilave mund të bëhet regjistrimi i paluajtshmërisë, organi përmbarrues menjëherë do t'ia dërgojë dokumentet organit, apo organizatës që e mbanë regjistrin me qëllim të regjistrimit. Në këtë rast organi përmbarrues ndalet së vepruari derisa procedura e regjistrimit të mos përfundojë.

3. Në qoftë se kreditori në propozimin e tij për përmbarrim, për objekt përmbarrimi e propozon ndërtesën, apo pjesën e ndërtesës që nuk janë të regjistruara në librin publik të paluajtshmërive, bashkë me deklaratën se regjistrimi nuk mund të bëhet në kuptimin e paragrafi 1. dhe 2. të këtij neni, organi përmbarrues me aktvendim ose urdher do ta lejojë përmbarrimin për paluajtshmërinë në pronësi të paregjistruar të debitorit, po qe se kreditori e dorëzon, apo e thekson si provë për pronësinë e paregjistruar, lejen e ndërtimit të dhënë në emër të debitorit, ose në qoftë se leja e ndërtimit nuk është në emër të debitorit, dokumentet për veprimet juridike me të cilat mund të fitohet pronësia e debitorit për paluajtshmërinë apo pjesën e saj.

4. Me kërkesë të kreditorit të përmbarrimit, organi përmbarrues i cakton detyrë debitorit ose personit të tretë që t'i dorëzojnë dokumentet nga paragrafi 3. i këtij neni, me kërcënim të gjobitjes me të holla nga nenet 15 dhe 16 i këtij ligji. Me kërkesë të kreditorit, do të detyron me vendim të organit përmbarrues organi kompetent shtetëror që t'i dorëzojë dokumentet nga paragrafi 3. i këtij neni.

5. Kur organi përmbarrues e cakton përmbarrimin për sendin e paluajtshëm që nuk mund të regjistrohet në librin publik të paluajtshmërive, në pajtim me paragrafin 3. të këtij neni, në kushtet e shitjes do të theksohet posaçërisht se është fjala për pronësinë e paregjistruar, e në vend të shënimit do të bëhet inventari në mënyrën e paraparë me paragrafin 3. dhe 4. nenin 270 të këtij ligji.

## KREU X

### PËRMBARIMI PËR REALIZIMIN E KREDISË JO NË TË HOLLA

#### Neni 272

##### Caktimi i penaleve gjyqësore

1. Kur debitori nuk e përmbushë brenda afatit të caktuar ndonjë detyrim jo monetar të caktuar me anë të dokumentit përmbarues, organi përmbarues i cili është kompetent që ta caktojë përmbarimin për kredinë jo monetare, sipas propozimit të kërkuesit të përmbarimit, me aktvendim ose urdhër për përmbarim ia cakton debitorit afatin plotësues dhe detyrimin, në rast të mosrespektimit të afatit të këtillë që propozuesit të përmbarimit t'ia paguajë shumën e caktuar të parave për secilën ditë vonese, ose njësi tjetër kohore, në pajtim me rregullat për marrëdhëniet detyimore që nga dita e skadimit të afatit penalet gjyqësore.
2. Afati plotësues nga paragrafi 1. i këtij neni, fillon të ecë nga dita në të cilën debitorit i dorëzohet aktvendimi me të cilin është caktuar afati i tillë. Ecja e afatit plotësues nuk ndërpritet as kur goditet me ankesë aktvendimi për caktimin e penaleve.
3. Kundër aktvendimit nga paragrafi 1 i këtij neni, pala ka të drejtë ankese brenda afatit prej shtatë (7) ditësh. Ankesa e paraqitur nuk prodhon efekt suspensiv.
4. Në qoftë se debitori brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita kur bëhet i formës së prerë aktvendimi nga paragrafi 1. i këtij neni e përmbushë detyrimin e vet, organi përmbarues mund ta zvogëlojë shumën e penaleve me kërkesë të debitorit të paraqitur brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, por duke marrë parasysh qëllimin e pagimit të penaleve. Kërkesa e debitorit nuk ndikon në lejimin e përmbarimit dhe zbatimin e tij në bazë të aktvendimit të formës së prerë për pagimin e penaleve gjyqësore nga paragrafi 1. i këtij neni.
5. Vendimi sipas paragrafit 1. deri ne 3. të këtij neni pasi që të marr formën e prerë mund të përmbarohet në të njëjtën procedurë.

#### Neni 273

##### Përmbarimi për realizimin e penaleve të caktuara

1. Në bazë të aktvendimit të formës së prerë për pagimin e penaleve gjyqësore nga neni 272 i këtij ligji, organi përmbarues po në atë procedurë përmbarimore në të cilën e ka nxjerrë aktvendimin e tillë, sipas propozimit të kërkuesit të përmbarimit, do ta nxjerrë aktvendimin për përmbarimin ose urdhrin përmbarues me qëllim të pagimit të detyrueshëm të penaleve të caktuara.
2. Po qe se debitori në prapësimin kundër aktvendimit për përmbarimin ose urdhrin përmbarues pretendon se e ka përmbushur detyrimin e tij, organi përmbarues do ta miratoj prapësimin e tij në procedurën përmbarimore vetëm po qe se themelësinë e tij e provon me anë të dokumentit publik ose jo publik, por që e ka rëndësinë e dokumentit publik.

## KREU XI

### PËRMBARIMI ME QËLLIM TË DORËZIMIT TË SENDEVE TË LUAJTSHME

#### Neni 274

##### Kompetenca territoriale në rast të përmbarimit gjyqësor

Për të vendosur për propozimin për përmbarimin me qëllim të dorëzimit të një apo të disa sendeve të caktuara, apo me qëllim të dërgimit të sasisë së caktuar të sendeve të zëvendësueshme dhe për zbatimin e përmbarimit, është kompetente Gjykata në territorin e të cilës ndodhen sendet e tilla.

#### **Neni 275**

#### **Kompetenca në rast të përbarimit nga ana e përbaruesit privat**

Për të vendosur për propozimin për përbarimin me qëllim të dorëzimit të një apo të disa sendeve të caktuara, apo me qëllim të dërgimit të sasisë së caktuar të sendeve të zëvendësueshme dhe për zbatimin e përbarimit, përbaruesi privat ka kompetence për të vendosur mbi propozimin përbarimorë dhe të zbatojë përbarimin.

#### **Neni 276**

#### **Kur sendet ndodhen të debitori ose të personi i tretë**

1. Përbarimi për dorëzimin e një ose të disa sendeve të caktuara që ndodhen pranë debitorit, zbatohet duke i marrë këto sende prej debitorit nga ana e organit përbarues dhe duke ia dorëzuar kreditorit kundrejt një vërtetimi me shkrim.

2. Në mënyrën e treguar në paragrafin 1. të këtij neni, përbarimi do të zbatohet edhe kur sendet ndodhen të personi i tretë i cili është i gatshëm t'ia dorëzojë organit përbarues. Në qoftë se personi i tretë nuk dëshiron t'ia dorëzojë sendet, kërkuesi i ekzekutimit mund t'ia propozojë organit përbarues që atij t'ia kalohet kredia e debitorit kundrejt personit të tretë për dorëzimin e sendeve.

3. Në procedurën e përbarimit sipas propozimit nga paragrafi 2. i këtij neni, zbatohen dispozitat e këtij ligji për përbarimin në kredinë që të dorëzohen ose dërgohen sendet e luajtshme.

#### **Neni 277**

#### **Kur sendet nuk janë gjetur as te debitori e as te personi i tretë**

1. Kur sendet e luajtshme nuk gjinden te debitori apo te personi i tretë, organi përbarues do ta njoftoj kreditorin i cili brenda afatit prej shtatë (7) ditësh mund të propozon vlerësimin e atyre sendeve dhe pagesën e vlerës së tyre për përmbushjen e kredisë.

2. Bazuar në propozimin e paragrafit 1. të këtij neni, organi përbarues do të caktoj një ekspert që ti vlerësojë sendet e luajtshme dhe do të lëshoj një vendim duke urdhëruar debitorin që të paguaj shumën e vlerës së tyre të përcaktuar në procedurën e njëjtë përbaruese.

3. Nëse propozimi i kreditorit nuk parashtrohet brenda afatit të paraparë në paragrafin 1. të këtij neni procedura e përbarimit do të pezullohet.

#### **Neni 278**

#### **Bashkimi i propozimeve**

1. Kërkuesi i përbarimit bashkë me propozimin për përbarimin për dorëzimin e sendeve që ndodhen te debitori, ose te personi i tretë, mund ta parashtrorë edhe propozimin për nxjerrjen e aktvendimit apo urdhrit nga paragrafi 1. i nenit 277 të këtij ligji. Në rast të bashkimit të dy propozimeve në fjalë, përbarimi sipas nenit 276 të këtij ligji dhe procedura e këtij neni zbatohen njëkohësisht.

2. Organi përbarues mund ta caktojë përbarimin e paraparë në paragrafin 3. të nenit 277 të këtij ligji dhe ta fillojë zbatimin e saj, por veprimet e shitjes së sendeve të sekuestruara të debitorit dhe kalimi i të hollave nga llogaria e tij bankare, nuk mund të bëhen para se të konstatohet se përbarimi nga paragrafi 1. dhe 2. i nenit 276 të këtij ligji nuk ka mundur të kryhet.

3. Në qoftë se përfundon me sukses përbarimi i rregulluar në nenin 276 të këtij ligji, organi përbarues sipas detyrës zyrtare e pezullon procedurën, e anulon aktvendimin ose urdhrin nga paragrafi 1. i nenit 277 të këtij ligji dhe veprimet tjera të kryera sipas dispozitave të paragrafit 1. të këtij neni. Në rast të këtyre kërkuesit të përbarimit i mbeten në ngarkim shpenzimet e shkaktuara me parashtrimin e propozimit nga paragrafi 1. i këtij neni.

**Neni 279**  
**Përmbartimi për dërgimin e sendeve të zëvendësueshme**

Në qoftë se me dokumentin përmbartues është caktuara detyrimi për dërgimin e sasisë së caktuar të sendeve të zëvendësueshme që ndodhen te debitori, ose personi i tretë, përmbartimi zbatohet në mënyrën e paraparë për dorëzimin e sendeve të caktuara individualisht, neni 276 zbatohet përshtatshmërisht.

**Neni 280**  
**Veprimet procedurale kur nuk janë gjetur sendet**

1. Kur sendet e zëvendësueshme nuk janë gjetur as te debitori e as te personi i tretë, kërkuesi i përmbartimit mund të propozojë që përmbartimi të zbatohet duke e autorizuar organin përmbartues që brenda afatit të caktuar t'i blejë diku tjetër këto sende me shpenzime të debitorit.
2. Propozimin që sendet t'i blejë diku tjetër, kërkuesi i përmbartimit mund ta parashtrojë brenda shtatë (7) ditësh nga dita në të cilën organi përmbartues e ka njoftuar që sendet nuk janë gjetur as te debitori as te personi i tretë.
3. Sipas propozimit të kërkuesit të përmbartimit organi përmbartues me aktvendim ose urdhër e urdhëron debitorin që brenda afatit të caktuar ta depozitojë te organi përmbartues shumën e të hollave të nevojshme për blerjen e sendeve dhe e cakton përmbartimin për pagimin e kësaj shume me kamatëvonesë nga dita e vlerësimit të sendeve deri në ditën e depozitimit të shumës te organi përmbartues.
4. Kërkuesi i përmbartimit ka për detyrë që në propozimin nga paragrafi 1. i këtij neni, ta përcaktoj mjetin përmbartimorë, me qëllim të pagimit të shumës së nevojshme për blerjen e sendeve të zëvendësueshme.
5. Përmbartimi i aktvendimit ose urdhrit nga paragrafi 1. dhe 3. i këtij neni, bëhet vetëm pasi të ketë marrë formë të prerë.
6. Në qoftë se kërkuesi i përmbartimit në afatin nga paragrafi 2. i këtij neni nuk e ka parashtuar propozimin për blerjen e sendeve diku tjetër, organi përmbartues do ta pezullojë procedurën përmbartimore, përveç se kur kërkuesi i përmbartimit me kohë e ka parashtuar edhe propozimin që debitori t'ia paguaj vlerën e sendeve që ka qenë i detyruar t'i dorëzojë.
7. Po qe se gjatë zhvillimit të procedurës ndryshon vlera e sendeve të zëvendësueshme, kërkuesi i përmbartimit mund të kërkojë nga organi përmbartues vlerësimin e ri dhe ta urdhërojë debitorin që ta paguajë dallimin e vlerës.

**Neni 281**  
**E drejta e shpërblimit të dëmit**

Me dispozitat e kreut të këtij ligji nuk preket në të drejtën e kërkuesit të përmbartimit që me padi kundër debitorit, në procedurë kontestimore ta kërkojë shpërblimin e dëmit që i është shkaktuar me mosdorëzimin, ose mos dërgimin e sendeve.

**KREU XII**  
**PËRMBARTIMI PËR ZBRAZJEN DHE DORËZIMIN E PALUAJTSHMËRISË**

**Neni 282**  
**Kompetenca territoriale në rast të përmbartimit gjyqësor**

Për të vendosur për propozimin për përbarim me anë të zbrajes dhe dorëzimit të sendit të paluajtshëm, si dhe për kryerjen e përbarimit, e kompetencës territoriale është Gjykata në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria.

#### **Neni 283**

#### **Kompetenca në rast të përbarimit nga ana e përbaruesit privat**

Për të vendosur për propozimin për përbarim me anë të zbrajes dhe dorëzimit të sendit të paluajtshëm, si dhe për kryerjen e përbarimit, përbaruesi privat ka kompetencë për të vendosur mbi propozimin përbarimor dhe për të zbatuar përbarimin.

#### **Neni 284**

#### **Mënyra e zbatimit të përbarimit**

1. Procedura e përbarimit me qëllim të zbrajes dhe dorëzimit të sendit të paluajtshëm zbatohet ashtu që organi përbarues, pasi t'i largojë personat dhe sendet nga paluajtshmëria, ia dorëzon atë në posedim kreditorit të përbarimit.

2. Zbraja dhe dorëzimi i paluajtshmërisë bëhet vetëm pas kalimit të shtatë (7) ditëve nga dita në të cilën debitorit i është dorëzuar aktvendimi për përbarimin ose urdhri përbarues, i cili nuk ka paraqitur prapësim kundër aktvendimit ose urdhrit të këtyllë. Në rast se kundër aktvendimit ose urdhrit për përbarim debitori ka paraqitur prapësim, atëherë afati shtatë (7) ditor fillon të ecë nga dita në të cilën debitorit i dorëzohet aktvendimi për refuzimin e prapësimit.

3. Në qoftë se me largimin e personave nga paluajtshmëria janë përfshirë personat e mitur, atëherë organi përbarues për përbarimin në zhvillim e sipër e njofton organin e kujdestarisë.

4. Fuqinë punëtore të nevojshme dhe mjetet për transport me qëllim të kryerjes së përbarimit, ka për detyrë t'i sigurojë propozuesi i përbarimit. Njoftimin lidhur me këtë, organi përbarues duhet t'ia dërgoj kreditorit së paku shtatë (7) ditë para se të fillojë zbatimin e përbarimit.

#### **Neni 285**

#### **Masat e dhunshme në rast nevoje**

1. Me kërkesën e organit përbarimor organet e policisë dhe organi i kujdestarisë janë të detyruar që të japin gjithë ndihmën e nevojshme, me qëllim të kryerjes së veprimeve përbarimore nga paragrafi 1. i nenit 284 të këtij ligji.

2. Kundër personave të cilët e pengojnë përbarimin, Gjykata e shqipton masën e largimit apo gjobën me të holla nga neni 15 dhe 16 i këtij ligji.

#### **Neni 286**

#### **Mënjanimi i sendeve të luajtshme nga paluajtshmëria**

1. Sendet e luajtshme që duhet mënjanuar nga paluajtshmëria i dorëzohen debitorit, e në qoftë se ky nuk është i pranishëm, anëtarit të rritur të familjes së tij ose personit të autorizuar nga debitori.

2. Në qoftë se me rastin e kryerjes së veprimeve përbarimore nuk është i pranishëm asnjë nga personat nga paragrafi 1. i këtij neni, apo në qoftë se këta persona refuzojnë t'i marrin, sendet do t'i jepen për ruajtje personit tjetër, me shpenzimet e debitorit.

3. Kreditori ka për detyrë që ta gjejë personin tjetër të cilit i dorëzohen sendet e mënjanuara nga paluajtshmëria. Kreditori mundet vetë t'i marrë sendet e luajtshme të mënjanuara të debitorit për ruajtje me shpenzime të cilat i mbeten në ngarkim debitorit.

#### **Neni 287**

#### **Konfirmimi i veprimeve të përbaruesit**

1. Sendet e mënjauara ia dorëzon për ruajtje personit tjetër, apo kreditorit të përbarimit, organi përbarues. Organi përbarues mund të vendosë më vonë me anë të konkluzionit, që sendet e mënjauara t'i merren personit tjetër dhe t'i besohen për ruajtje personit të tretë.

2. Për dhënien e sendeve për ruajtje personit të tretë dhe për shpenzimet e ruajtjes, organi përbarues e njofton debitorin, po qe se kjo është e mundshme dhe i cakton afat brenda të cilit mund ta kërkojë dorëzimin e sendeve pasi t'i paguaj shpenzimet e ruajtjes deri në atë moment.

3. Bashkë me këtë njoftim, organi përbarues do ta paralajmërojë debitorin se pas skadimit të afatit të caktuar sipas paragrafit 2. të këtij neni, sendet do të shiten dhe prej çmimit të shitjes do të paguhen shpenzimet e ruajtjes dhe të shitjes së sendeve.

#### **Neni 288**

#### **Shitja e sendeve të mënjauara**

1. Organi përbarues do të caktojë me anë të konkluzionit shitjen e sendeve të mënjauara për llogari të debitorit, në qoftë se ky brenda afatit që i është lënë nuk e kërkon dorëzimin e tyre dhe nuk i kompenson shpenzimet e ruajtjes.

2. Pjesa e çmimit të arritur nga shitja që mbetet pas pagimit të shpenzimeve të ruajtjes dhe të shitjes, depozitohet te organi përbarues në dobi të debitorit.

3. Shitja e sendeve bëhet sipas dispozitave të këtij ligji të parapara në Kreun 1, Pjesën 2, të këtij ligji, me qëllim të përmbushjes së kredive në të holla.

#### **Neni 289**

#### **Përbarimi për realizimin e shpenzimeve**

1. Kreditori ka të drejtë që në propozimin e tij për përbarim, me qëllim të zbrazjes dhe dorëzimit të sendit të paluajtshëm të kërkojë që bashkë me përbarimin të caktohet përbarimi për sendet e luajtshme të debitorit, që duhet mënjauar nga paluajtshmëria me qëllim të pagimit të shpenzimeve procedurale.

2. Përbarimi nga paragrafi 1. i këtij neni caktohet dhe zbatohet sipas rregullave të këtij ligji të parapara në Kreun 1, Pjesën 2 të këtij ligji për realizimin e kredisë në të holla, sipas propozimit të kërkuarit të përbarimit.

### **KREU XIII**

#### **PËRMBARIMI PËR REALIZIMIN E KREDISË PËR VEPRIM, MOSVEPRIM, APO DURIM / PËSIM**

#### **Neni 290**

#### **Kompetenca territoriale në rast të përbarimit nga Gjykata**

Në qoftë se debitori në bazë të dokumentit përbarues, ka për detyrë të kryejë veprimin e caktuar, apo ti duroj veprimet e caktuara, ose të përmbahet nga veprimi i caktuar, për të vendosur për propozimin për përbarim dhe për zbatimin e përbarimit e kompetencës territoriale është Gjykata në territorin e të cilës debitori duhet ta përmbushë detyrimin e caktuar në dokumentin përbarues.

#### **Neni 291**

#### **Kompetenca në rast të përbarimit nga ana e përbaruesve privat**

Për të vendosur për propozimin përbarimor në qoftë se debitori në bazë të dokumentit përbarues, ka për detyrë të kryejë veprimin e caktuar, apo ti duroj veprimet e caktuara, ose të përmbahet nga veprimi i caktuar, përbaruesi privat ka kompetencë për të vendosur mbi propozimin përbarimor dhe të zbatojë përbarimin.

#### **Neni 292**

#### **Detyrimi i veprimit që mund të kryhet nga çdokush**



1. Përmbartimi për realizimin e detyrimit për veprim të cilin mund ta kryej çdokush, zbatohet ashtu që organi përmbartues e autorizon kreditorin që me shpenzime të debitorit t'ia besoj ndonjë personi tjetër kryerjen e veprimit të tillë apo që vetë ta kryejë atë veprim.

2. Në propozimin për përmbartim, kërkuesi i përmbartimit mund të propozojë që organi përmbartues me aktvendim apo urdhër për përmbartim t'ia urdhërojë debitorin që më parë ta depozitoj në Gjykatë shumën e caktuar të nevojshme për pagimin e shpenzimeve që do të shkaktohen me kryerjen e veprimit nga personi tjetër, apo nga vetë kreditori. Sasinë e shumës së depozituar organi përmbartues e cakton sipas vlerësimit të lirë, duke marrë parasysh sipas mundësisë çmimoren e personit të autorizuar për kryerjen e veprimit të tillë, të cilën propozimit për përmbartim ia bashkangjetë kreditori.

3. Aktvendimin ose urdhrin definitiv për sasinë e shpenzimeve nga paragrafi 2. i këtij neni, organi përmbartues e jep me propozimin e kërkuesit të përmbartimit, respektivisht të debitorit, pasi të jetë kryer veprimi.

4. Në qoftë se më vonë konstatohet se në bazë të aktvendimit ose urdhrin nga paragrafi 2. i këtij neni, janë marrë nga debitori më tepër mjete se që ka qenë nevoja për mbulimin e shpenzimeve për kryerjen e veprimit dhe të shpenzimeve të procedurës përmbartimore, atëherë organi përmbartues do ta kthejë dallimin nëse ka mjete të marra nga debitori, respektivisht do t'i urdhërojë kreditorit që brenda afatit të caktuar ta kthejë dallimin e tillë, po qe se atij i është lanë në disponim.

5. Në bazë të aktvendimit nga paragrafi 2. i këtij neni, mund të propozohet përmbartimi edhe para se të bëhet i formës së prerë aktvendimi ose urdhri për përmbartimin, kurse në bazë të aktvendimit nga paragrafi 3. i këtij neni, vetëm pasi ai të bëhet i formës së prerë.

#### **Neni 293**

#### **Detyrimi i veprimit që mund të kryhet vetëm nga debitori**

1. Në qoftë se veprimin e caktuar në dokumentin përmbartues mund ta kryejë vetëm debitori, organi përmbartues me aktvendimin për përmbartimin ose urdhrin përmbartues do t'ia caktojë debitorit afatin për përmbartjen e detyrimit. Me aktvendimin ose urdhrin për përmbartimin organi përmbartues njëherit i kërcënohet debitorit dhe eventualisht personave përgjegjës në debitorin që është person juridik, se do të gjobiten sipas nenit 15 dhe 16 të këtij ligji, po qe se brenda afatit të caktuar nuk e përmbartshin detyrimin.

2. Në qoftë se debitori brenda afatit që ia ka caktuar organi përmbartues nuk e përmbartshë detyrimin, Gjykata sipas propozimit të kërkuesit të përmbartimit, do të veprojë më tutje sipas dispozitave të nenit 15 dhe 16 të këtij ligji.

3. Debitori që e ka përmbartshur detyrimin e vet brenda afatit të cilin ia ka lënë organi përmbartues, ka për detyrë që pa vonesë ta njoftojë organin përmbartues për një gjë të tillë, si dhe ta parashtrijë të organi përmbartues mjetin me të cilin në mënyrë të padyshimtë provohet pretendimi i tillë. Provë e këtillë konsiderohet deklarata me shkrim e kërkuesit të përmbartimit të vërtetuar, nga e cila shihet se veprimi i detyruar është kryer, procesverbali i organit përmbartues në të cilin është konstatuar se veprimi i detyruar është kryer, konstatimi dhe mendimi i ekspertit nga i cili shihet se është kryer veprimi, etj. Në të kundërtën do të merret se veprimi nuk është kryer.

4. Në qoftë se veprimi të cilin mund ta kryejë vetëm debitori, nuk varet vetëm nga vullneti i tij (krijimi i veprës artistike muzikore, pamore, letrare, arkitektonike, etj.), atëherë kreditori nuk ka të drejtë ta kërktojë shpërbllimin nga paragrafi 1. i këtij neni, por vetëm të drejtën që të kërktojë shpërbllimin e dëmit të pësuar.

#### **Neni 294**

#### **Detyrimi për durim dhe mosveprim**

1. Në qoftë se debitori është i detyruar ta duroj kryerjen e ndonjë veprimi, ose të përmbahet nga kryerja e veprimit, organi përmbartues sipas propozimit të kreditorit që pretendon se debitori vepron në kundërshtim me detyrimin e tij, me aktvendim apo urdhër e urdhëron debitorin që të silltet në pajtim

me detyrimin që e ka dhe e kërcënon me gjobë në të holla. Gjobat do të zbatohen në rast të mos përbushjes së obligimeve në pajtim me nenet 15 dhe 16 të këtij ligji.

2. Kreditori mund t'i parashtojë Gjykatës propozim që debitorit t'i caktohet gjoba nga shkakun se ai përkundrejt urdhëresës së organit përmbarues ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me detyrimin e tij. Ky propozim mund të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga marrja e dijenisë për sjelljen e tillë të debitorit, por më së voni brenda afatit prej një viti nga shkelja e detyrimit.

3. Pas skadimit të afateve nga paragrafi 2 i këtij neni, organi përmbarues me aktvendim e refuzon propozimin për shqiptimin e gjobës në të holla dhe e pezullon procedurën, kurse kreditori e humbë të drejtën e paraqitjes së propozimit të ri për përmbarim, në bazë të të njëjtit dokument përmbarues.

4. Për procedurën e përmbarimit nga paragrafi 1. i këtij neni, përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e nenit 293 të këtij ligji.

#### **Neni 295** **Depozitimi i garancionit për shpërblimin e dëmit**

1. Organi përmbarues me propozimin e kreditorit do ta urdhërojë me aktvendim ose urdhër debitorin që të organi përmbarues ta depozitojë një shumë të hollash për shpërblimin e dëmit që mund ta pësojë kreditori me sjelljen e mëtejme të debitorit në kundërshtim me detyrimin për durim dhe mosveprim. Në këtë rast kreditori i përmbarimit duhet ta bëjë të besueshme mundësinë e pësimit të dëmit.

2. Kohëzgjatjen e garancionit e cakton organi përmbarues duke i marrë parasysh rrethanat e rastit konkret.

3. Në bazë të vendimit për depozitimin e garancionit, përmbarimi zbatohet me propozimin e kreditorit.

#### **Neni 296** **Përmbarimi me qëllim të rivendosjes së gjendjes së mëparshme**

1. Në qoftë se për shkak të sjelljeve të debitorit në kundërshtim me detyrimin nga dokumenti përmbarues është krijuar ndryshimi që nuk është në pajtim me të drejtat e kreditorit, organi përmbarues do ta autorizojë këtë të fundit me propozimin e tij që vetë ai, e në rast nevojë edhe me ndihmën e organi përmbarues, ta rivendosë gjendjen e mëparshme me shpenzimet e debitorit dhe në rrezikun e tij.

2. Sa i përket depozitimit të shumës së nevojshme për mbulimin e shpenzimeve që mund t'i shkaktojë rivendosja në gjendjen e mëparshme dhe caktimit të shumës definitive të tyre, zbatohen dispozitat për shpenzimet për përmbarimin e veprimit, të cilin përveç debitorit mund ta kryej edhe personi tjetër.

#### **Neni 297** **Ri-pengimi i posedimit**

1. Në qoftë se në bazë të dokumentit përmbarimor, të nxjerrë sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit, është kryer përmbarimi, apo në qoftë se debitori e ka përbushur vullnetarisht detyrimin e vet, kurse pas kësaj përsëri e bënë pengimin e posedimit i cili në esencë nuk dallohet nga pengimi i mëparshëm, organi përmbarues me propozimin e kërkuesit të përmbarimit, në bazë të dokumentit përmbarues të njëjtë, do të nxjerrë aktvendim të ri për përmbarimin apo urdhrin përmbarues, me qëllim të rivendosjes së gjendjes së mëparshme nëse kjo është e nevojshme dhe do të kërcënohet debitori me gjobitje nëse përsëri kryen pengim posedimi. Në këtë rast në mënyrë të përshtatur zbatohen edhe dispozitat e nenit 290 të këtij ligji.

2. Propozimin për përmbarimin nga paragrafi 1. i këtij neni, kërkuesi i përmbarimit mund ta parashtojë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita kur ka marrë dijeni për ri-pengimin e posedimit, por jo më vonë se brenda një (1) viti nga pengimi i përsëritur.

#### **Neni 298** **E drejta e shpërblimit të dëmit (zhdëmtimit)**

Me dispozitat e këtij kreu të ligjit, nuk preket e drejta e kreditorit që me padi të ngritur në procedurën kontestimore të kërkojë shpërblimin e dëmit që i është shkaktuar me sjelljet e debitorit në kundërshtim me detyrimin e tij të caktuar në dokumentin përmbarimor.

#### **KREU XIV**

### **PËRMBARIMI I VENDIMIT PËR NDARJEN E SENDEVE**

#### **Neni 299**

#### **Kompetenca territoriale në rastet e përmbarimit gjyqësor**

Për vendosje për propozimin për përmbarim dhe për zbatimin e përmbarimit në bazë të vendimit për ndarjen e sendeve, e kompetencës tokësore është Gjykata në territorin e së cilës ndodhet sendi në bashkëpronësi.

#### **Neni 300**

#### **Kompetenca në rast të përmbarimit nga ana e përmbaruesit privat**

Për vendosje për propozimin për përmbarim dhe për zbatimin e përmbarimit në bazë të vendimit për ndarjen e sendeve, përmbaruesi privat ka kompetencë për të vendosur mbi propozimin përmbarimor dhe për të zbatuar përmbarimin.

#### **Neni 301**

#### **Ndarja fizike e sendit**

1. Ndarjen fizike të sendit të përbashkët, organi përmbarues e cakton në qoftë se ndarja e tillë është parashikuar me dokumentin përmbarues.
2. Veprimet e posaçme për kryerjen e ndarjes fizike i zbaton sipas rrethanave të rastit organi përmbarues.
3. Organi përmbarues do t'i ftojë pjesëmarrësit e procedurës që të jenë të pranishëm me rastin e kryerjes së ndarjes fizike të sendit.
4. Në qoftë se e kërkon nevoja, organi përmbarues mund ta caktojë ekspertizën.

#### **Neni 302**

#### **Ndarja e sendit me anë të shitjes**

Në qoftë se në bazë të dokumentit përmbarues sendin e përbashkët duhet shitur me qëllim të ndarjes së tij, shitja do të bëhet në mënyrën e paraparë me Kreun 1 dhe 9 të Pjesës 2, të këtij ligji. Për çështjet e caktuara palët mund të merren vesh ndryshe.

#### **Neni 303**

#### **Caktimi i mënyrës së ndarjes**

1. Organi përmbarues vendosë sipas rregullave për raportet pronësore-juridike se a do ta bëjë ndarjen fizikisht, apo me anë të shitjes, po qe se me anë të dokumentit përmbarues, mënyra e ndarjes nuk është caktuar e as palët nuk janë marrë vesh për një gjë të tillë.
2. Ndarja do të bëhet me anë të shitjes së sendit të përbashkët, po qe se në procedurën përmbarimore konstatohet se ndarja fizike e paraparë me dokumentin përmbarues nuk është e mundur, apo se është e mundur por me zvogëlim të vlerës së sendit.

#### **Neni 304**

#### **Shpenzimet procedurale të përmbarimit**

1. Shpenzimet e zbatimit të përbarimit sipas dispozitave të këtij kreu, i heqin të gjithë bashkëpronarët në përpjesëtim me vlerën e pjesëve që u takojnë për sendin në bashkëpronësi të tyre.

2. Bashkëpronari që ka shkaktuar shpenzime të posaçme, ka për detyrë t'ua paguajë ato bashkëpronarëve që kanë pasur shpenzime të tilla.

## **KREU XV**

### **PËRMBARIMI ME QËLLIM MARRJEJE TË DEKLARATËS SË VULLNETIT**

#### **Neni 305 Kredia e pakushtëzuar**

1. Në qoftë se debitori me vendimin që e ka cilësinë e dokumentit përbarues, është detyruar për dhënien e deklaratës së vullnetit, konsiderohet se deklaratën me përmbajtje si në dokumentin përbarues e ka dhënë në momentin kur është bërë i formës së prerë vendimi i tillë.

2. Po qe se debitori ka marrë përsipër detyrimin për dhënien e deklaratës së vullnetit me ujdinë gjyqësore apo administrative, konsiderohet se deklaratën me përmbajtje si në ujdinë, e ka dhënë në momentin në të cilin është bërë i kërkueshëm detyrimi i tij sipas ujdisë së tillë.

#### **Neni 306 Kredia e kushtëzuar**

Në qoftë se përmbushja e kredisë për dhënien e deklaratës së vullnetit varet nga përmbushja e ndonjë detyrimi të kreditorit të përbarimit, apo nga ndonjë kusht tjetër, konsiderohet se debitori e ka dhënë deklaratën e vullnetit, në momentin në të cilin kreditori e ka përmbushur detyrimin e tij, apo në momentin në të cilin plotësohet kushti tjetër që provohet me dokumentin publik, apo me dokumentin e vërtetuar sipas ligjit.

## **KREU XVI**

### **PËRMBARIMI ME ANË TË REGJISTRIMIT TË DREJTAVE NË LIBRIN PUBLIK**

#### **Neni 307 Kompetenca territoriale në rastet e përbarimit gjyqësor**

1. Për vendosje mbi propozimin për përbarimin me qëllim të themelimit të drejtave në paluajtshmërinë me regjistrim në librin publik, si dhe për kalimin, kufizimin, ose shuarjen e të drejtës së regjistruar, e kompetencës territoriale është Gjykata në territorin e të cilës ndodhet organi që mbanë librin publik për paluajtshmëri.

2. Për zbatimin e përbarimit nga paragrafi 1. i këtij neni, është kompetente në pikëpamje territoriale Gjykata, apo organi që mban regjistrin publik për paluajtshmërinë e tillë.

#### **Neni 308 Kompetenca në rast të përbarimit nga ana e përbaruesit privat**

Për vendosje mbi propozimin për përbarimin me qëllim të themelimit të drejtave në paluajtshmërinë me regjistrim në librin publik, si dhe për kalimin, kufizimin, ose shuarjen e të drejtës së regjistruar, përbaruesi privat ka kompetence për të vendosur mbi propozimin përbarimor dhe për të zbatuar përbarimin.

#### **Neni 309 Mënyra e zbatimit të përbarimit**

1. Në bazë të dokumentit përmbaues të cilin është caktuar detyrimi i regjistrimit në librin publik, organi përmbaues urdhëron që në librin publik të bëhet regjistrimi përkatës.
2. Regjistrimi i caktuar me anë të aktvendimit për përmbaumin ose urdhrit përmbaues zbatohet sipas detyrës zyrtare.

#### **Neni 310**

#### **Regjistrimi i të drejtës së pronësisë kur debitori nuk është i regjistruar si pronar**

Kur debitori nuk është i regjistruar si pronar i paluajtshmërisë, regjistrimi i të drejtës së pronësisë të kreditorit për këtë paluajtshmëri mund të bëhet në qoftë se, kreditori bashkë me propozimin për përmbaumin parashtron provën konform rregullave për regjistrimin e të drejtave në paluajtshmëritë, e paraardhësit juridik i debitorit është personi që është i regjistruar si pronar.

#### **Neni 311**

#### **Regjistrimi i të drejtës tjetër sendore kur debitori nuk është i regjistruar si pronar**

Kur sipas dokumentit përmbaues kreditori është i autorizuar që kundrejt debitorit të kërkojë regjistrimin e të drejtës së pengut, apo të ndonjë të drejte tjetër sendore në paluajtshmërinë përveç të drejtës së pronësisë, kurse debitori nuk është i regjistruar si pronar i paluajtshmërisë, kreditori i përmbaimit mund të kërkojë me propozimin për përmbaumin, që e drejta e pronësisë të regjistrohet në emër të debitorit, e pastaj të bëhet regjistrimi i të drejtës së kreditorit, po qe se e paraqet provë, në pajtim me dispozitat për regjistrimin e të drejtave në paluajtshmëritë, nga e cila provë shihet se debitori e ka fituar të drejtën e pronësisë për paluajtshmërinë e këtillë.

### **KREU XVII**

### **PËRMBARIMI I VENDIMIT PËR KTHIMIN NË VENDIN E PUNËS**

#### **Neni 312**

#### **Kompetenca territoriale**

1. Për vendosje për propozimin për përmbaumin në bazë të dokumentit përmbaues, me të cilin punëdhënësi është urdhëruar që punëtorin ta kthejë në punë, apo që ta sistemoj në vendin përkatës të punës dhe për zbatimin e përmbaimit, e kompetencës territoriale është Gjykata në territorin e së cilës është krijuar marrëdhënia e punës.
2. Gjykata ka kompetenca ekskluzive për përmbaumin e vendimeve lidhur me kthimin e punëtorit dhe shërbyesve civil në punë.

#### **Neni 313**

#### **Afati për paraqitjen e propozimit për përmbaumin**

Propozimi për përmbaumin në bazë të dokumentit përmbaimit për kthim në vendin e punës, me të cilin punëdhënësi është urdhëruar që punëtorin ta kthejë në punë, mund të paraqitet brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh, nga dita kur vendimi është bërë i formës së prerë.

#### **Neni 314**

#### **Mënyra e zbatimit të përmbaimit**

1. Përmbaimit në bazë të dokumentit përmbaues sipas të cilit punëdhënësi është i detyruar që punëtorin ta kthejë në punë, apo që ta sistemoj në vendin përkatës të punës, zbatohet me anë të caktimit të gjobave në të holla kundër punëdhënësit dhe personit përgjegjës në të.
2. Dënimi me të holla caktohet sipas dispozitave të nenit 15 dhe 16 të këtij ligji dhe dispozitave për përmbaumin me qëllim të realizimit të kredisë për veprimin të cilin mund ta kryejë vetëm debitori.

**Neni 315**  
**Shpërblimi i pagës në rast të kthimit të punëtorit në punë**

1. Kreditori që e ka parashtruar propozimin për kthim në punë, ka të drejtë të kërkojë që Gjykata të nxjerrë aktvendim me të cilin do të caktojë se, debitori ka për detyrë që atij t'ia paguajë në emër të pagës shumëat mujore që janë bërë të kërkueshme, nga dita në të cilën ka marrë formë të prerë vendimi e deri në ditën e rikthimit në punë. Me të njëjtin aktvendim, Gjykata e cakton përmbarimin për realizimin e shumëve mujore të caktuara.

2. Kërkesa nga paragrafi 1. i këtij neni mund t'i bashkëngjitet propozimit për përmbarim, ose mund të paraqitet më vonë deri në përfundimin e procedurës së përmbarimit.

**Neni 316**  
**Efekti i aktvendimit për kompensim**

1. Aktvendimi i nxjerr sipas paragrafit 1. të nenit 315 të këtij ligji, e ka efektin e aktvendimit me të cilin vërtetohet ekzistimi i detyrimit të debitorit dhe efektin e aktvendimit për përmbarimin.

2. Debitori mund të propozojë që aktvendimi nga paragrafi 1. i këtij neni të shfuqizohet, po qe se pas nxjerrjes së tij kanë ndryshuar rrethanat në bazë të cilave është nxjerrë ai.

3. Kompensimi i pagës mujore caktohet në shumën që do ta realizonte punëtori po të ishte në punë.

**Neni 317**  
**Realizimi i kompensimit në procedurë të posaçme**

1. Propozuesi i përmbarimit rezervon të drejtën e tij për pagesë ose kompensimin e pagave mujore ose pagesave tjera përderisa ka qenë i papunësuar për shkak të një vendimi të paligjshëm të punëdhënësit për largimin e tij nga puna dhe mund të kërkojë që rasti i tij të trajtohet në procedurë kontestimore.

2. Në qoftë se Gjykata përmbarimore vetëm pjesërisht e ka miratuar kërkesën për pagimin e pagave mujore, atëherë ajo do ta udhëzojë kreditorin e përmbarimit që pjesën tjetër të kërkesës ta realizojë në procedurën gjyqësore kontestimore.

**KREU XVIII**

**PËRMBARIMI I VENDIMEVE NGA LËMI I SË DREJTËS FAMILJARE  
DORËZIMI DHE MARRJA E FËMIJËS**

**Neni 318**  
**Kompetenca territoriale**

1. Për të vendosur për propozimin për përmbarimin e vendimit të Gjykatës me të cilin urdhërohet dorëzimi i fëmijës prindit, apo personit tjetër, respektivisht institucionit të cilit i është besuar fëmija në ruajtje dhe edukim, është kompetente Gjykata e cila është e kompetencës së përgjithshme territoriale për palën që e kërkon përmbarimin, por edhe Gjykata në territorin e së cilës ndodhet fëmija.

2. Për zbatimin e përmbarimit, kompetente në pikëpamje territoriale është Gjykata në territorin e së cilës ndodhet fëmija në kohën e përmbarimit.

**Neni 319**  
**E drejta e paraqitjes së propozimit**

Propozimin për përmbarimin e vendimit mund ta paraqesë prindi, apo personi tjetër të cilit fëmija i është besuar në ruajtje dhe edukim, si dhe organi i kujdestarisë.

**Neni 320**  
**Mënyra e zbatimit të përmbarimit**

1. Me rastin e zbatimit të përmbarimit, Gjykata sidomos kujdeset për nevojën që të mbrohen interesat e fëmijës në masën më të madhe të mundshme.
2. Me aktvendimin për përmbarimin, Gjykata i cakton debitorit afat prej tri (3) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar aktvendimi, që fëmijën t'ia dorëzoj prindit, apo personit tjetër, respektivisht institucionit të cilit fëmija i është besuar në ruajtje dhe edukim, me kërcënim të shqiptimit të gjobës në të holla.
3. Gjoha në të holla shqiptohet dhe përmbarohet sipas dispozitave të këtij ligji, për kryerjen e veprimit që mund ta bëjë vetëm debitori.
4. Në qoftë se përmbarimi nuk ka mund të zbatohet me shqiptimin dhe përmbarimin e vendimit për gjobën në të holla, përmbarimi do të zbatohet me marrjen e fëmijës nga personi të i cili ndodhet fëmija dhe dorëzimin e fëmijës prindit, ose personit tjetër apo institucionit të cilit fëmija i është besuar për ruajtje dhe edukim.
5. Marrjen dhe dorëzimin e fëmijës sipas paragrafit 4. të këtij neni, mund ta bëjë vetëm Gjykatësi në bashkëpunim me psikologun e organit të kujdestarisë, të shkollës, këshillimores së familjes, apo të institucionit tjetër të specializuar për ndërmjetësim në marrëdhëniet familjare.

**Neni 321**  
**Vazhdimi i përmbarimit**

Gjykata me propozimin e palës të cilës i është besuar fëmija, e vazhdon ekzekutimin sipas të njëjtit aktvendim për përmbarimin, në qoftë se fëmija në afatin tre (3) mujor, nga dita e dorëzimit të fëmijës përsëri gjendet te personi nga i cili është marrë.

**Neni 322**  
**Marrja e fëmijës**

1. Përrjashtimisht nga dispozitat nga neni 320 të këtij ligji, në rastin në të cilin konstatohet se i është rrezikuar jeta, shëndeti, ose zhvillimi psikofizik i fëmijës, Gjykata do ta zbatojë përmbarimin pa caktuar paraprakisht afat për dorëzimin e fëmijës dhe pa shqiptuar gjoha gjyqësore, duke marrë fëmijën dhe duke ia dorëzuar prindit, apo personit tjetër, respektivisht institucionit të cilit fëmija i është besuar në ruajtje dhe edukim.
2. Ky përmbarim, zbatohet në bashkëpunim me organin e kujdestarisë, në mënyrën e rregulluar në paragrafin 4. dhe 5. neni 320 të këtij ligji.

**PJESA E TRETË**

**PËRMARUESI PRIVAT**

**KREU I**

**MANDATI DHE KOMPETENCAT**

**Neni 323**  
**Statusi dhe kompetencat e përmbaruesit privat**

1. Përmbaruesi privat për kryerjen e autorizimeve publike të besuara me këtë ligj emërohet nga Ministri i Drejtësisë (më tutje: Ministri) për territorin e Gjykatës themelore.

2. Përmbauesi privat është kompetent të ndërmarrë të gjitha veprimet të përcaktuara në nenin 341 të këtij ligji dhe veprime të tjera të lejuara apo përcaktuara për përmbauesin privat sipas këtij ligji, përveç kur shprehimisht ndalohen me këtë ligj.

3. Përmbauesi privat do të ndërmerr veprime për të zbatuar përmbarimin brenda territorit për të cilin është emëruar.

4. Me kërkesë të kreditorit, përmbauesi privat mund të ndërmarr veprime për zbatimin e përmbaimit edhe jashtë territorit për të cilin ai është emëruar, personalisht apo nëpërmes përmbauesit privat të territorit tjetër.

5. Organet e administratës shtetërore mundet t'i besojnë përmbauesit privat zbatimin e përmbaimit në procedurat të cilat aplikohen në bazë të vendimeve të këtyre organeve shtetërore, vetëm nëse parashihet ndryshe me ndonjë ligj të veçant.

6. Selia e përmbauesit privat do të jetë e vendosur brenda territorit të Gjykatës themelore për të cilin ai është emëruar.

#### **Neni 324** **Pa pajtueshmëria me kryerjen e veprimeve përmbaimore**

1. Kryerja e funksioneve, mbikëqyrëse apo menaxhues në subjektet komerciale, institucionet shtetërore, shërbimet financiare, çështjet komerciale dhe detyrat e noterisë dhe avokatisë është në mos pajtueshmëri me veprimet përmbaimore të përmbauesit privat.

2. Përmbauesi privat nuk mund të themeloje marrëdhënie pune me ndonjë subjekt shtetëror apo komercial.

3. Kufizimi i parashikuar në paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni nuk vlen për aktivitetet shkencore, teknike, artistike apo arsimore apo kryerjen e aktiviteteve në Odë dhe shoqatat ndërkombëtare të përmbauesve privat.

#### **Neni 325** **Përjashtimi**

1. Dispozitat e ligjit të procedurës kontestimore për përjashtimin e gjyqtarëve vlejnjë përshtatshmërisht edhe për përjashtimin e përmbauesve privat.

2. Gjyqtari i Gjykatës themelore brenda territorit të cilit është emëruar përmbauesi privat, vendos për kërkesën për përjashtim.

3. Nuk do të lejohet asnjë ankesë kundër aktvendimit i cili aprovon apo hedh poshtë një kërkesë për diskualifikimin e një zyrtari privat të përmbaimit.

4. Veprimet përmbaimore të përmbauesit privat të kryera në kundërshtim me paragrafin 1. të këtij neni do të abrogohen.

## **KREU II**

### **EMËRIMI DHE BETIMI**

#### **Neni 326** **Kushtet për emërimin e përmbauesit privat**

1. Përmbaues privat mund të emërohet personi i cili plotëson kushtet si në vijim:

1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;

1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar, dhe duhet të jetë i aftë në aspektin shëndetësor;



1.3. të jetë jurist i diplomuar në fakultetin juridik, apo të ndonjë fakulteti juridik të ndonjë vendi tjetër, pas nostrifikimit të diplomës në Republikën e Kosovës;

1.4. të ketë të kryer provimin e jurisprudencës;

1.5. të ketë së paku tri (3) vjet përvojë pune juridike;

1.6. të ketë dhënë provimin për përmbaues;

1.7. që kundër tij nuk zhvillohet procedurë hetimore për veprë penale, përkatësisht që nuk është i dënua për veprë penale me dënim me burg e cila veprë është e dënueshme më së paku gjashtë (6) muaj, apo për veprë penale e cila e bënë të padenjë në ushtrimin e punës së përmbauesit;

1.8. të paraqes deklaratë te noteri për gjendjen e tij material, me të gjitha pasojat nga dhënia e deklaratës së rrejtme.

2. Në qoftë se kundër kandidatit që ka dorëzua kërkesë për emërim për përmbaues është duke u zhvilluar procedurë penale, vendimi për emërim shtyhet deri sa të arrihet vendimi në procedurën penale.

### **Neni 327**

#### **Caktimi i numrit të përmbauesve privat**

1. Numrin e përmbauesve privat e cakton Ministri në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Për territorin e Gjykatës themelore një pozitë e përmbauesit privat, sipas rregullit, caktohet në njëzet e pesë mijë (25.000) banorë.

3. Numri i përmbauesve privat për territorin e Gjykatës themelore, mund të rritet derisa numri i përmbauesve privat të emëruar në secilin rajon të arrijë proporcionin e paraparë në paragrafin 2. të këtij neni.

4. Përjashtimisht nga paragrafi 2. i këtij neni, Ministri varësisht nga nevoja apo sipas kërkesës të Këshillit Gjyqësor të Kosovës ose Odës së përmbauesve cakton edhe numër më të madh të përmbauesve privat.

### **Neni 328**

#### **Procedura e emërimit të përmbauesit privat**

1. Ministri emëron përmbauesin privat në bazë të konkursit publik.

2. Ministria e Drejtësisë (më tutje: Ministria) shpall konkursin në së paku dy (2) gazeta ditore.

3. Afati kohor për konkurim nuk do të jetë më pak se tridhjetë (30) ditë nga data e shpalljes sipas paragrafit 2. të këtij neni. Kandidatet aplikacionit për konkurim duhet t'ia bashkangjesin dokumentacionin me të cilin vërtetohet se i plotësojnë kushtet nga neni 326 i këtij ligji.

4. Komisionin për vlerësimin e kandidateve (më tej Komisioni Vlerësues) e emëron Ministri, i cili përbëhet si në vijim:

4.1. një (1) gjyqtar nga Gjykata Supreme i propozuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës;

4.2. dy (2) përmbaues të propozuar nga Oda e Përmbauesve privat;

4.3. një (1) përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë i cili ka së paku dhjetë (10) vjet përvojë pune në fushën e drejtësisë;

4.4. një (1) profesor i rregullt i lëmis civile.

5. Për grupin e parë të përmbaruesve privat deri në themelimin e Odes së përmbaruesve privat, anëtarët nga nënparagrafi 4.2. i këtij neni do të zëvendësohen nga dy (2) gjyqtarë të propozuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

#### **Neni 329**

##### **Organizimi i vlerësimit të përmbaruesve dhe provimit**

1. Komisioni Vlerësues pas vlerësimit të aplikacioneve dhe dokumentacionit të kandidatëve do të përpilojë listën me propozime për emërimin e kandidatëve i cila i dorëzohet Ministrit.

2. Me rastin e përzgjedhjes në mes të më shumë kandidatëve posaçërisht do të merret parasysh rezultati i tyre në provimin për përmbarues privat.

3. Ministri nxjerr akt nënligjor për punën e Komisionit Vlerësues.

#### **Neni 330**

##### **Emërimi i përmbaruesve privat**

1. Ministri, brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të listës me propozime të kandidatëve merr vendim për emërimin e përmbaruesve privat .

2. Vendimi i ministrit për emërim i dërgohet përmbaruesit privat dhe publikohet ne faqen zyrtare të Ministrisë ky vendim nuk mund ti nënshtrohet ankimimit administrativ, kundër tij mundë të ngritët konflikt administrativ.

3. Ministri do të organizoj përsëritjen e provimit dhe procesit të emërimit brenda nëntë (9) muajve pas mbajtjes se provimit paraprak, nëse ka vende të zbrazëta të cilat janë shpallur më parë por kanë mbetur të paplotësuara ose të cilat kanë mbetur vakante gjate kësaj periudhe.

#### **Neni 331**

##### **Betimi dhe fillimi i ushtrimit të veprimtarisë të përmbaruesit privat**

1. Personi i emëruar si përmbarues privat e jep betimin para Ministrit, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e emërimit.

2. Teksti i betimit është si në vijim:

**„Beto hem se do të kryejë veprimet e përmbarimit me dinjitet, nderë dhe paanshmëri në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës dhe duke mbrojtur interesat e palëve”.**

3. Nëse përmbaruesi privat është i detyruar që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dhënia e betimit, ministrisë të ia dërgoj dëshmitë se i ka plotësuar kushtet e parapara në nenin 332 të këtij ligji.

4. Ditën e fillimit të ushtrimit të veprimtarisë përmbaruese e cakton Ministri dhe për këtë njoftohet përmbaruesi privat dhe Oda e Përmbaruesve.

#### **Neni 332**

##### **Kushtet që duhet plotësuar pas dhënies së betimit**

1. Pas dhënies së betimit, përmbaruesi privat:

1.1. lidh marrëveshje për sigurimin e dëmit i cili mund t'i shkaktohet palëve të treta gjatë shërbimit të tij;

1.2. lidh marrëveshjen për sigurimin e lokalit dhe objekteve të pranuar si depozitë në rastin e dëmtimit, shkatërrimit apo humbjes së tyre;

1.3. hap llogarinë e veçantë në njërin nga bankat komerciale, ku vetëm paratë e rasteve përbarimore do të depozitohen dhe do të shfrytëzohen ekskluzivisht për shlyerjen e borxheve ndaj kreditorëve;

1.4. siguron hapësirën për zyre në territorin e Gjykatës themelore ku do ta ketë selinë;

1.5. siguron pajisje të nevojshme për të zbatuar përbarimin;

1.6. duhet të ketë vulën katrore dhe vulën e rrumbullakët zyrtare;

1.7 duhet të depozitojë nënshkrimin dhe inicialet e tij në kuadër të Gjykatës themelore në rajonin në të cilin është emëruar. Në rast të ndërrimit të selisë jashtë territorit të Gjykatës themelore, pas emërimit si përbarues privat në vendin e ri, ai depoziton nënshkrimin dhe inicialet e tij në kuadër të regjistrin të Gjykatës themelore në territorin e së cilës është rivendosur. Në rast të shpërnguljes jashtë territorit të Gjykatës themelore, pas emërimit të përbaruesit privat, ai do të depozitojë nënshkrimin dhe inicialet me regjistrin e Gjykatës themelore në territorin ku ai është shpërngulur.

2. Ministri me akt nënligjor përcakton kushtet minimale teknike dhe të tjera përkitazi me pajisjen dhe zyre në kuadër të nënparagrafëve 1.4 dhe 1.5 të paragrafit 1. të këtij neni.

3. Konsiderohet se përbaruesi privat nuk është emëruar nëse:

3.1. refuzon dhënien e betimit;

3.2. pa shkaqe të arsyeshme nuk i përgjigjet thirrjes për dhënien e betimit;

3.3. në afatin nga paragrafi 3.neni 331 i këtij ligji nuk i dërgon provat për plotësimin e kushteve të parapara për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë apo,

3.4. nuk fillon me ushtrimin e veprimtarisë përbaruese në ditën që i është caktuar.

4. Për rastet e parapara në paragrafin 3. të këtij neni, ministri nxjerr vendim. Vendimi nuk mund të ankimohet në procedurë administrative, dhe kundër tij mund të ngritet konflikti administrativ.

### **Neni 333**

#### **Vulat dhe kartela identifikuese e përbaruesit privat**

1. Përbaruesi privat ka vulën zyrtare dhe të rrumbullakët (më tutje: vula). Mostra e certifikuar e vulës dhe nënshkrimi i certifikuar i përbaruesit privat do të vendoset në Ministri dhe Gjykatën themelore në territorin e së cilës përbaruesi privat është emëruar.

2. Vula përmban logon e Republikës së Kosovës, shenjën e përbarimit, emrin personal të përbaruesit privat dhe selinë e përbaruesit privat. Përbaruesi privat shfrytëzon vulat vetëm pas fillimit të detyrës si përbarues privat dhe vetëm për veprimet për të cilat përbaruesi privat i ka ndërmarrë në kuadër të aktivitetit të tij ligjor.

3. Përbaruesi privat, zëvendësuesi i përbaruesit privat dhe zëvendësi i tij kanë kartelën identifikuese të përbarimit të lëshuar nga Ministria. Përbaruesi privat, zëvendësuesi i përbaruesit privat dhe zëvendësi shfrytëzojnë kartelën pas fillimit të detyrës dhe shfaqin kartelën gjatë kryerjes së veprimeve të përbarimit.

4. Forma dhe përmbajtja e kartelës identifikuese të përbaruesit privat përcaktohet me akt nënligjor nga Ministri.

### **Neni 334**

#### **Regjistrimi në regjistrin e përbaruesve privat**

1. Me ditën e fillimit të ushtrimit të veprimtarisë përmbarese kryhet regjistrimi i përmbaresit privat, zëvendësuesit të përmbaresit privat dhe zëvendës përmbaresit privat në regjistrin e përmbaresve privat, në bazë të njoftimit dhe dëshmime nga neni 332 i këtij ligji.
2. Të dhënat për regjistrim dhe fillim të ushtrimit të veprimtarisë përmbarese, ministria i shpallë në faqen zyrtare të Ministrisë dhe në faqen zyrtare të Odes së Përmbaresve privat.
3. Përmbaresi privat nuk mundë të filloj ushtrimin e veprimtarisë përmbarese para ditës që është caktuar si ditë e fillimit të kryerjes së veprimtarisë përmbarese.
4. Regjistri i përmbaresve privat përmban këto të dhëna:
  - 4.1. numrin rendor të regjistrimit;
  - 4.2. emrin personal dhe datën e lindjes të përmbaresit privat;
  - 4.3. numrin personal;
  - 4.4. territorin e Gjykatës për të cilën është emëruar, selinë zyrtare dhe adresën;
  - 4.5. numrin dhe datën e vendimit për emërim;
  - 4.6. datën e dhënies së betimit;
  - 4.7. data e fillimit të ushtrimit të veprimtarisë përmbarese;
  - 4.8. masat disiplinore të cilat i janë shqiptuar përmbaresit privat;
5. Të dhënat nga paragrafi 4. i këtij neni regjistrohen edhe për zëvendësuesin dhe zëvendësin e përmbaresit privat, përveç të dhënave për territorin e Gjykatës për të cilën është emëruar dhe selinë zyrtare.
6. Përmbaresi privat, zëvendësuesi apo zëvendësi i përmbaresit privat njofton në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh ministrinë dhe odën për ndryshimet e të dhënave në evidencën zyrtare.

### **KREU III**

#### **PROVIMI PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**

##### **Neni 335**

##### **Kushtet dhe Organizimi i provimit të përmbaresit**

1. Provimi për përmbares privat mundë ta japë personi i cili është jurist i diplomuar në fakultetin juridik, sipas programit katër vjeçar ose studimet master, dhe të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune juridike.
2. Provimi për përmbares privat jepet në pajtim me aktin nënligjor për mënyrën dhe programin e dhënies së provimit për përmbares privat i nxjerrë nga ministri.
3. Aplikacioni për dhënien e provimit për përmbares privat me dëshmitë për plotësimin e kushteve nga paragrafi 1. i këtij neni i dorëzohet ministrisë. Ministri nxjerr vendim me të cilin lejohet dhënia e provimit të përmbaresit privat, personi i cili plotëson kushtet e përcaktuara me ligj.
4. Pas dhënies së provimit, përmbaresit privat i lëshohet certifikata e nënshkruar nga Ministri.
5. Ministria mban evidencat për personat të cilët kanë dhënë provimin e përmbaresit privat.

##### **Neni 336**

### **Komisioni për dhënien e provimit të përbaruesit**

1. Provimi për përbaruesit privat jepet para Komisionit për dhënien e provimit për përbarues privat (më tutje: Komisioni për provim).
2. Përbërja e Komisionit për provim përcaktohet nga ministri me vendim.
3. Për punën në Komisionin për provim, kryetari, anëtarët e komisionit dhe sekretari i komisionit kanë të drejtë për kompensim në shumën e caktuar nga ministri.

## **KREU IV**

### **TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E PËRMBARUESIT PRIVAT**

#### **Neni 337 Pavarësia**

1. Përbaruesi privat është i pavarur dhe kryen funksionet vetëm në pajtim me ligjin.
2. Në rast se përbaruesi privat arrestohet apo akuzohet si i pandehur për veprë penale të karakterit të përgjithshëm, Ministri i Drejtësisë dhe Këshilli i Odës njoftohen.

#### **Neni 338 Partneriteti i përbaruesit privat**

1. Kompani partneriteti të përbaruesve privat mund të themelojnë vetëm përbaruesit privat për të mundësuar zhvillimin e afarizmit sipas kushteve dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
2. Përbaruesit privat në partneritet sipas paragrafit 1. të këtij neni mbajnë evidencë të përbashkët dhe individuale.

#### **Neni 339 Kryerja e veprimeve përbarimore**

1. Përbaruesi privat është përgjegjës për kryerjen e veprimeve përbarimore në pajtim me dispozitat e këtij ligji.
2. Përbaruesi privat kryen veprimet përbarimore dhe në bazë të autorizimeve të tij edhe zëvendësi i përbaruesit privat apo i punësuarit i tij. Personat e autorizuar nga përbaruesi privat veprojnë në emër dhe për llogari të përbaruesit privat.
3. Përbaruesi privat, sipas nevojës, për disa veprime të përbarimit, mund të angazhojë palën e tretë që t'i ndihmojë në këto veprime.
4. Përbaruesi privat është përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga personat e përmendur në paragrafin 2. dhe 3. të këtij neni gjatë kryerjes së veprimeve të caktuara përbarimore.
5. Të punësuarit e përbaruesit privat janë të obliguar që të mbajnë sekretin zyrtar nën kushtet të cilat vlejné edhe për përbaruesin privat.
6. Ministri me akt nënligjor përcakton formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së shënimeve dhe evidencës për propozimet e pranuar për përbarim.

#### **Neni 340 Obligimet për përbarim**

1. Përmbareuesi privat ka detyrim që të kryej obligimet zyrtare për të cilat është i autorizuar në territorin e Gjykatës themelore për të cilin është emëruar përveç në qoftë se :

1.1 .ekzistojnë arsyet për përjashtim;

1.2. propozuesi përmbareues nuk paguan avansin për kryerjen e detyrave zyrtare siç kërkohet nga përmbareuesi privat në bazë të këtij ligji.

2. Nëse linden rrethana siç janë të përshkruara në paragrafin 1. të këtij neni, përmbareuesi privat, përderisa kjo bie në kompetencat e tij, ndërmerr masat e nevojshme për të siguruar që veprimet përmbareuese mund të kryhen në nivel lokal nëse kjo kërkohet. Për këtë, përmbareuesi privat mund të kërkojë nga Ministri që të emërojë zëvendësuesin e përmbareuesit privat. Ai mund të rekomandojë zëvendësuesin e përmbareuesit privat.

3. Nëse përmbareuesi privat ka qenë i penguar të kryej detyrat sipas mandatit të tij për më shumë se tridhjetë (30) ditë, ai do të informojë për këtë Ministrin duke deklaruar masat të cilat ai i ka ndërmarrë që janë referuar në paragrafin 2. të këtij neni.

### **Neni 341** **Detyrat e përmbareuesit privat**

1. Përmbareuesi privat në procedurën e caktimit dhe të zbatimit të përmbareimit, në pajtim me dispozitat dhe kufizimet e parapara me këtë ligj:

1.1. nxjerrë urdhër për përmbareim dhe zbaton përmbareimin në pajtim me autorizimet e tij;

1.2. pranon dhe vepron sipas propozimeve për përmbareim të kërkesave dhe të propozimeve për zbatim të përmbareimit të kërkesave dhe cakton mënyrën e përmbareimit nëse kreditori nuk e ka caktuar në propozim;

1.3. të dorëzojë urdhra, akte, dhe shkresa;

1.4. Të identifikojë palët dhe pjesëmarrësit në procedurën përmbareimore;

1.5. të mbledh të dhëna për gjendjen pasurore të debitorit;

1.6. të nxjerr konkluzione, përpilojë procesverbale, kërkesa dhe të dhëna tjera zyrtare në pajtim me autorizimet e parashikuara me këtë ligj;

1.7. të kryejë regjistrimin, vlerësimin e pronës, sekuestrimin dhe shitjen e pasurisë së luajtshme dhe të drejtave mbi pasurinë e paluajtshme;

1.8. të pranojë dhe ruajë pasurinë e regjistruar dhe të siguruar të debitorit, urdhërojë transferin e pronësisë dhe kryejë ndarjen e pasurisë dhe mjetet tjera monetare të realizuara me shitjen e pasurisë;

1.9. të kryejë zhvendosjen dhe veprimet tjera përmbareimore për qëllime të përmbareimit në pajtim me këtë ligj dhe aktet nënligjore;

1.10. sipas kërkesës së debitorit apo kreditorit, përmbareuesi privat ndërmjetëson ndërmjet tyre për qëllime të arritjes së marrëveshjes;

1.11. të pranojë dhe transferoj mjete monetare në pajtim me këtë ligj;

1.12. të mbajë evidence të rasteve në të cilat ai vepron në pajtim me formën e përcaktuar nga Ministri;

1.13. të ndërmarrë veprime të tjera siç parashikohet me këtë ligj te nxjerra ne zbatim te këtij ligji.

**Neni 342**  
**Mbrojtja e të drejtave të debitorit**

1. Gjatë përbarimit të kërkesave, përbaruesi privat i përmbahet këtij ligji, vendimeve gjyqësore dhe kërkesave të parashikuara në aktvendimin për përbarim duke u kufizuar në përbarimin e veçantë të instrumenteve dhe objekteve të caktuara.
2. Gjate zbatimit të përbarimit duhet pasur kujdes për mbrojtjen e dinjitetit të personalitetit të debitorëve, dhe përbarimi duhet të jetë sa më i përballueshëm për debitorin.
3. Menjëherë pas përfundimit të veprimeve të përbarimit apo aktivitetit që ka të bëjë me sigurimin e kërkesës, përbaruesi privat evidenton aktivitetet e përbarimit që i referohen nenit 349 të këtij ligji.

**Neni 343**  
**Mbrojtja e të dhënave**

1. Dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të dhënave personale janë gjithashtu të aplikueshme për përbaruesit privat.
2. Përbaruesi privat duhet të mënjanojë që të procedojë të dhënat që nuk janë të nevojshme për këtë arsye.
3. Përbaruesi privat mban të fshehta të dhënat në të cilat ai ka qasje gjatë kryerjes së detyrës së tij dhe nuk mund t'i përdor ato për përfitim personal apo të personave tjerë.
4. Detyra e referuar në paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni vlen edhe pas ndërprerjes së punës si përbarues.
5. Përbaruesit privat duhet të bartin përgjegjësi për ruajtjen e konfidencialitetit kur hasin në informatat sekrete, konfidenciale apo të ndjeshme gjatë procedurës përbarimore. Në rast të shkeljes së kësaj përgjegjësie, aplikohen masat e përgjegjësisë disiplinore së bashku me sanksionet civile dhe penale.

**Neni 344**  
**Aktivitetet plotësuese**

1. Përbaruesi privat mund të kryen aktivitetet tjera përpos atyre të referuara në nenin 340 vetëm nëse ato nuk ndikojnë apo pengojnë në kryerjen e duhur apo të pavarur të zyrës së tij apo në reputacionin e tij.
2. Përkitazi me interesat e referuara në paragrafin 1. të këtij neni Ministri mund të nxjerr akt nënligjor përkitazi me kryerjen e aktiviteteve të caktuara.
3. Me akt nënligjor të Ministrit, mund të ndalohen aktivitetet e caktuara të përbaruesit përveç:
  - 3.1. mbledhjen e parave për palët e treta;
  - 3.2. bërjen e inventarit dhe vlerësimeve;
  - 3.3. përpilimin e deklaratës me shkrim përkitazi me faktet materiale të vërejtura nga përbaruesi privat personalisht.

**Neni 345**  
**Qasja në të dhëna**

Organet e administratës publike, organet e qeverisë qendrore dhe organet tjera në vartësi të tyre, bankat, ndërmarrësit dhe personat tjerë juridik janë të obliguar që pas kërkesës së përbaruesit privat të sigurojnë qasjen në të dhënat të cilat janë të nevojshme për kryerjen e veprimeve përbarimore.

**Neni 346**  
**Bashkëpunimi**

1. Në ushtrimin e autorizimeve të tij, përmbaruesi privat mundet të kërkojë bashkëpunim nga organet shtetërore, zyrtarët dhe organizatat, të cilat janë të obliguara ta ofrojnë këtë.

2. Organet e policisë janë të obliguara që menjëherë të ofrojnë bashkëpunim për përmbaruesin privat në çdo rast që ai e konsideron të domosdoshëm në realizimin e funksioneve të tij. Përmbaruesi mund të paraqes një kërkesë të tillë në rast se ka pengesa gjatë zbatimit të funksioneve të tij, por policia nuk ka të drejtë të refuzojë kërkesën për bashkëpunim dhe ndihmë nga ana e përmbaruesit.

**Neni 347**  
**Përgjegjësia për dëmet**

1. Përmbaruesi privat është përgjegjës për dëmet e shkaktuara gjatë kryerjes së veprimeve përmbarimore, edhe si rrjedhojë e neglizhencës së tij apo neglizhencës së personave që punojnë nën përgjegjësinë e tij siç përmendet në nenin 338 të këtij ligji.

2. Përmbaruesi privat siguron vetën për periudhën e aktivitetit të tij dhe për periudhë jo më pak se tre (3) vjeçare pas transferit, revokimit apo pensionimit nga profesioni kundrejt dëmeve të cilat mund të rezultojnë nga mosplotësimi i detyrave të tij apo të atyre të cilët punojnë nën përgjegjësinë e tij siç përmendet në nenin 338 të këtij ligji.

3. Shuma minimale për sigurim për të cilën përmbaruesi privat duhet doemos të lidhë marrëveshje për sigurim për dëmet të cilat përmbaruesi privat mund t'iu shkaktojë kreditorit, debitorit palëve të treta apo personave të tjerë gjatë shërbimit të tij, është njëqind mijë (100.000) euro ose dhjetë përqind (10%) nga vlera e përgjithshme e vendimeve të regjistruara por të pa përfunduara në zyrën e tij.

**KREU V**

**MIRËMBAJTJA E EVIDENCAVE AFARISTE**

**Neni 348**  
**Arkivi zyrtar**

1. Përmbaruesi privat është i detyruar të mbaj evidencën e të gjitha propozimeve të pranuar për caktimin dhe zbatimin e përmbarimit dhe të kërkesave tjera.

2. Përmbaruesi privat duhet të mbajë evidence për rastet e pranuar dhe ato të përfunduara, në arkivin zyrtar. Evidenca përfshin të dhënat si në vijim:

- 2.1. emrin e Gjykatës e cila urdhëron përmbarimin ose sigurimin e kërkesës;
- 2.2. numrin e lëndës përmbarimore;
- 2.3. numrin e objektit të përmbarimit apo objektin në bazë të cilit sigurohet kërkesa;
- 2.4. të dhënat për kreditorin dhe debitorin të cilat janë të deklaruara në aktvendimin për përmbarim;
- 2.5. data e pranimit të kërkesës për përmbarim dhe për mbledhjen e borxhit;
- 2.6. data e vendimit për caktimin në detyrë të përmbaruesit privat dhe data e pranimit të këtij vendimi;
- 2.7. objekti dhe mjeti i përmbarimit nëse të dhënat e tilla munden të gjinden në aktvendimin për përmbarim;



- 2.8. shuma që kërkohet;
- 2.9. vendimet të cilat i merr gjatë përbarimit;
- 2.10. shuma e borxhit të mbledhur;
- 2.11. koha dhe rezultati i përbarimit të kryer;
- 2.12. të dhënat për personat nga të cilat janë mbledhur borxhet dhe shuma e borxhit të mbledhur;
- 2.13. shuma përfundimtare e shpërblimit dhe kompensimit të shpenzimeve nga përbaruesi privat;
- 2.14. numri i përgjithshëm i lëndëve në nivelin vjetor, në të cilat përbaruesi privat ka vepruar.

3. Të dhënat e përmendura në paragrafin 1. të këtij neni konsiderohen të dhëna publike dhe formojnë arkivin zyrtar të përbaruesit privat.

4. Me akt nënligjor të cilin e nxjerr Ministri më persë afërmi rregullohet mënyra e mbajtjes së evidencës nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni, mënyra e qasjes në evidencë dhe veprimi me evidencë në rast vdekje, shkarkimit apo të pushimit të ushtrimit të veprimtarisë së përbaruesit privat.

#### **Neni 349** **Afarizmi dhe të dhënat personale**

1. Përbaruesi privat do të mban të dhënat për punën e tij dhe për asetet e afarizmit të tij. Këto të dhëna gjatë gjithë kohës tregojnë të drejtat dhe detyrimet e tij.

2. Përbaruesi privat gjithashtu mban të dhënat për asetet e tij personale, gjithashtu duke përfshirë këtu edhe pasurinë e përbashkët sipas martesës ose ate të cilën e ka lidhur me një partneritetit të regjistruar. Çdo vit përbaruesi privat përpilon bilancin e gjendjes sa i përket aseteve të biznesit të tij dhe aseteve të tij personale gjithashtu edhe bilancin e gjendjes së biznesit të tij duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet.

3. Të dhënat përkitazi me punën e tij të referuar në paragrafin 1. që ndërlidhet me aktet zyrtare si dhe aktivitetet tjera që referohen në nenin 344 të këtij ligji të cilat zhvillohen nga përbaruesi privat.

4. Kushtet dhe procedura përkitazi me mënyrën me të cilën të dhënat e biznesit dhe ato personale aranzhohen dhe mbahen do të specifikohen me aktin nënligjor të Ministrisë të nxjerrë pas marrjes së mendimit nga Oda.

#### **Neni 350** **Detyrat përkitazi me menaxhimin dhe mbajtjen e mjeteve monetare**

1. Përbaruesi privat mban së paku një llogari bankare e cila do të shfrytëzohet ekskluzivisht për depozitat monetare që rezultojnë nga procedurat e përbarimit.

2. Paratë që i besohen përbaruesit privat në lidhje me punën e tij për palët e treta paguhen në këtë llogari. Nëse këto para paguhen në ndonjë llogari tjetër të përbaruesit privat gabimisht ose nëse paratë janë paguar gabimisht në një llogari të posaçme, përbaruesi privat paguan këto para në llogarinë e saktë pa vonesë. E njëjta vlen edhe nëse paratë i jepen përbaruesit privat drejtpërdrejt. Përbaruesi privat deklaron numrin e llogarisë së posaçme në dokumentin e tij.

3. Përbaruesi privat është ekskluzivisht i autorizuar për të administruar dhe disponuar me llogarinë e posaçme. Ai mundet t'i jep autorizim personit i cili punon nën përgjegjësinë e tij.

4. Përmbareusi privat plotëson menjëherë deficitin në bilancin e llogarisë së posaçme dhe është përgjegjës për deficitin e tillë përpos nëse mundet të demonstrojë se ai nuk duhet fajësuar për deficitin.
5. E drejta e të gjithë parashtruesve të kërkesës mjetet e të cilëve gjinden në këtë llogari llogariten proporcionalisht deri në shumën e paguar në këtë llogari të posaçme për dobinë e tij.
6. Për shkak se nuk buron ndryshe nga natyra e kësaj të drejte, parashtruesi i kërkesës tërë kohën ka të drejtë në pagesën e pjesës së tij në llogari të bilancit të kësaj llogarie të posaçme.
7. Nëse shuma e gjendur në këtë llogari të posaçme është joadekuate për të paguar shumën për pjesët e secilit kreditor valid , përmbareusi privat mundet të i paguajë kreditorin valid vetëm atë shumë që e lejojnë të drejtat e kreditorëve të tjerë valid. Në këtë rast shuma (bilanci) do të shpërndahet ndërmjet parashtruesve të kërkesës proporcionalisht sipas pjesës që i takon secilit duke marrë parasysh se nëse përmbareusi privat është vetë parashtrues i drejtë i kërkesës, atij i ndahet shuma e cila ka mbetur pasi të gjithë kreditorët valid të kenë pranuar pjesën në të cilën kanë të drejtë.
8. Mjetet të cilat mbahen në llogarinë e posaçme mundet të mos jenë objekt i konfiskimit për qëllime të shlyerjes së borxheve të përmbareus privat. Nëse urdhri për mbledhjen e borxhit është nxjerrë kundër agjentit gjyqësor për pjesën e kreditorit valid në llogarinë e posaçme, agjenti gjyqësor i cili e ka bërë deklaratën në pajtim me dispozitat e ligjit për përmbareim, mundet të paguajë kreditorin në pajtim me deklaratën apo urdhrin pa pasur nevojë të udhëzohet nga kreditori për një gjë të tillë.
9. Me akt nënligjor të cilin e nxjerrë Ministri rregullohet mënyra e llogaritjes, shuma më e ulët nën të cilën nuk mund të paguhet interesi dhe pagesa e interesit për paratë e paguara në llogarinë e posaçme. Interesi nuk do të paguhet më i ulët se shuma e përcaktuar nga Ministri.
10. Përmbareusi privat gjithashtu mban llogari të veçanta për shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve si dhe për çfarëdo mjete tjera nga aktivitetet shtesë të cilat janë të përcaktuara shkruara në këtë nen dhe nenin 344 të këtij ligji.
11. Nëse disa përmbareus punojnë së bashku në partneritet, llogaria e posaçme mundet të mbahet në emra të përbashkët të këtyre përmbareusve privat, partneritetit apo kompanisë.
12. Përmbareusi privat do të transferojë të kreditorit të gjitha fondet e pranuar nga debitori në afat prej tre (3) ditësh nga dita e pranimit.

#### **Neni 351**

#### **Aftësimi profesional i përmbareusit privat**

1. Përmbareusi privat, zëvendësuesi apo zëvendës përmbareusi privat janë të obliguar që të vijojnë aftësimin profesional.
2. Oda mban evidencën e seminareve dhe formave të tjera të aftësimit profesional të përmbareusit privat dhe i raporton Ministrin.

### **KREU VI**

#### **PASQYRA E SHPENZIMEVE**

#### **Neni 352**

#### **Kompensimi për veprimet e përmbareimit**

1. Përmbareusi privat ka të drejtë për shpërblim të punës së tij apo kompensim të shpenzimeve të shkaktuara në lidhje me punën e tij në pajtim me tarifën për shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për përmbareus privat.

2. Tarifat për përmbauesit, metoda e llogaritjes dhe shuma e shpërblimit dhe shpenzimet tjera që ndërlidhen me procedurën e cila është në zhvillim e sipër dhe transferi i rasteve dhe të dhënave nga përmbauesi privat i shkarkuar tek përmbauesi privat tjetër, përcaktohet nga Ministri me propozim të Odës dhe në konsultim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

3. Debitori nuk është përgjegjës për çfarëdo kompensimi ose pagese të shpenzimeve përmbauesit privat nëse ato tejkalojnë shumat e definuar me tarifa.

### **Neni 353**

#### **Shpenzimet e shkaktuara nga përmbauesi privat**

1. Shpenzimet e përmbauesit privat të shkaktuara në lidhje me procedurën e përmbaimit konsiderohen si shpenzime të kësaj procedure.

2. Përmbauesi privat përpilon pasqyrën e shpenzimeve përkitazi me rastin i cili i është besuar e cila tregon qartë se si janë llogaritur shpenzimet e ngarkuara dhe nëse ato ndërlidhen me aktet zyrtare apo aktivitetet tjera të referuara në nenin 344 të këtij ligji

## **KREU VII**

### **ZËVENDËSUESI DHE ZËVENDËSI I PËRMBARUESIT PRIVAT**

#### **Neni 354**

##### **Zëvendësuesi i përmbauesit privat**

1. Zëvendësuesi i përmbauesit privat (më tutje: zëvendësuesi) zëvendëson përmbauesin privat kur ai pengohet në kryerjen e veprimeve përmbaimore për shkak të sëmundjes, mungesës apo revokimit të përkohshëm të drejtës për ushtrimin e profesionit.

2. Personat si në vijim mund të emërohen si zëvendësues të përmbauesit privat:

2.1. përmbauesi privat;

2.2. personi i cili plotëson kushtet për emërimin si përmbaues privat siç përmendet në nenin 326 të këtij ligji, me përjashtim të kërkesave sipas paragrafit 1. të këtij neni.

3. Ministri me vendim emëron zëvendësuesin e përmbauesit privat. Vendimi i ministrit për emërimin e zëvendësuesit të përmbauesit privat është përfundimtar. Personi nga paragrafi. 2., i cili emërohet si zëvendësues i përmbauesit privat për herë të parë jep betimin para ministrit.

4. Mandati i zëvendësuesit përfundon:

4.1. pas kthimit të përmbauesit privat për të cilin ka qenë zëvendësues;

4.2. pas skadimit të mandatit për të cilin është zgjedhur si zëvendësues;

4.3. pas shkarkimit nga ministri.

#### **Neni 355**

##### **Të drejtat dhe detyrat e zëvendësuesit të përmbauesit privat**

1. Personi i emëruar si zëvendësues i përmbauesit privat ka të njëjtat të drejta, detyra dhe përgjegjësi sikur përmbauesi privat. Dispozitat e këtij ligji në lidhje me paraqitjen, imazhin dhe përmbajtjen e legjislacionit, kryerjen e detyrës, përgjegjësi dhe masave disiplinore të përmbauesit privat, mos pajtueshmërisë me veprimet përmbaimore, kontrollin e punës së përmbauesit privat dhe shkarkimin nga detyra të përmbauesit privat vlejné në mënyrë të njëjtë edhe për zëvendësuesin e përmbauesit privat.

2. Zëvendësuesi i përmbauesit privat është i autorizuar të përmbarojë kërkesën për zbatimin e e akteve zyrtare të adresuara për përmbauesin privat që zëvendësohet. Ai informon kreditorin për zëvendësimin.

3. Përmbauesi privat i cili duhet zëvendësuar i jep zëvendësuesit të përmbauesit privat qasjen në të dhënat e tij siç kërkohet për zëvendësimin.

4. Në rast të zëvendësimit për shkak të vdekjes, sëmundjes apo mungesës së përmbauesit privat, zëvendësuesi mundet të vazhdojë me dorëzimin e të dhënave të përmbauesit privat gjë e cila është objekt i marrëveshjes me këtë të fundit.

5. Pas skadimit të zëvendësimit, paragrafi 3. vlen përshtatshmërisht edhe për ish zëvendësuesin e përmbauesit privat përkitazi me përmbauesin privat të zëvendësuar.

6. Gjatë kryerjes së detyrave zyrtare zëvendësuesi i përmbauesit privat e deklaron kapacitetin e vet veprues. Në rast të shkarkimit nga detyra ai nuk përmend vetëm emrin e tij por edhe emrin dhe vendin e ushtrimit të praktikës së përmbauesit privat të cilin e zëvendëson.

### **Neni 356** **Zëvendës përmbauesi privat**

1. Përmbauesi privat nuk mund të ketë më shumë se dy (2) zëvendës përmbaues.

2. Personi i cili plotëson kushtet e parashikuara me këtë ligj për emërimin si përmbaues privat mundet të emërohet në detyrën e zëvendësimit të përmbauesit privat.

3. Zëvendësi i përmbauesit privat (më tutje: zëvendësi) zëvendëson përmbauesin privat, në baza ditore, kur ai pengohet gjatë kryerjes së veprimeve përmbaimore për shkak të sëmundjes, festave apo mungesës së përkohshme.

4. Gjatë veprimit në procedurën e përmbaimit dhe sigurimit të kërkesës, zëvendës përmbauesi privat përdor logon dhe vulën e përmbauesit privat për të cilin vepron.

5. Gjatë veprimit në procedurën e përmbaimit dhe sigurimit të kërkesës zëvendës përmbauesi privat e nxjerr kartelën e tij identifikuese dhe shenjës dalluese me emër dhe titull "zëvendësi i përmbauesit privat".

6. Personi i emëruar si zëvendës i përmbauesit privat ka të njëjtat të drejta, detyra dhe përgjegjësi si përmbauesi privat.

7. Përmbauesi privat është përgjegjës për punën e zëvendësimit të përmbauesit privat dhe në mënyrë solidarë është përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga puna e zëvendës përmbauesit privat.

8. Dispozitat e këtij ligji përkitazi me paraqitjen, imazhin, përmbajtjen e legjislacionit, kryerjen e detyrës, përgjegjësitë dhe masave disiplinore të përmbauesit privat, mos pajtueshmërisë me veprimet përmbaimore, kontrollin e punës së përmbauesit privat dhe shkarkimin nga detyra të përmbauesit privat vlej në mënyrë të njëjtë edhe për zëvendës përmbauesin privat.

9. Ministria përcakton me një akt të posaçëm mandatin valid dhe numrin e zëvendës përmbauesve privat të cilët do të punojnë në të njëjtën kohë nën përgjegjësinë e një përmbauesi privat.

### **Neni 357** **Emërimi i zëvendës përmbauesit privat**

1. Ministri me vendim emëron zëvendësin e përmbauesit privat me propozim të përmbauesit privat.

2. Vendimi i Ministrit për emërimin e zëvendës përmbauesit privat është përfundimtar.

3. Personi i emëruar si zëvendës i përmbauesit privat merr përsipër detyrën e tij në ditën kur ai jep betimin para ministrit. Betimi do të jetë si në vijim:

**“Beto hem se do të respektojë ligjet e Kosovës dhe do të kryejë detyrën e zëvendësit të përmbauesit privat me ndërgjegje, në mënyrë të drejtë dhe te paanshme”.**

**Neni 358**  
**Përfundimi i mandatit si zëvendës përmbaues**

1. Mandati i zëvendës përmbauesit privat përfundon me:

- 1.1. njoftimin me shkrim nga ana e përmbauesit privat dërguar ministrit dhe zëvendësit të tij se përmbauesi privat tërheq përzgjedhjen e bërë për zëvendësin;
- 1.2. lirim nga detyra apo vdekjen e përmbauesit privat që ka caktuar zëvendësin;
- 1.3. tërheqjen e miratimit apo skadimin e mandatit për të cilin është dhënë emërimi;
- 1.4. emërimin e zëvendës përmbauesit privat si përmbaues privat.

**KREU VIII**

**MBIKQYRJA**

**Neni 359**  
**Kontrolli ndaj punës së përmbauesve privat**

1. Mbikëqyrjen ndaj ligjshmërisë së punës së përmbauesit privat dhe të Odës e kryen Ministria nëpërmjet të personave të autorizuar (inspektorëve) të Ministrisë, sipas detyrës zyrtare apo me propozimin e Kryetarit të Gjykatës kompetente për territorin e së cilës është emëruar përmbauesi privat, Kryetarit të Odës, si dhe me iniciativën e palëve dhe të pjesëmarrësve në procedurë.

2. Ministria është e autorizuar të:

- 2.1. bëjë shikimin në librat afarist, evidencën, shkresat dhe të sendeve të magazinuara;
- 2.2. kërkoj nga përmbauesi publik të gjitha të dhënat e nevojshme për afarizmin e tij;
- 2.3. marrin nga organet kompetente dhe organizatat të dhëna për afarizmin e përmbauesve privat;
- 2.4. iniciojnë procedurën disiplinore kundër përmbauesit publik apo zëvendësuesit të përmbauesit publik.

3. Në kuadër të kryerjes së mbikëqyrjes së ligjshmërisë së punës të përmbauesit privat dhe Odës, personi i autorizuar zyrtari i Ministrisë, mund të urdhëroj masa për mënjanimin e të metave në punën e përmbauesit privat, dhe të caktoj afatin për të vepruar sipas atyre masave.

**Neni 360**  
**Komisioni Profesional për Vlerësimin e Përmbaimit**

1. Për të siguruar që vlerësimi për zbatimin e përmbaimit të kryhet në kontinuitet dhe që mbikëqyrja e aktiviteteve të përmbauesve të mos rrezikoj punën e tyre të papengueshme, Ministri emëron Komisionin Profesional për Vlerësimin e Përmbaimit (me tej: Komisioni) prej shtatë (7) anëtarëve dhe zëvendësve të tyre. Anëtarët dhe zëvendës anëtarët e Komisionit emërohen për periudhën prej katër (4) vitesh

2. Anëtarët dhe zëvendës anëtarët e Komisionit, ministri i emëron nga radhët e: Gjykatës themelore (dy (2) anëtarë dhe zëvendës anëtar); Gjykatës së Apelit ( një (1) anëtar dhe një (1) zëvendës anëtarë); Gjykatës Supreme ( një (1) anëtarë dhe një (1) zëvendës anëtarë); Këshilli Gjyqësor ( një (1) anëtarë dhe një (1) zëvendës anëtar); Fakulteti juridik (një (1) anëtar dhe një (1) zëvendës anëtar); Ministria e Drejtësisë (një (1) anëtarë dhe një (1) zëvendës anëtar).

3. Anëtarët dhe zëvendës anëtarët e Gjykatës themelore, Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme i propozon Këshilli Gjyqësor.

4. Kryesuesin e Komisionit e zgjedhin anëtarët e Komisionit përmes votimit të fshehtë me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit, në takimin e saj konstituiv

5. Për kryerjen e punëve profesionale dhe administrative për Komisionin, Ministria e cakton zyrtarët nga radhët e të punësuarve në Ministrinë e Drejtësisë.

### **Neni 361 Mbledhjet**

1. Komisioni punon në mbledhje, në të cilën marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.

2. Komisioni vendosë me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

3. Në punën e Komisionit mund të marrin pjesë, pa të drejtë vote, edhe ekspertë në çështjet të cilat gjenden në rend dite të Komisionit, me ftesën e kryesuesit të Komisionit, përfaqësuesit e institucioneve tjera dhe të shoqërisë civile kur bëhet fjalë për çështjet lidhur me përbarimin.

4. Komisioni, pas marrjes së pëlqimit të ministrit, nxjerrë Rregulloren e punës, me të cilën më për së afërmi rregullon mënyrën e punës, konvokimit dhe mbajtjes së mbledhjeve, punës publike si dhe çështje tjera me rëndësi për punën e Komisionit.

### **Neni 362 Kushtet dhe mjetet e punës**

1. Ministria siguron kushtet dhe mjetet e domosdoshme për punën e Komisionit, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

2. Anëtarëve të Komisionit për punë e tyre në takime u takon e drejta në shpërblim në pajtim me vendimin e veçantë të Ministrit.

### **Neni 363 Mbikëqyrja e punës së përbaruesve privat nga Oda**

1. Mbikëqyrja ndaj punës së përbaruesit privat dhe zëvendës përbaruesit privat do të kryhet edhe nga Oda.

2. Oda kryen mbikëqyrjen sipas detyrës zyrtare së paku një herë në vit.

3. Oda mundet të inspektojë objektet, të dhënat dhe materialin tjetër arkivor të përbaruesit privat, llogarinë bankare, menaxhimin e objekteve të ruajtura dhe paratë e vendosura si sigurim, dëftesat për paratë e mbledhura si shpërblim apo tarifë e përbaruesit privat sikurse edhe merr masat tjera në pajtim me ligjin dhe aktet tjera ligjore dhe së këndejmi urdhëron përbaruesin privat në fjalë të largojë parregullsitë dhe të caktojë afatin kohor për respektimin e tyre.

4. Oda është e autorizuar të urdhërojë përbaruesin privat të eliminojë të gjitha mangësitë në punën e tij/saj në kuadër të afatit të specifikuar kohor dhe shqipton masat tjera disiplinore në pajtim me ligjin dhe dispozitat tjera.

5. Raportin për kontrollin e kryer Oda ia dërgon Ministrisë.

6. Mënyra e kryerjes së kontrollit së punës së përmbaruesve privat në kuptim të këtij neni e përcakton Kuvendi i Odës.

#### **Neni 364**

##### **Raporti për punën e përmbaruesit privat**

1. Përmbaruesi privat është i detyruar që një herë në vit Ministrisë dhe Odës të ia dozoj raportin vjetor të punës brenda tre (3) muajve.
2. Ministri nxjerr akt nënligjor për mënyrën e raportimit dhe të përmbajtjes së raportit.
3. Raportet vjetore përfshijnë të dhënat si në vijim:
  - 3.1. numrin e përgjithshëm të lëndëve në punë;
  - 3.2. numrin e përgjithshëm të lëndëve të zgjidhura;
  - 3.3. numrin e përgjithshëm të lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit, dhe
  - 3.4. raporti i shumës së mjeteve të përgjithshme të realizuara me veprime përmbarimore dhe shuma e përgjithshme e kërkesave;
  - 3.5. të dhënat nga raporti vjetor i përmbaruesit privat shpallen në ueb Faqen Zyrtare të Ministrisë dhe të Odës, të dhënat nga ai raport janë publike derisa nuk shpallen të dhënat për vitin e ardhshëm.

#### **Neni 365**

##### **Përgjegjësia disiplinore e përmbaruesit privat**

1. Përmbaruesi privat ka përgjegjësi disiplinore nëse me veprimet e tij në ushtrimin e veprimtarisë së vetë shkel dispozitat e këtij ligji dhe të dispozitave tjera, nëse nuk i plotëson detyrimet e parapara me statut dhe me akte tjera të Odës, dhe nëse shkel prestigjin e profesionit të përmbaruesit privat.
2. Përmbaruesit privat në procedurën e përcaktimit të përgjegjësisë disiplinore mundë ti shqiptohen vetëm masa disiplinore të cilat janë të parapara me këtë ligj.
3. Përgjegjësia për vepër penale apo kundërvajtje nuk e përjashton përgjegjësin disiplinore të përmbaruesit privat.

#### **Neni 366**

##### **Fillimi i procedurës disiplinore**

Propozimin për fillimin e procedurës disiplinore mund ta paraqesin Ministria dhe kryetari i Odës, sipas iniciativës së vet si dhe sipas ankesave dhe iniciativave të palëve në procedurë, të përfaqësuesve të palëve dhe të autorizuarve të tyre. Propozimin sipas ankesës dhe iniciativës së palëve mundë ta paraqes edhe kryetari i Gjykatës kompetente për territorin e së cilës është emëruar përmbaruesi privat.

#### **Neni 367**

##### **Shkeljet disiplinore**

1. Shkeljet disiplinore munden të jenë si në vijim:
  - 1.1. nëse përmbaruesi privat tejkalon autorizimet e besuara me këtë ligj;
  - 1.2. nëse gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij përmbaruesi privat nuk i përmbahet ligjit;

- 1.3. nëse përmbartuesi privat gjatë procesit të emërimit nuk ka zbuluar në mënyrë të qëllimshme pengesat ligjore të cilat janë kusht i emërimit të tij;
- 1.4. nëse përmbartuesi privat ka shkelur detyrat e parashikuara me këtë ligj duke rrezikuar besimin në paanshmërinë e tij dhe në veprimet të cilat ai i ndërmerr;
- 1.5. nëse përmbartuesi privat ndërmerr veprime në procedurë pavarësisht arsyeve për përjashtim;
- 1.6. nëse përmbartuesi privat shkel detyrën e mbajtjes së sekretit zyrtar;
- 1.7. nëse përmbartuesi privat kërkon kompensim më të lartë se sa ai i paraparë në tarifë;
- 1.8. nëse përmbartuesi privat pa shkaqe të arsyeshme refuzon aftësimin profesional;
- 1.9. nëse përmbartuesi privat nuk mban evidencat për lëndët e përmbartimit në të cilat ai punon apo evidencat e lëndëve në të cilat ai/ajo punon nuk janë në rregull;
- 1.10. shkelja e detyrave të përcaktuara me dispozitat tjera;
- 1.11. nëse përmbartuesi privat në pajtim me aktin e odës nuk e paguan anëtarësinë.

### **Neni 368 Masat disiplinore**

1. Masat disiplinore për shkeljet disiplinore janë si në vijim:
  - 1.1. vërejtja;
  - 1.2. vërejtja publike;
  - 1.3. gjoba në të holla nga pesqind (500) deri tremijë (3000) Euro;
  - 1.4. ndalimi i ushtrimit të profesionit në kohëzgjatje prej tre (3) muaj deri në një (1) vit;
  - 1.5. shkarkimi nga detyra.
2. Ministri mund ta suspendoj përmbartuesin privat gjatë kohës sa zgjatë procedura disiplinore.
3. Gjobat në të holla nga nënparagrafi 1.3. i paragrafit 1. i këtij neni paguhet në buxhetin e Republikës së Kosovës.
4. Me rastin e shqiptimit të masave disiplinore merren për bazë të gjitha rrethanat të cilat mund të ndikojnë në llojin e masave dhe atë posaçërisht pasha dhe pasojat e shkeljes, dëmi i shkaktuar, shkalla e përgjegjësisë dhe masat e mëhershme disiplinore.
5. Të dhënat mbi masat e shqiptuara disiplinore nga nënparagrafët 1.3. deri 1.5. të paragrafit 1. të këtij neni, shpallen në faqen e internetit të Ministrisë dhe Odës.

### **Neni 369 Komisioni disiplinor**

Komisioni Disiplinor zbaton procedurën disiplinore për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të përmbartuesit privat dhe shqipton masat disiplinore në pajtim me këtë ligj.

### **Neni 370 Përbërja e Komisionit**

1. Komisioni Disiplinor, të cilin e emëron Ministri, përbëhet nga tre (3) anëtar dhe atë:



1.1. dy (2) anëtarë nga radhët e gjyqtarëve, të cilët i propozon Këshilli Gjyqësor i Kosovës; dhe

1.2. një (1) anëtarë nga radhët e përmbauesve privat të cilin e propozon Oda.

2. Kryetari dhe anëtarët e komisionit disiplinorë kanë zëvendësit e tyre. Anëtarët e komisionit disiplinorë emërohen për një mandate dy (2) vjeçar, dhe mundë përsëri të emërohen.

3. Anëtarët e komisionit disiplinor kanë të drejtë në shpërblimin për punën nga mjetet e Odes, në lartësi të cilën e cakton ministri sipas propozimit të Odës së përmbauesve.

4. Dispozitat e këtij ligji për përgjegjësinë dhe për procedurën disiplinore të përmbauesve privat përshatshëmrishtë zbatohet edhe për zëvendësit dhe zëvendësuesit e përmbauesit privat.

### **Neni 371 Përgjashtimi dhe kundërshtimi**

1. Dispozitat e ligjit të procedurës kontestimore të cilat vlejné për përgjashtimin e gjyqtarëve vlejné në mënyrë analoge edhe për përgjashtimin e anëtarëve të komisionit disiplinor.

2. Ministri me vendim vendosë për përgjashtimin nga paragrafi 1. i këtij neni. Vendimi i Ministrisë është përfundimtar.

### **Neni 372 Procedura disiplinore**

1. Procedura disiplinore konsiderohet se ka filluar në ditën e dorëzimit të propozimit për ngritjen e procedurës disiplinore ndaj përmbauesit privat.

2. Komisioni disiplinor menjëherë ia dërgon përmbauesit privat propozimin për ngritjen e procedurës disiplinore, i cili në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh ka të drejtë që të paraqes mbrojtje me shkrim lidhur me propozimin.

### **Neni 373 Seanca dëgjimore**

1. Kryesuesi cakton datën e seancës dëgjimore për rastin. Komisioni Disiplinor fton përmbauesin privat dhe palën ankuese që të paraqiten në seancë dëgjimore së paku dhjetë (10) ditë përpara seancës.

2. Propozuesit për ngritjen e procedurës disiplinore së bashku me ftesën i dërgohet edhe përgjigja me shkrim.

3. Nëse gjatë dëgjimit shqyrtimi i rastit shtyhet apo pezullohet për një periudhë kohore, asnjë njoftim i ri nuk ka efekt sikurse referohet në paragrafin 1. të këtij neni.

4. Seanca dëgjimore e Komisionit Disiplinor është publike. Për arsye me rëndësi, Komisioni Disiplinor mundet të urdhërojë që dëgjimi plotësisht apo pjesërisht të mbahet pa publikun

5. Përmbauesit privat dhe ankuesi munden të ndihmohen apo përfaqësohen nga një avokat.

6. Komisioni Disiplinor mundet të refuzojë individët e caktuar si mbrojtës nëse ata nuk janë juristë.

7. Komisioni Disiplinor i jep përmbauesit privat dhe ankuesit si dhe avokatëve të tyre apo të tjerëve të cilët i ndihmojnë ata, një mundësi për të marrë shënime për dokumentet që ndërlidhen me rastin.

8. Përmbauesit privat dhe ankuesit apo avokatëve të tyre dhe të tjerëve të cilët i ndihmojnë ata u jepet mundësi t'i drejtohen Komisionit Disiplinor dhe të shtjellojnë qëndrimin e tyre.

9. Komisioni Disiplinor mundet të thirr dhe dëgjojë dëshmitarët dhe ekspertët. Një nga anëtarët e Komisionit Disiplinor mundet të udhëzohet të dëgjojë dëshmitarët dhe ekspertët. Çdokush i thirrur si dëshmitar apo ekspertë respekton thirrjen. Ai më tej kërkohet që të përgjigjet në pyetjet e bëra apo të ofroj shërbimet e kërkuara. Dispozitat e ligjit të Procedurës Kontestimore vlejné përshtatshmërisht për dëshmitarët dhe ekspertët.

10. Pas zbatimit të procedurës disiplinore Komisioni disiplinor nxjerr vendim.

11. Procedura disiplinore me hollësisht do të rregullohet me akt nënligjor të Ministrisë.

#### **Neni 374**

#### **Vendimi i komisionit disiplinor**

1. Si rrjedhojë e vendimit të Komisionit Disiplinor përkitazi me ankesën kundër përmbarduesit privat, ankesa shpallet e papranueshme, e pabazë apo e bazuar. Vendimi duhet te permbaje arsyetimin dhe te shpallet.

2. Nëse Komisioni Disiplinor shpall ankesën plotësisht apo pjesërisht të bazuar, ai do të shqiptojë masa disiplinore siç parashikohen në nenin 368 të këtij ligji.

3. Veprimi disiplinor merret vetëm pasi që vendimi është bërë i plotfuqishëm apo shtyhet për më vonë nëse është përcaktuar në vendim.

4. Pa vonesë komisioni disiplinor i përcjell vendimin me shkrim ministrit, përmbarduesit privat dhe Odes. Vendimi shpallet publikisht në faqen zyrtare të Ministrisë dhe të Odes.

5. Vendimi i komisionit disiplinor është përfundimtar. Kundër vendimit të komisionit disiplinor mund të ngritët konflikti administrativ.

#### **Neni 375**

#### **Periudha brenda së cilës mund të iniciohet procedura disiplinore**

Procedura disiplinore mund të fillohet brenda afatit prej gjashtë (6) muaj nga dita e shkeljes së bërë, por jo më vonë se një (1) vitë nga dita e shkeljes.

### **KREU IX**

#### **PËRFUNDIMI PEZULLIMI DHE LIRIMI NGA DETYRA**

#### **Neni 376**

#### **Arsyet për pushim të funksionit të përmbarduesit privat**

1. Funksioni i përmbarduesit privat pushon:

1.1. në rast të vdekjes;

1.2. kur e mbushë moshën shtatëdhjetë (70) vjeçar;

1.3. në rast të dorëheqjes me shkrim;

1.4. në rast se me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës është dënuar për vepër penale në kohëzgjatje më shumë se gjashtë (6) muaj burgim, apo për ndonjë vepër që e bënë të padenjë në ushtrimin e funksionit të përmbarduesit privat;

1.5. në rast se përmbarduesi privat nuk fillon punën e tij brenda periudhës së paraparë me këtë ligj;

1.6. në rast të shkarkimit.

2. Në rastet nga paragrafi 1. të këtij neni, Ministri nxjerr vendim për pushim e ushtrimit të funksionit të përmbaruesit privat.

3. Për pushimin e ushtrimit të funksionit të përmbaruesit privat Ministria e njofton Odën dhe Gjykatën kompetente në territorin e të cilës përmbaruesi privat ka pasur selinë. Me kërkesë të Ministrit përmbaruesi privat kryen shërbimet e përmbarimit gjatë tre (3) muajve të ardhshëm derisa Ministri të nxjerr vendim për emërimin e përmbaruesit të ri privat apo zëvendësuesit të përmbaruesit privat.

4. Arsyet për pushim të ushtrimit të funksionit të përmbaruesit privat të përcaktuara në paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni përshtatshmërishtë zbatohen edhe zëvendësit të përmbaruesit privat.

#### **Neni 377 Dorëheqja**

1. Përmbaruesi privat, në çfarëdo kohe, mundet të kërkojë të lirohet nga detyra e tij. Kërkesa i paraqitet me shkrim Ministrit. Afati kohor për lirim të tij nga detyra është tre (3) muaj.

2. Pas skadimit të afatit kohor në bazë të paragrafi 1. të këtij neni, me të cilën detyra e përmbaruesit privat pushon, Ministri nuk cakton ndonjë afat tjetër kohor. Ministri duhet të merr vendim para skadimit të afatit kohor të parashikuar me paragrafin 1. të këtij neni.

#### **Neni 378 Shkarkimi i përmbaruesit privat**

1. Ministri me vendim shkarkon përmbaruesin privat nëse:

1.1. dëshmohet se ai nuk përmbush kushtet për emërimin e përmbaruesit privat;

1.2. përmbaruesi privat pranon çfarëdo funksioni siç parashikohet në nenin 323 dhe 324 të këtij ligji;

1.3. ai fillon të përdor pensionin e pleqërisë;

1.4. zotësia për të vepruar e përmbaruesit privat merret apo kufizohet me aktvendim të Gjykatës;

1.5. përmbaruesi privat humb në mënyrë të përhershme zotësinë për të kryer funksionin;

1.6. përmbaruesit privat i shqiptohet masa disiplinore e marrjes së autorizimit të tij për përmbarimin dhe sigurimin e kërkesës;

1.7. nëse përmbaruesi privat dënohet me vepër penale me aktgjykim të plotfuqishëm dhe kundër të cilit shqiptohet dënimi prej më së paku gjashtë (6) muaj burgim, e cila e bën atë të padenjë të kryejë funksionin e përmbaruesit privat.

2. Oda e përmbaruesve privat është e obliguar të informojë Ministrin menjëherë pasi të ketë mësuar për arsyet e shkarkimit të përmbaruesit privat nga paragrafi 1. i këtij neni.

#### **Neni 379 Vendimi për shkarkim**

1. Vendimi për shkarkim të përmbaruesit privat e nxjerr Ministri. Në vendimin për shkarkim të përmbaruesit privat Ministri cakton zëvendësuesin e përmbaruesit privat.

2. Vendimi për pushimin e ushtrimit të funksionit të përmbaruesit privat dhe vendimi për shkarkim të përmbaruesit privat nuk mund të ankimohet ne procedurën administrative, por kundër tyre mund të fillohet konflikti administrative.

## **KREU X**

### **ODA E PERMBARUESVE PRIVAT TË KOSOVËS**

#### **Neni 380**

#### **Organizimi i Odës së Përmbauesve Privat të Kosovës**

1. Oda e përmbauesve privat të Kosovës (më tej: Oda) është organizatë profesionale në të cilën bashkohen të gjithë përmbauesit privat.
2. Selia e Odës është në Prishtinë.
3. Oda ka statusin e person juridik dhe punon si organizatë jo profitabile.

#### **Neni 381**

#### **Përfaqësimi**

Oda përfaqësohet nga kryetari dhe kur ai mungon nga zëvendësit e tij bazuar nga vjetërsia e përvojës juridike.

#### **Neni 382**

#### **Autorizimet e Odës**

##### 1. Oda:

- 1.1. ruan prestigjin, dinjitetin dhe të drejtat e profesionit të përmbauesit privat;
- 1.2. nxjerr statutin, Kodin e Etikës së Përmbauesve Privat dhe aktet tjera në pajtim me ligjin dhe Statutin e Odës ;
- 1.3. përfaqëson përmbauesit para institucioneve publike për qëllime të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të profesionit;
- 1.4. kujdeset që përmbauesi privat të veprojë në mënyrë të ndërgjegjshme dhe në pajtim me ligjin ti kryejnë punët e tyre;
- 1.5. kujdeset për avancimin profesional të përmbauesve privat nëpërmjet organizimit të takimeve profesionale, seminareve dhe punëtorive profesionale në fushën e përmbaimit;
- 1.6. vendos dhe realizon bashkëpunimin me Odat e Përmbauesve të shteteve tjera; dhe
- 1.7. kryen punë tjera të përcaktuara me ligj dhe me Statutin e Odës.

#### **Neni 383**

#### **Statuti dhe aktet e përgjithshme**

1. Statuti dhe aktet e përgjithshme të Odës rregullojnë organizimin dhe aktivitetet e Odës si dhe organet, përbërjen e tyre dhe procedurat e emërimit të tyre.
2. Ministri jep pëlqimin në Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme të Odes.

#### **Neni 384**

#### **Organet e Odës**

Organet e Odës janë: Kuvendi i Odës, Bordi Ekzekutiv, Këshilli i Kontrollit dhe Kryetari i Odës.

#### **Neni 385 Kuvendi**

1. Kuvendi i Odës përbëhet nga të gjithë përbaruesit privat dhe zëvendësit e përbaruesve privat të regjistruar në regjistrin e Ministrisë.
2. Kuvendi i Odës është kompetent për:
  - 2.1. nxjerrjen e statutit të Odës, rregullave të procedurës së përbaruesve privat dhe akteve tjera të përgjithshme të Odës;
  - 2.2. përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit Ekzekutiv dhe anëtarëve të tjerë të Odës;
  - 2.3. vendos për shumën e pagesës së anëtarësisë dhe mënyrën e pagesës së saj;
  - 2.4. vendos për çështjet e parashikuara me këtë ligj dhe statutin e Odës.

#### **Neni 386 Mbledhja e Kuvendit të Odes**

1. Mbledhjet e jashtëzakonshme të kuvendit të odes thirren në rastet e parapara me statutin e odes.
2. Puna publike dhe çështjet tjera me rëndësi për punën e kuvendit të odes rregullohen me statutin e odes.

#### **Neni 387 Bordi Ekzekutiv**

1. Bordi Ekzekutiv ka kompetenca për të:
  - 1.1. zgjedhur Kryetarin e bordit ekzekutiv nga radhët e anëtarëve të vet;
  - 1.2. propozon draftin e statutit dhe aktet tjera të përgjithshme të Odës;
  - 1.3. përgatitur seancat dhe zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Odës;
  - 1.4. kujdeset për afarizmin e Odës;
  - 1.5. vendos për çështjet tjera në pajtim me këtë ligj dhe statutin e Odës.
2. Çdo vit Bordi përpilon një raport për aktivitetet e Kuvendit të Odës. Këtë raport t'ia përcjell Ministrit jo më vonë se 31 Mars të secilit vit.
3. Çdo vit Bordi përpilon politikën e tij financiare dhe buxhetin për vitin e ardhshëm financiar me shënime sqaruese dhe i dërgon këto dokumente Kuvendit për miratim.

#### **Neni 388 Përbërja e Bordit Ekzekutiv**

1. Bordi Ekzekutiv përbëhet nga një numër tek më së paku shtatë (7) anëtarë.
2. Përbërja e bordit sa më shumë që është e mundur pasqyron përpjesëtimin në kuadër të kuvendit ndërmjet përbaruesve privat dhe zëvendës përbaruesve privat.

3. Kryesuesi dhe zëvendësi i tij duhet të jenë përmbarues privat.
4. Anëtarët emërohen për mandat tre (3) vjeçar dhe pas dorëheqjes kanë të drejtë për rrimërim edhe njëherë për të njëjtën periudhë.

### **Neni 389 Kryetari**

1. Kryetari i Odës prezanton dhe përfaqëson Odën. Kryetari i bordit ekzekutiv është edhe kryetar i odes.
2. Kryetari i Odës ka autorizime të:
  - 2.1. kujdeset se a po respektohen parimet e kryerjes së ndërgjegjshme të detyrave të përmbaruesit privat;
  - 2.2. kujdeset që Oda po punon dhe zhvillon aktivitetet në pajtim me ligjin;
  - 2.3. implementon vendimet e organit të Odës kur parashikohet me statut të Odës;
  - 2.4. emëron personelin e Odës dhe
  - 2.5. kryen punë tjetër siç parashihet me statut të Odës.
3. Kryetarit të Odës në cilësinë e tij i besohet kryesimi i Kuvendit.

### **Neni 390 Këshilli i Kontrollit**

1. Këshilli i Kontrollit ka tre (3) anëtar, me mandat prej tre (3) vjetëve.
2. Këshilli i Kontrollit kryen kontrollin e ligjshmërisë së punës dhe afarizmit financiar të Odës.
3. Këshilli i Kontrollit për aktivitetin e tij i përgjigjet Kuvendit të Odës.
4. Kur Këshilli i Kontrollit gjen shkelje të statutit, akteve nënligjore apo vendimeve të Kuvendit të Odës, ai përpilon raport dhe t'ia prezanton Bordit Ekzekutiv respektivisht Kuvendit të Odës.

### **Neni 391 Pasuria**

1. Pasuria e Odes do të përbehet nga:
  - 1.1. kontributet e detyrueshme vjetore dhe kontributet plotësuese nga ana e anëtarëve të saj;
  - 1.2. pagesat për shërbime;
  - 1.3. donacionet dhe lënja e pronës me testament;
  - 1.4. burime të tjera.

### **Neni 392 Kontributet vjetore dhe plotësuese të Odës**

1. Oda bart tërë shpenzimet që burojnë nga ekzekutimi i detyrave të besuara me këtë ligj. Për të mbuluar këto shpenzime ajo mundet të ngarkojë anëtarët e vet me pagesa vjetore të anëtarësisë.

2. Me propozim të Bordit Ekzekutiv, Kuvendi përcakton madhësinë e pagesës së anëtarësisë për vitin financiar. Shuma mund të jetë e ndryshme për kategoritë e ndryshme të anëtarëve.

3. Përmbauesit privat i bëjnë pagesat e kërkuara Odës duke u bazuar në kushtet e specifikuar në aktet nënligjore të Odës dhe në pajtim me vendimet e Kuvendit të Odës.

### **Neni 393** **Aktet nënligjore të nxjerra nga Oda**

1. Aktet nënligjore miratohen sa i përket temave që në pajtim me këtë ligj rregullohen me akte nënligjore.

2. Aktet nënligjore nuk përmbajnë detyrime apo kërkesa të cilat nuk janë të domosdoshme për të realizuar objektivin e parashikuar me këtë akt nënligjor.

3. Propozimet për akte nënligjore i paraqiten Kuvendit të Odës nga Bordi Ekzekutiv.

4. Aktet nënligjore të Odës janë obligative vetëm për anëtarët dhe organet e saj.

5. Një akt nënligjor mundet t'i jep pushtet Bordit Ekzekutiv që të përcaktojë rregulla më të detajuara përkitazi me temën me të cilën merret ky akt nënligjor.

### **Neni 394** **Procedura**

Propozimi për akt nënligjor së bashku me shënimet sqaruese i kumtohen anëtarëve të Odës së paku dy (2) muaj para datës në të cilën do të diskutohet në Kuvendin e Odës.

### **Neni 395** **Miratimi i Ministrit**

1. Aktet nënligjore të propozuara nga Oda duhet të marrin miratimin e Ministrit. Miratimi mund të kthehet prapa nëse ky akt është në kundërshtim me ligjin ose interesin publik.

2. Pas miratimit nga ana e Bordit Ekzekutiv, Bordi angazhohet që akti nënligjor të bëhet i njohur me botimin e tij në Gazetën Zyrtare. Akti nënligjor bëhet obligativ vetëm pas botimit. Ai hyn në fuqi një (1) muaj pas publikimit apo edhe më herët nëse e përcakton Bordi me mirëkuptimin se së paku dhjetë (10) ditë duhet të kalojnë nga data e publikimit dhe e hyrjes në fuqi.

### **Neni 396** **Provimet**

1. Përmbajtja e provimeve për përmbauesit privat do të definohet në saktësi me akte nënligjore të nxjerra nga Ministri, dhe do të siguroj testimin e njohurive të përmbauesve privat në të gjitha qeshtjet e së drejtës ndërkombëtare dhe private dhe procedurat gjyqësore me rendësi për aktivitetet e tyre profesionale.

2. Provimet do të shpallen publikisht se paku një (1) muaj para fillimit të tyre dhe të gjithë të interesuarit do të ftohen për të marr pjesë;

3. Kandidati i cili do të nënshtrohet provimeve për përmbaues privat është i obliguar të bartë shpenzimet për provim.

4. Ministri përcakton shumën e shpenzimeve reale për marrjen e provimit, duke përfshirë shumën e nevojshme për përgatitjen dhe fillimin e pjesës së provimeve me shkrim, përgatitjen dhe dorëzimin e materialit dhe ftesave, përgatitjen e certifikatave dhe kompensimin e punës së anëtarëve dhe sekretarit të Komisionit për provime.

5. Nëse shpenzimet nuk paguhen në llogarinë përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së caktuar për mbajtjen e provimit, kandidatet nuk do të lejohen të hyjnë në provim. Nëse kandidati brenda një (1) viti nga dita e pagesës së provimit nuk ju ka nënshtruar provimit, pagesa do ti kthehet kandidatit.

6. Ministri do të emëroj për pozita të përmbauesit kandidatet me rezultatin me të lartë të arritur në provime, përveç nëse janë vërejtur parregullsi specifike në mes të kriterëve për emërim të identifikuar me këtë ligj që e bëjnë emërimin e tyre të papërshtatshëm. Ministri do ti informoj kandidatet për rezultatin e arritur në provim si dhe kandidatet e pasuksesshëm si arsye për mos emërimin e tyre.

7. Ministri do të shpall emërimet brenda një (1) muaji pas përfundimit të provimeve.

## **KREU XI**

### **DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 397**

#### **Lëndët e pazgjydhura para 1 Janarit 2014**

1. Lëndët e pazgjydhura të cilat janë parashtruar para hyrjes së këtij ligji në fuqi, zgjidhen në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

2. Lëndët e parashtruara në Gjykatë para datës 1 janar 2014 do të mbesin nën juridiksionin e Gjykatës përveç nëse kreditorët-propozuesit e përmbaimit parashtrojnë kërkesë për transferimin e lëndes (rastit) tek përmbauesi privat.

3. Në çdo lëndë kur procedura përmbaimore nuk është përfunduar më 1 janar 2014, dhe në të cilën kreditori ka kërkuar që lënda të vazhdojë të procedohet nga përmbauesi privat në pajtim me paragrafin 2. të këtij neni, Gjykata do të kompletoj të gjitha dokumentacionin lidhur me rastin e përmbaimit, specifikoj shpenzimet e ngarkuara nga Gjykata, dhe do të lëshoj konkluzion për dorëzimin e rastit tek përmbauesi privat. Gjykata do ta përcjelle rastin tek përmbauesi privat i zgjedhur nga Kreditori brenda (8) tetë ditëve pas marrjes së kërkesës së tillë.

4. Veprimet në procedurën e përmbaimit të ndërmarra nga Gjykata janë të vlefshme ligjërisht sikurse të ishin ndërmarrë nga përmbauesi i cili vazhdon përmbaimin. Pasi që përmbauesi të ketë pranuar lëndën, ai është i obliguar të njoftojë debitorin se procedura përmbaimore e nisur më parë vazhdon përmes përmbauesit privat.

5. Kompetent për të caktuar dhe vendosur për përmbaimin sipas dispozitave të këtij ligji që nga hyrja në fuqi të datës 1 janar 2014 e deri me 30 qershor 2014 janë si Gjykata ashtu edhe përmbauesit privat, varësisht se pranë cilit organ është paraqitur propozimi për përmbaimin.

#### **Neni 398**

#### **Procedurat e papërfunduara me 31 dhjetor 2013**

1. Procedura përmbaimore në të cilën është parashtruar ankesë kundër vendimit për përmbaimit para datës 1 janar 2014, i transferohen Gjykatës e cila ka juridiksion për të vendosur për mjetin juridik në pajtim me këtë ligj.

2. Gjatë shqyrtimit të mjetit të juridik, Gjykata kompetente e merr vendimin e saj duke u bazuar në dispozitat e këtij ligji.

#### **Neni 399**

#### **Aktet nënligjore**



1. Brenda gjashtë (6) muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministri i Drejtësisë nxjerr aktin nënligjor për tarifën e përmblyesve privat. Nga debitorët do të kërkohet që të kompensojnë kreditorët për shpenzimet e përmblyesve sipas këtyre tarifave.

2. Brenda periudhës prej katër (4) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministri do të:

2.1. nxjerrë aktin nënligjorë me të cilin do të definojë për së afërmi procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së provimeve për përmblyesit privat;

2.2. nxjerrë aktin nënligjorë me të cilin do të përcaktoj planin e biznesit si në paragrafin 2. neni 318 të këtij ligji;

2.3. nxjerrë aktin nënligjorë me të cilin definojnë formën dhe mënyrat e mbajtjes së evidencës së përmblyesve privat;

2.4. nxjerrë aktin nënligjor për formën dhe mënyrat e urdhërësive, procesverbaleve dhe akteve tjera që përmblyesi i ndërmerr gjatë veprimeve formale përmblyese;

2.5. nxjerrë aktin nënligjorë me të cilin bënë përcaktimin e metodave të inspektimit dhe kontrollimit të përmblyesve privat nga ana e Ministrisë dhe Odes së Përmblyesve. Forma, përmbajtja dhe mënyra e lëshimit dhe pezullimit të kartës së identifikimit të përmblyesve privat po ashtu do të definohet me këtë akt nënligjor.

3. Brenda katër (4) muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministri i Drejtësisë do të përcaktojë me një vendim të posaçëm, numrin e përmblyesve privat për territorin e secilës Gjykatë Themelore në Republikën e Kosovës bazuar në të dhënat zyrtare për regjistrimin e popullsisë dhe në bazë të nenit 327 të këtij ligji.

#### **Neni 400 Organizimi i provimeve**

1. Ministria organizon mbajtjen e provimit për përmblyesit privat brenda pesë (5) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Në bazë të akteve nënligjore për provimin profesional për përmblyes, Ministria organizon provimin e parë profesional për përmblyes dhe emëron përmblyesin e parë privat brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

#### **Neni 401 Themelimi i Odës**

1. Ministri, për përmblyesin privat të parë të emëruar deri në themelimin e Odës, përcakton me vendim ditën e nisjes të punës së përmblyesit privat.

2. Oda themelohet kur së paku njëzet (20) përmblyes privat janë emëruar dhe të kenë filluar punën e tyre.

3. Deri në themelimin e Odës, Ministri i kryen të gjitha kompetencat e Odës.

4. Gjersa Oda e Përmblyesve të themelohet dhe përmblyesit të emërohen, kërkesat nga paragrafi 4.3. i nenit 328 të këtij ligji do të suspendohen. Në vend të këtyre kërkesave, dy (2) anëtarë të Komisionit për Vlerësimin e Kandidatëve do të jenë dy (2) gjyqtar të procedurës civile të propozuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe të emëruar nga Ministria.

5. Ministri, brenda njëqind e njëzet (120) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji nxjerr aktet nënligjore të përkohshme të cilat parashikohen me këtë ligj që të lëshohen nga Oda e të cilat do të vlejnjë deri në nxjerrjen e akteve nënligjore përfundimtare nga ana e Odës.

6. Kuvendi themelues i Odës thirret nga Ministria, dhe kryesohet nga përmblyesi privat më i vjetër.

**Neni 402**  
**Hyrja në fuqi**

1. Nenet nga 323 deri në nenin 396 hyjnë në fuqi dhe aplikohen pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në gazetën zyrtare.
2. Dispozitat tjera të këtij ligji hyjnë në fuqi me 01 janar 2014.
3. Në datën e hyrjes në fuqi, shfuqizohet Ligji për procedurën përmbare i miratuar në vitin 2008, me numër 03/L-008 dhe Ligji për procedurën përmbare "Gazeta zyrtare e RSFJ-së", nr. 20/1978.

**Ligji Nr. 04/L-139**  
**20 dhjetor 2012**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-001-2013, datë 03.01.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga**